

SPIRO FLOQI

## KONSTRUKTE TAUTOLOGJIKE NË SHQIPEN E SOTME

(dhe paralele shqip-rumanisht)\*

O. Termi «tautologji», i sajuar në greqishten nga «tautos» (po ai, po ajo) dhe «logos» (ligjërim, fjalë) nën trajtën ταυτολογία ka hyrë në gjuhë të ndryshme indoevropiane nëpërmjet të latinishtes «tautologia» shqip «tautologji», it. «tautologia», fr. «tautologie», angl. «tautology» gjm. «Tautologie», rus. «тавтология». Fjala «tautologji» përdoret në sfera të ndryshme të dijës, në logjikë e në filozofi, në retorikë e në gjuhësi; shpjegimi i saj në fjalorë e enciklopedi të ndryshme është herë-herë shumë i përgjithshëm, e si rrjedhim, i paqartë; herë i pasaktë e i ngatërruar dhe herë i metë dhe me vlerësime të gabuara, gjë që rrjedh nga këndi i pamjes nga është kundruar si dhe nga botëkuptimi filozofik-gnoseologjik i përdorësve.

Kuptimi më i përhapur i termit tautologji, siç na rezultojnë nga analiza e një vargu fjalorësh të gjuhëve të ndryshme dhe enciklopedive të mëdha e ka zanafillën te pikëpamjet logiciste të shekujve të kaluar, të cilat janë përhapur edhe në ditët tona. Kështu, tautologjia është vështruar si «përsëritja e po asaj gjëje me fjalë të ndryshme»<sup>1</sup> ose si «përsëritja e po asaj ideje me anë të shprehjeve të afërta ose të njëkuptimita»<sup>2</sup> ose fortfort si «përsëritje e po asaj ideje nën një trajtë tjetër»<sup>3</sup> dhe ndonjëherë në një trajtë më globale e «përsëritje në suksesion imediat (close succession) e po asaj ideje, shpjegimi ose fjale»<sup>4</sup>. Kështu, pra, shprehja e papërcaktuar «përsëritje e po asaj gjëje» si dhe shprehja po aq e papërcak-

\*) Ky punim është varianti i plotë nga është nxjerrë kumtesa «Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordance ou divergences albanoroumaines)», mbajtur në Kongresin e parë të Studimeve Balkanologjike në Sofje në gusht 1966, dhe botuar në «Studia Albanica» 1966 Nr. 2 (f. 129-144). Ky punim dallohet nga kumtesa e mësipërme jo vetëm për përfshirjen më të gjerë të fakteve dhe materialeve, si dhe për ndonjë material të ri të shtuar ndërkohë, por edhe për një farë saktësimi të mëtejshëm të të konceptuarit të tautologjisë, që ka gjetur shprehjen në një përmirësim të mëtejshëm të përkufizimit të saj.

1) *Dictionnaire de la conversation et de la lecture*, sec. éd. entièrement re-fondue, sous la direction de M.W. Duckett, tome seizième, Paris MDCCCXXII, f. 482/1; Ottorino Pianigiani, *Vocabolario etimologico della lingua italiana*, M-Z, Milano, Sonzogno, 1937, f. 1413; УШАКОВ, М. *Толковый словарь русского языка* М. 1940, f. 632/2; N. Zingarelli, *Vocabolario della lingua italiana* settima ed., Bologna 1942, f. 1580/1.

2) *Der Grosse Brockhaus*, Achtzehnter Band, Leipzig 1934, f. 504/2.

3) Paul Robert: *Dictionnaire alphabétique et analogique de la langue française*, vl. VI, Paris 1964, 668 f.

4) *Webster's Third New Dictionary of the English Language*, VI. II, London 1961, f. 2344/3.

tuar «përsëritje... me fjalë të ndryshme... të afërta... ose që kanë po atë kuptim» nuk na sqarojnë aspak për brendinë e fjalës «gjë», as për karakterin gjuhësor të fjalëve.

Pikëpamja etimologjizante e ka bërë shkencëtarin frëng Maruzo<sup>5</sup> të shohë një tautologji të fjalave frënge «aujourd'hui» (sot) ku u thënka po ajo gjë me një përsëritje fjalë për fjalë (par une répétition littérale), ndonëse pjesa *hui* e kësaj fjale, e dalë nga latinishtja *hodie* (këso dite), kish kuptimin e fjalës *sot* vetëm në frëngjishten e vjetër, por në gjuhën e sotme nuk ndjehet më kuptimi i parmë i saj (dhe besoj, edhe në kohën kur doli fjala «aujourd'hui» kuptimi i pjesës «hui» ishte dobësuar, në mos po shuar), kështu që kjo fjalë ka kuptim tani vetëm me gjithë përbërjen e saj, në blok. Prandaj është e gabuar të shohim nga pikëpamja e sotme të shprehur po atë gjë me fjalë të ndryshme si të shprehjet: fr. «vente faite et consommée», it. «rimasi unico e solo», shqip: «dil jashtë», zaten edhe në momentin e formimit të këtyre shprehjeve ka pasur një element theksimi, përforcimi, kurse përdorimi i mëtejshëm i konsakroi me një kuptim të caktuar.

Termi «tautologji» është shikuar edhe në shkencën e logjikës, si një «grykim ku subjekti është identik me predikatin»<sup>6</sup> ose si «një grykim tautologjik (une proposition tautologique) ku predikati përsërit subjektin»<sup>7</sup> për të cilin jepet shembulli: «Çdo pasojë supozon një shkak», për arësye se përkufizimi i pasojës qënkëshe «ajo që është prodhuar nga një shkak», kështu që do të delte nga ana brendiore diçka e tillë si «çdo fenomen që është prodhuar nga një shkak supozon një shkak». Ne nuk do të merremi këtu me kesi tautologjish; nuk do të shqyrtojmë as tautologjinë e kuptuar si O. Ahmanova<sup>8</sup> si «tepëri e pajustificuar e shprehjes» të ilustruar me shembëllat e rusishtes «popullorçe» (просторечие) «самый наилучший», «более красивее», të cilat nuk janë veçse gabime gjuhësore.

Nga ana gjuhësore na intereson tautologjia linguistike, dmth të shprehurit e diçkaje me të njëjtat fjalë, me të njëjtin kuptim leksikor, natyrisht me disa kufizime të ndryshme gramatikore, siç do të shohim më poshtë.

Kështu, termi «tautologji» është shikuar nga pikëpamja logjike e brendisë së njëjtë (shprehet po ajo gjë me fjalë të ndryshme), ndonjëherë edhe me përmendjen e anës gjuhësore (përsëritje me po ato fjalë), por gjithmonë duke theksuar identitetin e brendisë.

Në kohët e fundit janë bërë edhe përpjekje për të hedhur poshtë konceptin tradicional logjicist të tautologjisë. Kështu Henri Valdi<sup>9</sup>, duke luftuar teorinë e pozitivizmit logjik, që konsideron se në tautologji mendimi bëka hap në vend, ngul këmbë se tautologjia kurdoherë kumton diçka të re. Por kthesë rrënjësore në shqyrtimin gjuhësor të tautologjisë përbën pikëpamja e akademikut rumun Al. Graur, parashtruar

5) J. Marouzeau *Lexique de la terminologie linguistique*, 3-e éd. augm. et mise à jour, Paris, P. Geuthner, 1961, f. 223.

6) Ушаков v.c. vl. IV. f. 6.

7) *Grand dictionnaire universel du XIX siècle*, Tome quatorzième, Paris.

8) Ахманова, О.С. *Словар лингвистических терминов*, М. 1966, f. 467.

9) Henri Wald, artikull i botuar në «Tribuna» a. VI, Nr. 49 (305), d. 6.XI.1962. Citojmë sipas Acad. Al. Graur, *Tautologia în limbă*; vetë artikullin fatkeqësisht nuk e kemi pasur në dispozicion.

në artikullin «Tautologjia në gjuhë»<sup>10</sup>. Aty autori thekson nevojën për të shqyrtuar përbërjen formale të tautologjisë dhe kategoritë sintaksore që mund ta veshin (care le poate îmbrăca)<sup>11</sup>. Në bazë të materialeve të shumta, sidomos të rumanishtes, autori parashtrohet disa tipe të ndryshme formale dhe përdorimet e tyre. Rëndësi të madhe ka edhe përkufizimi që i jep ai tautologjisë si «një fjali ose periudhë ku janë vendosur marrëdhënje gramatikore midis dy gjymtyrëve (gjymtyrë fjalie ose fjali të tëra) që kanë po atë kuptim dhe janë shprehur me po ato fjalë»<sup>12</sup>.

Pikëpamja e akademikut Al. Graur është zhvilluar e saktësuar më tej nga lingvistja rumune Euxhenia Kontrash, në kapitullin mbi «Tautologjinë» të gramatikës shkencore të rumanishtes<sup>13</sup>. Përkufizimi i saj është një konkretizim i mëtejshëm i anës gjuhësore të tautologjisë, që shihet si «përsëritje e një tipi special: ajo qëndron në përsëritjen e një gjymtyrë të fjalisë ose të një fjalie me po ato fjalë, që kanë po atë kuptim, por kanë funksione sintaksore të ndryshme»<sup>14</sup>. Autorja vëren se midis gjymtyrëve të tautologjisë mund të ekzistojnë diferenca formale për nga nyja, diateza dhe koha. Gjithashtu mund të ekzistojnë ndryshime intonacionore»<sup>15</sup>.

Duke vlerësuar lart bazat gjuhësore të konceptit të tautologjisë te kolegët rumunë, nuk mund të mos vëmë re prapëseprapë se përkufizimi që i kanë dhënë ata tautologjisë është akoma tepër i gjerë dhe i papërcaktuar mirë dhe, rrjedhimisht, jep shkas për keqkuptime, sepse përsëritja e një fjale me po atë kuptim leksikor, por me funksion sintaksor të ndryshëm nuk jep domosdo në të gjitha rastet konstrukt tautologjik nga pikëpamja gramatikore dhe brendiore, p.sh. Sheh *rrushi rrushin* e piqet; *Baba i babës* quhet gjysh, ose p.sh. në latinisht *Asinus asinum* fricat; *homo homini* lupus etj.etj. Veç kësaj, në periudhën me fjali të varur, vëllimi i fjalisë së varur nuk është i njëjtë me atë të fjalisë kryesore, për arsye se mjeti i lidhjes (lidhëzat nënrenditëse, përemrat lidhorë e pyetës lidhorë, ndajfoljet lidhore etj.) janë pjesë përbërëse e fjalisë së varur dhe nuk ekzistojnë të fjalja kryesore, kështu që njëra gjymtyrë e tautologjisë do të ishte një fjali po të abstragoheshim nga mjeti i lidhjes.

Ndërkaq nuk kufizohen qartë tiparet e tautologjisë në qoftë se do të lejohen diferenca formale për nga diateza dhe nga koha, sepse në fragmente tëaktuara ligjërimore ndryshimi i kuptimit gramatikor midis kohëve dhe diatezave shuan thujt krejt identitetin e kuptimit midis gjymtyrëve.

Le të krahasojmë fjalët: «Ha siç hanje», që i tha vjehrra nuses kur kjo e pat interpretuar gabim urdhërin e parë «Dy me një, o nuse» (d.m.th. dy kafshata bukë me një ulli) dhe kish filluar të hante «dy ullinj me një kafshatë». Me anën e gjymtyrës *hanje* të «ha siç hanje», vjehrra kërkon që veprimi i të ngrënit të kryhet tashatutje në ngjajshmi me karakteristikën e tij në të kaluarën imediate, d.m.th. «një ulli me një kafshatë», brendia reale e të cilit shtjellohet nga situata konkrete.

10) Acad. Al. Graur, *Tautologia în limbă*, Studii și cercetări lingvistice, 1962. Nr. 4, f. 443-448.

11) Po ai, *po aty*, f. 444.

12) Po ai, *po aty* f. 444.

13) Eugenia Contraș *Tautologia*, «Gramatica limbii române», Ed. a II-a, revăzută și adăugită. Vol. al II-lea. București 1963, f. 415-417.

14) Po ajo, *po aty* f. 415.

15) Po ajo, *po aty*, f. 415.

Po ashtu edhe te shembulli i mëposhtëm: «— Ju siguroj, shokë, se edhe në të ardhmen do të punoj si kam punuar».

Diferenca për nga diateza thuhet nuk ndeshet në praktikën e gjerë gjuhësore, megjithatë mundësitë e brendshme të gjuhës shqipe mund të na japin të tilla ndërtime si «Hante siç hahej» «Hante ç'i hahej», ku gjymtyra e dytë mund të marrë përkitazi kuptimin e diçkaje «të rëndomtë, të lejueshme, të pranueshme» në një rreth a rrethanë të caktuar, ose të diçkaje «të pëlqyeshme, të varur prej tekës a parapëlqimit».

Veç kësaj, duhen bërë edhe kufizime të tjera. Tautologji nuk kemi edhe atëhere kur gjymtyra e përsëritur është shoqëruar nga fjallë të ndryshme plotësonjëse (plotësa, përcaktorë, fjali e varur) që ngushtojnë në një mënyrë a në tjetrën vëllimin e nocionit të shprehur nga gjymtyra e parë. Kështu pra nuk kemi tautologji te shembujt e mëposhtëm: Gori e dinte se *po të dashuronte do të dashuronte me gjithë zemër* / P. Marko: *Hasta... 89/*; *Se shekulli i njëzet asht shekulli i apothëozës së misrit ndër foletë e shqipeve* / Migjeni: *Legjenda e misrit/*; — *Dita e sotme është dita që duhet të lash borxhet sipas fjalës që na ke dhënë* / N. Bulka; *Kur qante e qeshte bilbili (75)* / — *Le që s'del në rregull në punë, po dhe atë punë që bën e bën shtrembër* / Gjata: *Tana?* (25); — *Nëqoftëse do të fitojmë, ne do të fitojmë sepse jemi besnikë ndaj njëri tjetrit dhe vdesim për shoshogin!* — *mendova...* / H. Petrela: *Kronikë e viteve të paharruara (187)*.

Nga ana tjetër, nuk kemi tautologji kur fjala e përsëritur është përdorur të dy herët me kuptim të ndryshëm leksikor, si p.sh.: *Ay thosh: «Mos më çani kokën, unë dua atë që dua.»* / M. Kuteli: *Xinxifilla 121, E bukura e detit /*, sepse këtu kemi «unë dua (dëshiroj» për grua») atë që dua (= dashuroj), me fjalë të tjera: *Unë dua të martohem me atë që dashuroj*.

Prandaj nga koncepti gjuhësor dhe nga përkufizimi i tautologjisë duhet të eliminohet çdo diferencë formale për nga rasa, diateza, koha dhe veta dhe të lejohet të shumtën një diferencë për nga nyja e emrave dhe mënyra e foljeve. Tautologjia gjuhësore nuk mund të jetë kurrë e plotë, as nga pikëpamja formale: midis gjymtyrëve duhet të ketë një diferencë theksi (intonacioni). Tautologjia absolute nuk mund të ekzistojë, përndryshe gjuha s'mund të kryente funksionin e saj themelor: marrëveshjen. Prandaj ne do të formulojmë si vijon përkufizimin e tautologjisë: «*Tautologjia është përsëritja e së njëjtës fjalë ose e të njëjtit togfjalësh që ka po atë kuptim leksikor, po atë trajtë rasore, përkitazi po atë diatezë, kohë e vetë por që nuk plotësohet prej ndonjë fjale a fjallie të varur dhe që ka funksion sintaksor të ndryshëm, kur gjymtyrët e tautologjisë ndodhen në po atë fjali, ose që ka po atë funksion sintaksor të kallëzuesit foljor dhe funksione të ndryshme, atë të kryefjalës e të kallëzuesorit, kur njëra gjymtyrë ndodhet në fjalinë kryesore dhe tjetra në fjalinë e varur*». Dy gjymtyrët e tautologjisë me gjithë mjetet e lidhjes përbëjnë «konstruktin tautologjik». Mjetet e lidhjes së gjymtyrëve janë: 1) në fjali: folja këpujë «jam» ose këpuja zero; më rrallë folja këpujë bëmë (a bëhem) që tregon ndërrim të gjendjes; lidhëza *si*, parafjala *për*; 2) në periudhë a) përemri lidhor *që*, përemërat pyetës lidhorë e të pakufishëm lidhorë *kush, ç, se dhe lidhëzat që, ku, nga, si, sa, kur, në, si...që dhe b)* intonacioni, te periudhat asindetike (palidhëzore). Një pjesë prej mjeteve të lidhjes në fjalitë e varura mund të kenë edhe korelatët e tyre në fjalinë kryesore.

Në fjali mund të vendosen marrëdhënje midis: 1) kallëzuesorit e kryefjalës: *Djali është djalë*; 2) kallëzuesorit e kundrinës: Puna e bën *njerinë njeri*; 3) «plotësorit të marrëdhënjes» dhe foljes kallëzues a kallëzuesorit: *Për i zoti, është i zoti; për të parë e kam parë*.

Në periudhë, midis një fjalie kryesore dhe një fjalie të varur ekzistojnë funksione:

- 1) kryefjalore: *Ç'u bë, u bë*.
- 2) kallëzuese: *Qenë si qenë*, por tani janë ndryshe.
- 3) kundrinore: *Mora ç'mora*.
- 4) «marrëdhënjore» (kufizimi): *Që kanë ikur, kanë ikur*,

po....

- 5) vendore: *Vajtëm nga vajtëm*, pastaj prapë u kthyem.
- 6) kohore: *Kur je i mirë, je i mirë*.
- 7) shkakore: *Plaku, si plak që ish*, mezi ecte.
- 8) kushtore: *Në vjen, eja; në mos, flije mëndjen*.
- 9) përcaktore-lejore: *Edhe kalamani, që është kalamani*,

i di këto.

- 10) krahasore: *Hëngri sa hëngri*, të tjerat i la në pjatë.
- 11) mënyrore: *Këtë dimër kaloje si ta kalosh*; dimrin tjetër shohim e bëjmë.

Në periudhën asidentike kemi tipin me marrëdhënje lejore: *Iku iku*, s'kemi ç'i bëjmë.

Qoftë në fjali, qoftë në periudhë, tautologji kemi midis gjymtyrëve të bashkuara me marrëdhënje sintaksore varësie; përsëritja në bashkërenditje nuk formon konstrukte tautologjike.

Disa konstrukte që përfshihen ndër konstruktet tautologjike janë studjuar në plane të ndryshme (por jo si konstrukte tautologjike) së pari prej nesh disa vjet më parë<sup>16</sup>, të tjera janë parë nga M. Çeliku<sup>17</sup>, një palë nga J. Thomaj<sup>18</sup> dhe E. Lafe<sup>19</sup>, por disa konstrukte tautologjike kanë mbetur pa u studjuar, një palë duhen saktësuar nga pikëpamja strukturore dhe sidomos për nga vlera, dhe të gjitha kanë nevojë të shihen nga pikëpamja e një konceptioni sintaksor unik.

Në këtë punim do të shqyrtohet tautologjia në tiparet e saj kryesore: strukturore, kuptimore, stilistiko-gjinore. Studimi i konstrukteve tautologjike të shqipes së sotme paraqitet i gërshetuar edhe me përqasjen e konstrukteve përkatëse të rumanishtes së sotme, si hap i parë i studimit përqasor të strukturës sintaksore të shqipes dhe rumanishtes dhe si premisë e një studimi të mëtejshëm të këtyre konstrukteve në të gjitha gjuhët ballkanike.

Për shqipen, studimi i konstrukteve tautologjike është mbështetur mbi materialet e vjela nga më shumë se 80 vepra, prej Rilindjes e deri në ditët tona; gjithashtu është shfrytëzuar folklori i botuar, materiale

16) Spiro Floqi, *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, BUSHT, Seria Shkençat Shoqërore, 1958, Nr. 3.

17) Mehmet Çeliku, *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, BUSHT, Seria Shkençat Shoqërore, 1963, Nr. 1.

18) Jani Thomaj, *E folmja e katundit Seman* (sintaks e leksik), BUSHT, Seria Shkençat Shoqërore, 1961, Nr. 4.

19) Emil Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten*, «Studime Filologjike» 1966, Nr. 4.

dialektore të botuara, fragmente të ligjëritimit të përditshëm. Për ru-manishten jemi mbështetur në një material mjaft më të ngushtë<sup>20</sup>

Konstruktet tautologjike përbrenda fjalisë nuk kanë ndonjë larmi të madhe funksionale dhe kuptimore: ato do t'i shqyrtojmë nga funksioni i gjymtyrëve, kurse paraqitjen e konstrukteve tautologjike në peri-udhë do ta bëjmë në bazë të mjetit të lidhjes, për arsye se vlera e tautologjisë në këtë rast përcaktohet nga mjeti i lidhjes krahas përsë-ritjes së elementeve leksikore.

### I. Konstruktet tautologjike në fjali.

Në fjali, gjymtyrët e konstruktit tautologjik mund të shprehin ma-rrëdhënje sintaksore:

- 1) midis kallëzuesorit dhe kryefjalës;
- 2) midis kallëzuesorit dhe kundrinës së drejtë.
- 3) midis plotësorit të «marrëdhënjes» dhe përkritazi kallëzuesit fol-jor ose kallëzuesorit.

I. 1. Shumë të përdorshme në gjuhën shqipe janë konstruktet tau-tologjike «kryefjalë-kallëzuesor», të cilat karakterizohen nga këto tipare:

a) Kryefjala dhe kallëzuesori mund të shprehen me emra dhe me përemra (rëndom përemra vetorë). *Urdhëri është urdhër. Ti je ti dhe ai është ai.* Kryefjala shprehet rëndom me emër të shquar (emër plus njëz shquese), por mund të shprehet edhe me një emër të panyjshëm të shoqëruar nga një përcaktor (*Dy veta janë dy veta*) ose një emër i shoqëruar me fjalë përcaktontjese: *urdhëri i shefit është urdhëri i shefit; gjyshi im është gjyshi im.* Kallëzuesori emër është rëndom i panyjzuar, por mund të jetë dhe i panyjzuar dhe i shoqëruar me një fjalë përcak-tuese (në rast se edhe kryefjala ka një fjalë të tillë): *Katër ushtarë ja-në katër ushtarë; në raste të tjera kallëzuesori mund të jetë vetëm dhe i pajisur me një shquese: nëna është nëna.*

b) Kallëzuesori emër bashkohet me kryefjalën nëpërmjet të foljes këpujore *jam*, këpujë maksimalisht e abstraguar. Më rrallë mund të për-doret edhe si folje këpujë folja «bëhem», me kuptimin e ndërrimit të gjendjes.

Tasi: Iluzione, Andrea. *Faktet janë fakte!* V. Vinçani: Pas furtunës, A I t. I, në Drama (283) /

*Se gjaku asht gjak:* K. Resuli, Tradhëtia (86).

— Pse / kish merak, S. F. / vetëm për çunin? Ju kishit edhe një vajzë! — pyeti me qëllim Zefi.

— Se çuni vinte i dobët, — tha plaka. — Mandej çuni asht çun. — shtoi / Sh. Musaraj. Para agimit (I) (570) /.

20) Acad. Al. Graur, *Tautologia în limbă*, «Studii și Cercetări Lingvistice» 1962, Nr. 4, f. 443-448 (më tej shkurt AG-T); Eugenia Contrás, *Tautologia*, «Gramati-ca limbii romine», vol. II, bot. II București 1963, f. 415-417, më tej, shkurt GLR, II, T); ARPR, *Gramatica limbii romine*, vol. I dhe II bot. II, București 1963 (më tej, shkurt GLR); V. Guțu-Romalo, *Repetiția, procedeu sintactic de exprimare a as-pectului în limba romină*, «Studii și Cercetări Lingvistice» 1963, Nr. 3, f. 485-493 (V.G-R.); Mioara Avram, *Evoluția subordonării circumstanțiale în limba romi-nă*, București 1960 (më tej, MA-ES); ARPR, *Dicționarul limbii romine literare con-temporane* vol. I-VI, București 1955-1957 (më tej DLRLC); ARPR *Dicționarul limbii romine moderne*, București 1958 (më tej DLRM).

— Unë shikoj defterin, se *hesapi është hesap* edhe vëlla në qofsh / Xoxe: Liv (II) (244) /.

c) Nganjëherë këpuja mund të përforcohet me ndajfoljet *gjithmonë, përherë, gjithherë*, të cilat mund edhe të zënë vendin e këpujës, kur kjo nuk është shprehur; nuk janë të paka rastet kur këpuja mungon, dhe në këtë rast ajo mund të kompensohet krejt nga ndonjë pjesëzë si pjesëza e pohimit *po* ose nga ish-lidhëza *se* me funksionin e sotëm të një pjesëze.

*Shqiptari*, mysliman qoftë, orthodox qoftë, katolik qoftë, *është gjithmonë shqiptar*. / S. Frashëri: Shqipëria..., S. Prifti, 1. c. pjesa I, f. 66).

Dr. Andrea — *I huaji është gjithmonë i huaj* dhe Shqipëria rrallë ka gjetur nër ta miq të vërtetë. / Vinçani «Pas furtunës», Akti III, Drama (319) /.

*Dhëlpër dhëlpën gjithherë*. / D. Kurti: Prralla kombtare, I (31) /.

— Po ça ti bëjmë dhe ne qeraxhinjtë e zes... *Nata po natë*: do gju-më; *qerrja po qerre*: të dremit me nani nani; *robi po rob*: i lodhur e i këputur e hajde ta mbash gjumin pastaj e të bëhesh kukudh në majë të qerres. J. Xoxa: LIV (III) (45).

Nikollaqi: / Misheli/ *Është i krimbur në napolona, Olimbi! Ç'i do llafet!*

Olimbia: I rruaçin! *Gallofi se gallofi!* / S. Çomora: Kek, a.I t. I, Drama (130) /.

ç) Mjaft herë këpuja mungon; gjymtyrët e tautologjisë lidhen atëhere me mjete intonacionore, me pauzën bashkuese.

Hamalli A: Ai tha se do të na paguani zotëria juaj.

Olimbia: Po *batakçiu, batakçi!* / Po ai, po aty (163) /.

«*Po vllëzëria vllëzëri: (...)*. / S. Spasse: Buzë liqenit (223).

E rënkoinin e lebetiteshin të plagosurit në atë gjuhë të ngatërruar, si mos më keq. *Po lufta luftë*: bjeri t'i biem gjer na nxehej dyfeku e s'mbahej nër duar. / M. Kuteli: Kapllan Aga... (17) /.

d) Rendi i rëndomtë i fjalëve është si vijon: në fillim kryefjala, pastaj këpuja, pjesëzat (ose pauza bashkuese) dhe në fund kallëzuesori; kallëzuesori vihet në dukje nëpërmjet të theksit të fuqishëm që bie mbi të; anasjellja e gjymtyrëve vërehet rrallë, dhe në këtë rast theksohet edhe më tepër kallëzuesori.

*Dhëlpër është dhëlpër*, po këtu e humbet mëndjen e s'di ç'të thotë, ja merr përçart: / M. Kuteli: Xinxifillua (77) /.

Nganjëherë rendi mund të jetë si vijon: kryefjalë- kallëzuesor-këpujë, p.sh.:

— Nuk shahemi dot ne, — u përgjegj Kristua (...).

*Dielli, ( ) diell është* edhe në plehë. Le të thonë ç'të duan. / A. Çaçi: Na hoqën çatinë? (16) /.

— Po bëhet luftë baba, dhe topa bien shumë.

Çdo ditë luftë bën Lulashi dhe *lufta luftë është*.

Këndo, moj bijë, se mirë i bën kënga trimit / Z. Sako: Guri i nuses «Një-rëz dhe ngjarje» (68).

dh) Në shumicën dërmuese të rasteve, konstrukti tautologjik përbën fjalinë e parë «të pavarur» të një periudhe me fjali të bashkërenditura me marrëdhënje kundërshtore, bashkuar me lidhëzën *por* ose *po*:

— (...) vete e marr mitrolozin dhe vij.

— Po urdhëri?

— Urdhëri the? *Urdhëri është urdhër*, mor shpirt i vëllait, po nuk

të duket ty që ai mitralozi, megjithëse nuk ka gojë, na thëret ta marrim. / Th. Nikoli: Rrethimi u zgjerua, Në ato ditë stuhie (80) /.

— Nuk bëri mirë Fatosi që s'ndëni një muaj në bazën e brigadës për t'u stërvitur. *Vullneti është vullnet, po dhe lufta ka zanatin e saj.* / P. Marko: Hasta la vista (12) /.

**I. 1. 2.** Një palë i kanë mohuar kallëzuesit tautologjik vlerën njohëse, kurse nonjë tjetër deklaroi se «rëndësia njohëse e tij është e pakët»<sup>21</sup>. Nga sa kemi parë deri tani, del se këto mendime janë të gabuara: vlera kumtuese e tautologjisë, «rëndësia njohëse» nuk është më e pakët se ajo e konstrukteve të tjera kallëzuesore jotautologjike.

Por këtu ndërkaq del pyetja: si është e mundur të komunikohet diçka e re me anën e një kallëzuesori tautologjik?

Dihet se funksioni kryesor i një kallëzuesori emër të bashkuar me kryefjalën me anën e këpujës «jam» është të klasifikojë nocionin e shprehur nga kryefjala me një nocion më të përgjithshëm, të shprehur me kallëzuesorin emër. Por puna nuk qëndron vetëm me kaq. Zepse kallëzuesori emër jo vetëm që klasifikon por edhe «përshkruan» kryefjalën, siç ndodh p.sh. te fjalia: *Afërdita është nënë*; këtu kallëzuesori *nënë*, më tepër se e klasifikon personin te kategoria e nënave, e përshkruan atë, duke i dhënë një karakteristikë dalluese, themelore që është e mirëfilltë për një nënë, si dhëmbshurinë, dashurinë ndaj fëmijës, etj., etj. Vetia përshkruese e afron kallëzuesorin emër me një kallëzuesor të shprehur me një mbiemër, i cili, siç dihet, e përcakton kryefjalën nga pikëpamja e një tipari, cilësie e veçorie. Dhe është pikërisht kjo anë përshkruese, karakterizuese e kallëzuesorit emër që paraqitet e theksuar te rastet e kallëzuesorit tautologjik. Kjo anë përshkruese karakterizuese vihet në dukje nëpërmjet të një theksi më të fuqishëm që bie mbi kallëzuesorin, dhe ky theks luan një rol të rëndësishëm.

— Ervehe! Ti shko e arrije brigadën! Në mos u kthefsha unë, çantën dorëzoje në shtab! (...). I kundërshtova, po *urdhëri ishte urdhër* dhe iu binda. / F. Gjata: Shqipëria-Shtëpia. Në pragun e jetës (149) /.

Duke theksuar identitetin e kallëzuesorit me kryefjalën, është vënë në dukje prania e një tipari, e një vetie karakteristike inherente të kryefjalës, domethënë është theksuar te sendi, frymori i shprehur nga kryefjala, prania e karakteristikës, vetisë autentike të tij. Kjo karakteristikë autentike zakonisht është e përhershme, por ndonjëherë mund të jetë edhe e përkohshme, sipas lidhjes që mund të vendosim në një rast konkret. Tipari kryesor, esencial i urdhërit është natyrisht se ai duhet zbatuar, prandaj kallëzuesori «urdhër» te shembulli: «*Urdhëri është urdhër*» vë në dukje tiparin e detyrimit të zbatimit të urdhërit. Këtu qëndron vlera kumtuese e kallëzuesorit tautologjik: të tregojë duke e theksuar tiparin esencial të kryefjalës. Te shembulli «*ligji është ligj*» — me kallëzuesorin tautologjik theksojmë karakterin e pashkelshëm të ligjit.

Si për nga struktura, si për nga kuptimi konstruktet tautologjike koresponduese të rumanishtes koincidojnë plotërisht me ato të shqipes. Trajta e kryefjalës dhe ajo e kallëzuesorit emër janë përkitazi identike në të dy gjuhët: kryefjala është emër i shquar me një të aglutinuar, kurse kallëzuesori është emër pa nyjë, p.sh.:

21) Stefan Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Dispensë për Institutet Pedagogjike Dvjeçare, pjesa e parë. Tiranë 1959, f. 66.

*Podvada era podvadă... Meremetul era meremet / Camil Petrescu, GLR, II, f. 415 /*

Vlerën e këtyre tautologjive, Gramatika e akademisë rumune e përcakton si vijon: «ajo tregon karakterin veridik, autentik, real të gjymtyrës së parë» (GLR, II (417)).

Po ashtu si në shqipe, mund të mungojë folja këpujë dhe në tautologji mund të kemi një «element adverbial» si p.sh. fjala «tot» (= gjithmonë). P.sh.:

*Capra tot capră; se zmucea în toate părțile / Creangă, GLR, II, 415 /.*

Por kur kallëzuesori është një emër i përveçëm (ose një emër që tregon në kontekst të caktuar një send a person krejt të identifikuar) kallëzuesori vihet në trajtën e shquar me një të dy gjuhët. Krh.:

*Mama-i mama și tu esti tu / GLR, I. /.*

*Prahova-i Prahova / po aty / dhe*

*Nëna është nëna*

*Tirana është Tirana.*

Kush është Hedia që u dashka të gjurmojmë jetën e saj, fare të shkuar. *Hedia është Hedia.* Asgjë më tepër. / A. Cerga: Hedia, «Vullnetari», 3 prill 1968, f. 1, sht. 3 /.

Emëri *nëna* në situatën konkrete tregon një person të dalluar. Këtu konteksti a situata bën të «nënkuptohej» një përcaktor si përemrat *ime, jote, jonë* etj.

Në këto konstrukte tregohet me theksim *identiteti i kryefjalës me kallëzuesorin.*

**I. 1.2.1.** Në raste të tjera, kallëzuesori tautologjik thekson karakterin ekskluziv të tiparit, duke mos lënë esencën e nocionit të shprehur nga kryefjala të kapërcejë caqet e caktuara nga vetë ai nocion:

Mirëpo *ndihma*, në fund të fundit, *është ndihmë*, ajo nuk mund të lozë rolin vendimtar / E. Hoxha: Fjala e mbajtur në takimin me përfaqësuesit e inteligjencës së kryeqytetit. 1962 /. Me konstruktin tautologjik vihet në dukje se «ndihma nuk është gjithçka», se «ndihma nuk është tjetër veç se ndihmë».

Në këto raste konstrukti tautologjik shoqërohet nga një fjali mohore, lidhur me bashkërenditje ose asidentisht:

Vetmevete ajo / Emira, S. F. / kish menduar gjithënjë se prishja me Qemalin, që rridhte nga shkaku i pikëpamjeve të tyre të ndryshme politike, ish një çështje që s'do të zgjaste shumë. *Pikëpamjet politike ishin pikëpamje politike* dhe asgjë më shumë / Sh. Musaraj: Para agimit (I) (477-478).

Me të njëjtat mjete shprehet kjo vlerë edhe në rumanishten: Crima nu e politică... *Crima e crimă / Rebreanu, GLR II, 417 /.*

Konstruktet tautologjike mund të sajojnë dhe fjali të bashkërenditura, të bashkuara me lidhëzën këpujore *e*, ose asindetisht (kryesisht nëpërmjet të intonacionit të përqasjes): *Qefi është qef, e puna është punë.*

Duke u vënë në përjasje dy fjali me strukturë paralele, vihen në përjasje, mbi bazën e këpujave morfologjiksht dhe leksikisht të njëjta (ose mbi bazën e këpujës zero — për kohën e tashme) kryefjalët dhe kallëzuesorët përkatës të fjalive të bashkërenditura. Në këtë rast vëmë në dukje karakterin e veçantë të çdo thënjeje, d.m.th. se qefi është diçka më vete, dhe puna është diçka më vete, me fjalë të tjera vëmë

në dukje se puna, si diçka serioze etj. nuk është diçka «sa për të kaluar kohën», «sa për t'u zbavitur», dhe në analizë të fundit, se «puna s'është qef». Kjo duket qartë në shembujt e mëposhtëm:

«Ç'thotë ligji? Thotë: *njeriu është njeri, skllavi — skllav. Pra skllavi s'është njeri* / M. Kuteli: Në një cep të Ilirisë së Poshtme Nëndori» 1965, Nr. 6 (22) /.

J. — E zeza dhe e bardha qëndrojnë bashkë, janë një gjë, vetë e ke thënë.

B. — Jo, *ja në dy gjëra. Medoemos dy. E bardha është e bardhë dhe e zeza e zezë...* / F. Paçrami: E bardha dhe e zeza, akti III, tb. VI, «Nëndori» 1965, Nr. 7 (82) /.

Këto fjali të bashkërenditura, për nga brendia e tyre, kalojnë shpesh në thënje aforistike dhe nga përdorimi i dendur dhe i gjatë, modeli sintaksor mund të humbë këputjen jo vetëm në fjalinë e bashkërenditur (në të dytën etj.), por edhe të fjalia e pavarur (tek e para).

— Pastaj me masë çdo gjë, ore Nasto, *puna punë e nusja nuse* / S. Andoni: Maleve në Shëndre (2) /.

M. — Gjithkush ka vendin e vet: *grueja — grue, prindët — prindë* / N. Luca: Votra e huej, akti I, (10) /.

*Krushku — krushk, miku — mik* / Gjeçov: KiLD, XXV /

«*Miku mik; shoqi shoq*» / Po ai, po aty, § 640 /.

«*Zana jemi e zana kjosim!* / *besa besë e fjala fjalë* / *grueja grue e zana zanë* / *zana diell e grueja hanë* / KPLgj, 140/.

*Nana — nanë, baba — babë, burri — burrë, e grueja — grue* / Kamsi: Goja e popullit /.

Elementet strukturore gramatikore si dhe vlerat përputhen plotësisht si në shqipen, ashtu dhe në rumanishten. Krh. p.sh.:

*Jocul e joc și norocul e noroc* / Caragiale, GLR, II, 416 /.

*Slujba-i slujbă, și drujba-i drujbă* / AL. Graur, TiL, 445 /.

**I. 1. 3.** Në konstruktin tautologjik fjali nominale, kryefjala dhe kallëzuesori janë që të dy të shquar, punën e këputjes e bën lidhëza *si* (rum. *ca*). Ky kallëzuesor dallohet për faktin se nuk merr ndonjëherë këputje. Plani kohor është gjithmonë ai i së tashmes.

Medihaja — Mamaja si është?

Shpresa — Mirë. *Mamaja si mamaja* / F. Paçrami: E bardha dhe e zeza, akti III, tb. VII, «Nëndori», 1965, Nr. 7 (85) /.

Vlera e këtij konstrukti është të vërë në dukje se kryefjala përputhet plotësisht me esencën e nocionit të treguar prej saj, d.m.th. aty theksohet se tipari i sendit është autentik dhe kjo karakteristikë autentike është ashtu siç e parafytyrojmë zakonisht.

— *Grania si grania*, hej burrë, *e burrat si burrat!*... dhe /Sulejman Tafili, S.F. / i ra në sup myzeqarit / J. Xoxe; LIV, (I) (36) /

Ky konstrukt përdor shpesh si kryefjalë e kallëzuesor një emër të përveçëm, duke theksuar me këtë se personi paraqitet edhe në këtë rast i ngjajshëm me vetveten, me karakteristikën tipike, autentike, të zakonshme:

«Po nuk u fut Llaz Qesarati në kooperativë, s'kemi pse të futemi ne të tjerët» — thonë ata... Po *Llazi si Llazi*. E shikon si qëndron puna dhe prapë s'bindet / Sh. Musaraj: Isha unë... (75) /.

Po xha Demi... Sa kryeneç / qe /; aq edhe më kryeneç u bë... Veç po të pyesje botën, fjalë të liga për të nuk dëgjoje. *Xha Demi si xha Demi*.

Si bën keq njeriu, po vetes. Si uthulla e fortë / Dh.Shuteriqi: Xha Demi, KeP (107) /.

Anastas Gjeorgjeviçi ja kish përvehtësue / Hasanit / arën e bukës. Dhe *Hasani si Hasani!* As nji, as dy, por thikën në fyt / K. Resuli: Tradhëtia (259).

Këtu konteksti i jep Llazit dhe Xha Demit karakteristikën «kryeneçë» ose Hasanit atë të «gjaknxehitit», ndërsa te shembulli i mëposhtëm Lajes i jepet karakteristika e njeriut «të pavendosur», karakteristika këto tipike, autentike dhe të zakonshme për secilin personazh.

Sadiku: Po Laja ç'po bënte?

Sula: *Laja si Laja*, kujt t'ja prishë e kujt t'ja ndreqë / K. Jakova, Ndimë konkrete, «Nëndori» 1968, Nr. 9 (144) /.

Një kallëzues emëror i tillë ndërtohet në të njëjtën mënyrë në gjuhën rumune: kryefjala dhe kallëzuesori janë emra të shquar, ata bashkohen pa ndonjë këpujë por me fjalën *ca*, gjymtyrët shqiptohen pa kurrfarë pauze, rendi është i ngurosur:

*Briza ca briza*, iși inchipuia el cam ce-ar să fi / Tudoran, GLR II (415) /.

*Copii*, biet *ca copiii*, nu știau ce să facă, ce să dreagă ca să umble după placul ei /Ispirescu, DLRLC, I, 308/2/.

**I. 2.** Gjymtyra tautologjike e shprehur me emër rrallë përdoret si kallëzuesor i kundrinës (plotësor kallëzuesor i kundrinës). Në këtë rast, kundrinori i drejtë është në trajtë të kallëzores së shquar, ndërsa kallëzuesori në rasën kallëzore të pashquar. Si kallëzues përdoret rëndom folja *bëj*.

Puna e bën *njerinë njeri*.

— Hajde, luaji të tharat! ...i foli / Piloja, S. F. / të birit; — Kumbarja po të pret te kënetat, ti ma paske bërë *gjumin gjumë*. / J. Xoxe: Lumi i vdekur (I) (219) /.

Kuptimi i këtij konstrukti tautologjik është të theksojë karakteristikën më spikatëse të sendit, karakteristikën me të vërtetë dalluese.

Në materialet që disponojmë për rumanishten ky konstrukt nuk figuron.

**I. 3.** Konstrukti tautologjik i përbërë prej një fjale me funksion kallëzuesi (foljor ose emëror) dhe prej përsëritjes së po asaj fjale, por me funksionin e një plotësori «të marrëdhënjes» (pl. të kufizimit) është shumë i përhapur në ligjërimin e folur, dhe pasqyrohet edhe në letërsinë artistike.

Dallohen dy variante kryesore: 1) kallëzuesi është foljor dhe 2) kallëzuesi është emëror.

**1. 3. 1.** Kallëzuesi foljor përsëritet nga trajta e paskajores (toske ose geqe). Këtë konstrukt e kemi shqyrtuar për herë të parë në një punim tonë mbi përshkrimin e një të folmeje të toskërishtes<sup>22</sup>, aty krahas zberthimit të strukturës, funksionit janë paraqitur dhe kushtet e përdorimit. Më vonë konstrukti është shqyrtuar me materiale të të folmeve të Shqipërisë së Mesme nga M. Çeliku<sup>23</sup>.

<sup>22</sup> Spiro Floqi: *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, BUSHT, Seria Shkenca Shoqërore, 1958, Nr. 3 (113-117).

<sup>23</sup> Mehmet Çeliku: *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, BUSHT, Seria Shkenca Shoqërore, 1963, N. 1, f. 170-176.

Tiparet kryesore të këtij konstrukti tautologjik janë:

1) Mungesa e kufizimit nga pikëpamja leksikore: mund të përsëriten me paskajoren trajtat vetore të të gjitha foljeve. Ka vetëm kufizime brendakategoriale: kallëzuesi që përsëritet nga paskajorja është rëndom vetëm në trajta të mënyrës dëftore, ndër të cilat më të përdorshmet janë: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera dhe e ardhmja. Trajatat e tjera janë shumë më të rralla. Kallëzuesi mund të jetë pohor ose mohor; kur është mohor përdoren jo vetëm pjesëzat e mohimit total, *s, nuk*, por dhe pjesëza *spara* që tregon mohim të zbutur ose mohim sporadik. P. sh.

— *Për të njohur e njo* / po emrin nuk ia di / Pg / S. Floqi, Skicë...

— *Për të folur spara u flisnja* / fëmijëve, S. F. / po frikën ma kishin / çudi qe // (Ks.) / Po ai, po aty. /

— He! thashë me vete time. Po *për të lojtur, s'lojta* nga vendi. / Kacori: PM (II) (16).

I bani gjellët / po *për t'hangër nuk hangri* (Gr. Z.) / M. Çeliku, v.c. (170) /

Në funksionin e një pjesëze mohuese në ligjërimin e folur popullor familjar mund të përdoren dhe ish-pasthirma *hë!* e përsëritur, e shoqëruar me lidhëzën *se (hë hë se + F +)*: «(...) njeriu qesh, kurse hajvani pëllet e bërtet po *për të qeshur hë hë se qesh dot.*» / J. Xoxa: LiV (II) (34) 1.

Rendi i gjymtyrëve të tautologjisë nuk është gjithmonë i lirë<sup>24</sup> kur kallëzuesi është pohor, ky mund të jetë në postpozicion ose në prepozicion ndaj paskajores; por kur është mohor, kallëzuesi vendoset rregullisht në postpozicion, rendi në këtë rast është i ngurosur dhe gjymtyra e përsëritur anticipon kallëzuesin. Zaten në gjuhën letrare ky rend është i vetmi në të gjitha rastet, pra «paskajore + trajtë vetore e foljes».

Ndoshta e ndjen, se *për të kuptuar ai nuk kuptonte gjë*. / Gjata: Këneta (87)/.

/Symeja/. Punën nuk e bënte më duke kënduar. As *për t'u veshur nuk vishej* më me merakun e parë/ Kacori: PM (II) (14)/.

— Mua më ka zënë (ujët e kënetës, S. F.) misrin në arë. Ja ka mbuluar edhe xhufkat(...). *Për të vjelur s'e vjel dot*, plevitosh e mbytesh./ Gjata: Ujët e verdha, në PreJ (41)/.

Kozi doli jashtë, po *për të shkuar nuk shkoi* / Xoxa, LiV (II) (131)/.

Ajo njohu zërin e Leksit, por *për të parë s'pa njeri*. (LiV, II, 157).

3) Trajta e fjalës së rimarrë, trajta e foljes kallëzues, varet nga trajta në të cilin është përdorur folja në pyetjen e përmendur më përpara. Kur është folje në dëftore, rimerret në po atë trajtë kohore, por kur është folje në urdhërore, rimerret me trajtën e së ardhmes së dëftores.

a) — (..) por s'po dij a po më *ndihmoni* ndopak? (...).

— Vëlla, — ia pritën vllaznit një zani, — për me të ndihmue të *ndihmojm* gjithsi të na thuesh; por po druem, se s'na del gjâ / D. Kurti, Prralla Kombtare II (37) Gerzheta /.

— A ja *ke folur* / vajzën, S. F. / Kuma Maros?

24) Nuk është i saktë pohimi i M. Çelikut se renditja (paskajore + trajtë vetore e foljes) nuk asht element i domosdoshëm, për deri sa infinitivi në togjet e këtij tipi mund të jetë prepozitiv ose postpozitiv (v.c. f. 169). Ndër shëmbujt e M. Çelikut ka katër që kanë kallëzuesin postpozitiv dhe të gjithë janë kallëzues mohorë.. Ndër kallëzuesit pohorë ka prepozitivë, ka edhe postpozitivë.

— Për të folur ja *kam folur*, se më kish zënë ngushtë në mal. / M. Kuteli: Xinxifillua (26-27)/.

Trajta kohore e pyetjes ruhet në replikë edhe kur rimerret një folje a një togfjalësh frazeologjik me një folje sinonimike.

— Të *nxiu kurrizë* Lumo Shkurti?

— ...Për të rrahur *s'më rrahu*. Po më bëri rrezil. / Gjata: Përmbysja, II 5.

Të pyetja, togfjalëshi «nxiu kurrizë» është togfjalësh frazeologjik, sinonimik me *rrahur* (shumë, fort), megjithatë të dy foljet janë në të kryer të thjeshtë.

Varësia e trajtës kohore të kallëzuesit në replikë nga ajo e trajtës së foljes që ndodhet në pyetjen duket edhe më qartë, kur kemi pyetje në kohë të ndryshme, dhe në replikë çdo foljeje të pyetjes i jepet përgjigje në trajtën përkatëse.

Rapo: Ç'thua? e *njeh* ti këtë? E ke parë tjetër herë?

Selfo: Për të parë (.) një mijë herë e *kam parë*, po për të njohur *s'e njoh* dot! / Sami Frashëri; Besa, Përflim V (Përkthim A. Ypi) /.

b) — *Mos ia numëro* (Tirit) si ditë pune, — tha më në fund brigadier (...).

— Për të numëruar *s'do t'ia numëroj*, se ja, vura Marikën ta mbjellë edhe një herë, — tha Tana / F. Gjata: Tana<sup>2</sup> (25)/.

Ndonjëherë folja që rimerret përmbahet në mënyrë implicite në një pyetje që mund të dalë nga situata konkrete. P.sh.

/ Ndenj pastaj, si më njanë, pranë dasmorëve. /

*Për të ngrënë nuk hëngri* gjë (.) as *për të pirë nuk piu* gjë, por *për të gëzuar u gëzua* fort kur pa të rinj e pleq që lonin (valle, S. F.) me shami në dorë. / M. Kuteli: Kapllan Aga... (44) /. Situata reale, dasma, i kujton autorit parafytyrimet e të ngrënit, të pirit dhe të të gëzuarit, si gjëra të rëndomta në dasmat. Dhe ai rimerr të tri idetë me foljet «hëngri», «piu», «u gëzua». Trajta kohore e këtyre foljeve përcaktohet nga plani kohor i situatës konkrete (Ndenj pastaj...).

4) Tipar tjetër i këtij konstrukti është intonacioni: folja kallëzues ka një theks të fuqishëm, pavarësisht nga topika e saj, kurse plotësori i marrëdhënjes ndahet prej saj me pauzë, dhe pikërisht kjo pauzë dallon plotësorin e marrëdhënjes nga plotësori i qëllimit të shprehur me anën e një konstrukti me paskajore (fjalë qëllimore e pashtjellë), i cili në postpozicion nuk ndahet me pauzë.

Krahaso: «*Vajtëm për të blërë materiale ndërtimi*» dhe «*Vamë për të vatur* / po gjene u kthym».

«*Për të njohur e njoh* / po...»<sup>25</sup>.

5) Konstrukti tautologjik rëndom bën pjesë në një periudhë me fjali të bashkërenditura me marrëdhënje kundërshtore: kundërshtore kufizuese, kundërshtore-lejore ose kundërshtore-shtesore. Ai mund të përbëjë ose fjalinë e parë, «të pavarurën» e mirëfilltë ose të dytën, fjalinë e bashkërenditur. Kjo ndodh për arsye se kuptimi i theksimit që del te ky konstrukt tautologjik ka për qëllim t'i kundërvihet një thënjeje tjetër. Kjo thënje formalisht mund të mos jetë shprehur, por ajo ndodhet në situatë a në kontekst në mënyrë implicite; kjo përbën një farë elipse që lë të nënkuptohet ajo që nuk është paraqitur e plotë.

25) Shenjat konvencionale kanë këto vlera: [ ] theks i fuqishëm, [ ] theks më i dobët [ ; ] pauzë e shkurtër, [ | ] pauzë më e gjatë, «pauzë e presjes».

a) tautologjia është një fjali e bashkërenditur kundërshtore me nuanca të ndryshme: p.sh.

(Gërzheta, S. F.). Të gjitha punët i kryete pa mërzi: *por me folë me gojë nuk folte*, e gjindja e shpis bindeshin për këtë punë./ D. Kurti: Prralla Kombtare, II (38) Gërzheta/.

Kozi doli jashtë (dyqanit, S. F.), *po për të shkuar nuk shkoi* / J. Xoxe: Novela (II) (131)/.

Burrat punonin duke bërë muhabet. Gratë i dëgjonin. *po për të folur, nuk flisnin.* / Th. Kacori: P. M. (II) (38) /.

Fjalja e bashkërenditur mund të vijë edhe fill mbas pauzës së plotë (mbas pikës, në të shkruar), si një kundërvënje shtesore, ose si diçka që përbën një kumtim të ri, deri diku në një farë opozicioni me sa është thënë më sipër, si diçka që i jep ligjërimin një farë drejtimi të ri lidhur me thënjen e mësipërme:

Babalja thesh se shkënte (,) po sytë e tij të përlotur nuk na çquanin asfare. (...) *Po për të njohur Babalja na njëhte*. Na njëhte me njëto duart e tij të bymyera. / M. Kuteli: Kap. Aga, (95) /.

— *Po për të larë, kur do të lahesh në lumë?* — i pyeti me tallje Hajdari. / F. Gjata: Këneta /.

b) Konstrukti tautologjik përbën fjalinë e parë, kurse fjalja e bashkërenditur kundërshtore — fjalinë e dytë.

Për të njohur e njo / *po emrin nuk ja di* // S. Floqi, v. c. /.

— Dhët i kap me gjalosa //.

— A njallen prej saj?

— Jallen për t'jall / *po i çon n fun* (Rr) / M. Çeliku; v. c. f. 171 /.

6. Në toskërishte, «paskajorja» nuk merr treguesit e diatezës, ashtu si edhe gjymtyrë të dyta të ndryshme (kundrina ose plotësorë të rrethanës): edhe kur paskajorja prin kallëzuesin, vetëm ky i fundit merr pjesë të trajtëformuese të diatezës përsore si dhe kundrinat e plotësorët e rrethanës.

Krahasoni shembujt:

*Për të vjelur s'e vjel dot...*

*Për të ndjekur e ndoqën...* S. Andoni: Kokëkrisuri, DeÇ (44).

— *Zotrote për të ngacmuar më ngacmon*, po vicklat nuk m'i dëgjon. / Xoxa: LiV (II) (74).

*Për të njohur Babalja na njëhte...*

*Po për të larë, kur do të lahesh në lumë?*

*Për të folur spara u flisnja...*

*Për të shtënë nuk i shtinë* / Kacori: PM (I) (113) /.

*Për të numëruar s'do t'ia numëroj...* / Gjata: Tana<sup>2</sup> (25) /.

*Për të parë, një mijë herë e kam parë ...* / Sami Frashëri: Besa, përkthim nga A. Ypi /.

— A ja ke folur / vajzën / kuma Maros?

— *Për të folur ja kam folur...* / Kuteli, Xinxifillua (26-27).

Mospërdorimi i pjesëzës u te «paskajorja» është karakteristike për toskërishten e folur, dhe në gjuhën e shkruar të Sami dhe Naim Frashërit e të mjaft të tjerëve është zbatuar në mënyrë konseguente. Përdorimi i pjesëzës u te «paskajoret pësore» aty-këtu në letrarishten e sotme, është, me sa duket, një krijim i gjuhës së shkruar, jo pa ndonjë ndikim të folmeve gege, si p.sh.: *Se për t'u veshur*, nuk vishej më me merakun e parë / Kacori: PM (II) (14)/.

Ndërkaq, në të folmet e Shqipërisë së Mesme, hetuar prej M. Çelikut, ka lëkundje në përdorimin e trajtës së shkurtër të përemrit vetor

me funksionin e kundrinës; duke shqyrtuar materialin e paraqitur prej autorit, ne konstatojmë praninë e kundrinave herë vetëm te kallëzuesi, herë njëkohësisht edhe te kallëzuesi, edhe te togu i paskajores; p.sh.

Për t'shkul nuk e shkule (D.). Për t'besue m'besove / po m'plase veç (E.). Për ta vram e vrisje vet (Sh). Për t'ja huth ja huth kur t'dush (E).

Ndërsa në toskërishte përdoret «paskajorja toske» («për + emër asnjane i pashquar», sipas të tjerëve) dhe në Shqipëri të Mesme, sipas M. Çelikut, po kjo trajtë, në gegërishten veriore përdoret «paskajorja» gege: «me + pjesore» ose «për + me + pjesore», P.sh.

— (...) por s'po dij a po më ndimoni ndopak...

— Vëlla, — ia priten tre vllaznit një zani, — *per me* të ndimue të ndimojm gjithsi të na thuesh; por po druem, se s'na del gjã. / Kurti, PK (II) (37), Gerzheta/.

/Gerzheta/ Të gjitha punët i kryete pa merzi; por *me folë* me gojë nuk folte, e gjindja e shpis bindeshin per ket punë. / Kurti, PK (II) (38), Gerzheta/.

— Mos e mbytni (ujkun) aman! — bërtet dhelpna prej së largut. Falsa të shkretit jetën. Në daç repnie per së gjallit, por *me e mbytë* mos e mbytni! / D. Kurti: PK (I) (31-32)/.

Por midis konstruktit me «paskajoren toske» dhe atij me «paskajoren gege» ka një ndryshim sintaksor: ndërsa nga paskajorja toske nuk varet ndonjë fjalë, nga paskajorja gege varet kundrina ose «plotësori i mjetit» siç shihet të shëmbujt e mësipërm (me të ndihmue; me e mbytnë; me folë *me gojë*), kështu që këtu të njëjtat përemra me të njëjtin funksion janë përsëritur pranë të dy trajtave foljore. Në toskërisht dhe në gjuhën letrare kjo ndodh vetëm pranë trajtës vetore.

Ndonëse ky konstrukt tautologjik ka një dozë frazeologjizmi, prapëseprapë mund të shohim një veçim gjymtyrësh në pjesët përbërëse. Shpjegimi që u jep A. Gvozdevi konstrukteve adekuatë të rusishtes mund t'i përshtatet fare mirë edhe atyre të shqipes. Po e citojmë në përkthimin tonë: «Folësi në fillim mbas bashkëfolësit, e ripërmend (vosproizvodit) foljen në paskajore, duke ndjellë kështu parafytyrimin për atë veprim dhe pastaj e përdor po atë folje në trajtën e duhur për të shprehur një pohim, një të qenë dakord me një situatë ose me një fakt të caktuar, të parashtruar nga bashkëfolësi, dhe pas kësaj (me lidhëzat *no, da* (= shqip *por*) folësi shtie një farë kufizimi në pohimin dhe këtij i kundërvihet pohimi vehtjak i folësit»<sup>26</sup>.

### I. 3. 2.

Konstrukti tautologjik «kallëzuesor-plotësor i marrëdhënjes» përdoret në dialog (si dhe në rastet kur monologu ka tiparet pyetje-përgjigje të dialogut) në stilin e folur të ligjërimit.

Ky konstrukt merr shkas nga një kallëzuesor i një kallëzuesi emëror të përdorur prej bashkëfolësit (ose nga një pyetje e brendshme e vetë folësit në monolog). Kallëzuesori gjymtyrë e tautologjisë përsërit «kallëzuesorin e pyetjes», dhe e shoqëron me parafjalën *për* ose e le pa parafjalë, por me funksionin sintaksor të plotësorit të marrëdhënjes, (duke lënë më njanë foljen këpujë «jam»).

26) A. H. Гвоздев, Очерки по стилистике русского языка, Москва, 1952, f. 195

Rendi i gjymtyrëve është i ngurosur: në krye plotësori i marrëdhënjes, pastaj kallëzuesori.

Kallëzuesori dhe plotësori i marrëdhënjes shprehen rëndom me emër e me mbiemër.

**I. 3.2.1.** Kur kallëzuesori i tautologjisë shprehet me emër ose mbiemër, plotësori i marrëdhënjes shprehet me po atë emër ose mbiemër me parafjalën për.

— Pa të del aty një erë që ta shuan pishën.

— Ja? Kaq e fortë? — pyeti dikush.

— *Për e fortë e fortë*, po edhe e rëndë. / M. Kuteli. Kap. Aga (21)/.

Më shpesh kallëzuesori emër dhe mbiemër përdoret në prepozicion pa parafjalën për.

— Jemi mbretëri, kemi mbret!

— *Mbret mbret*, po si u bëhet halli qepëve të mia?

Më mbetnë në dorë. / Kuteli: «Një natë tetori» «Nëndori», 7. 1962 (56)/.

— Ç'je ti?

— Njeri, si më sheh.

— *Njeri njeri*, po si e qysh?

— Jam Xoxi. (...) / M. Kuteli: Kap. Aga (34)/.

— Mor po kryetar i këshillit popullor je, apo kryetar i këshillit antipopullor! — ja ngjeshi me të qeshur majori / Jani qimekuqit S.F. / Kjo fjalë i dogji Janit:

— Të lutem, Llazi, *shaka, shaka*, po shakaja ka kufi / S. Spasse: Buzë liqenit (243)/.

Më thoshte: Po ato, si i lënë prindërit vetëm, a nuk janë vajza ato?. *Vajza, vajza*, po njeriu bëhet me cen kot / Elena Kadare: Shuaje dritën, Vera, «Nëndori» 1965, Nr. 1 (17)/.

*E kripur / e kripur* (gjella) / po ti e hangre ama! / J. Thomaj, v.c. (137)/.

Rendi i gjymtyrëve të tautologjisë në rastin e kallëzuesorit të kallëzuesit emëror ose të kallëzuesorit të kundrinës është i ngurosur: në krye plotësori «i marrëdhënjes», pastaj kallëzuesori. Kjo ndodh për arsye se folësi rimerr në replikën e vet kallëzuesorin e përmendur nga bashkëfolësi, duke e theksuar më tepër nëpërmjet të anticipimit; konstrukti tautologjik, përsëritje dyfishe e po asaj fjale, është gjithmonë në opozicion me një thënje kundërshtore që pason.

Vlera e konstruktit tautologjik është po ajo që shqyrtuam në pikën I. 3.1. (shih më sipër): theksim i tiparit të kallëzuesorit dhe kundërvënje e tij ndaj një thënjeje tjetër në planin kufizues.

**I. 3.3.** Nga gjithë parafjalët ose lokucionet parafjalore që përdoren në ndërtimin e plotësorëve të ndryshëm «të marrëdhënjes» në shqipen dhe në rumanishten si «për» (*de, pentru*), «në» (*in, la*) «sa për» (*cît pentru*), «në lidhje me» (*in privința, relativ la*) «nga pikëpamja e» (*din punctul de vedere*), etj. në plotësorin e marrëdhënjes që është gjymtyrë e një konstrukti tautologjik përdoret vetëm parafjala për në shqipen dhe *de* në rumanishten si gjerësisht popullore.

Në rumanishtet plotësori i marrëdhënjes shprehet:

a) me një folje në supin (që i përgjigjet «paskajores toske»).

➤ De băt, bei mereu sau numai așa la sərbători. / Tudoran, GLR,

II (416)/.

Për të vatur / vanë / po...

b) me një folje në *Infinitiv* (që i përgjigjet «paskajores geqe»).

De numele d-tale am auzit,

dar *a vedea* nu te-am *văzut* / GLR II (193) /.

(Për) Me vojtë do të vete / por tash s'mundem.

3) me një emër të prirë ose jo nga parafjala *de* (shqip *për*)

*De ghume! ghume!* era moș Nichifor, nu-i vorbă: / Creangă. / GLR, II (417).

*De frate, frate* să-mi fii, dar la noi mai rar să vii / Ipann GLR, II (195).

*Frate, frate*, dar pita-i cu bani, bărbate / Po ai, aty (415).

*Vëlla vëlla*, po qesja në mes / Kuteli: Xinxifillua (14)/

4) me një mbiemër me parafjalën *de* (=për) ose në rast elipse, pa parafjalë:

*De frumoasă, ești frumoasă,*

Dar la nu Ț-o Țtii coasă / Jarnik-Birseanu, GLR, II, (416).

*Për trim është trim*, por...

Oslobanu *prost, prost*, dar să nul atingă cineva cu cît e negru sub unghie, ca-și azvirle țarna după cap ca buhaiul. / Creangă, GLR, II (403)/.

I varfër / i varfër ai / po e bëri shtëpin goxha. / J. Thomaj, v. c. (137).

*Scăpătat, scăpătat*, dar vād că n-a rămas fără cheag / Tudoran (GLR, II, 416)/.

Si në shqipet, edhe në rumanishten tautologjia është në opozicion me një fjali të bashkërenditur kundërshtore me lidhëzën *dar* (shqip *po, por*).

Gjithë elementët strukturorë dhe kuptimorë janë të njëjtë në të dy gjuhët: rendi, intonacioni, mundësia ose jo e elipsës etj. Në këtë konstrukt tautologjik shqipja dhe rumanishtja kanë një ko incidencë të plotë.

## II. Konstrukte tautologjike në periudhë

Rëndësi kryesore strukturorë në këto konstrukte tautologjike kanë mjetet e lidhjes, dhe prandaj klasifikimin e tyre po e bëjmë mbi këtë bazë. Elementet e tjera të strukturës do të jepen për brenda çdo klasifikimi gjithashtu dhe vlera e konstruktit, kushtet e përdorimit etj. Në rast se mjeti i lidhjes është intonacioni, konstruktet do të jepen mbi bazën e tipit intonacionor të «periudhat asindetike».

### II. 1. Konstruktet tautologjike me përemrin kush

Dallohen dy grupe kryesore:

**II. 1.1. Grupi i parë** përfshin ato periudha që kanë fjalinë e varur kryefjalore në prepozicion, theksa të njëjtë mbi foljet kallëzues, pauzë të ndijshme midis fjalive, melodikë ngjitëse-zbritëse.

Konstrukt i tautologjik ka vlerë kushtore me nuancën e theksimit të kallëzuesisë dhe ka lidhje drejtpërdrejt me periudhat me fjali të varur kryefjalore që kanë vlerë kusht-pasojë dhe bashkohen me përemra të pakufishëm.

— Dhe ti Pucelli, ç'ua var kaqë torbën. Ti vazhdoje / tregimin, S.F. / *Kush dëgjon, dëgjon!* Ti e thua për shokët që nuk e kanë dëgjuar! / P. Marko: *Hasta la vista* (70) /.

Mënyra më e përdorshme e foljeve-kallëzues është dëftorja: koha e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e kryer. Përdorimi i lidhore (rëndom koha e tashme) jep kuptimin e eventualitetit, mundësisë.

Kush di, di.

*Kush merte merte; kush mbetej mbetej.*

*Kush ka mësuar gjer tani, ka mësuar; kush s'ka mësuar, s'ka ç'bën.*

*Kush është trim, është trim.*

II. 1.2. Grupi i dytë dallohet për këto karakteristika: Rendi i anasjelltë i vendosjes së fjalive shoqërohet edhe me ndryshime të tjera strukturore dhe kuptimore: melodikë ngjitëse, e cila mund të mbetet e pambaruar, ndërsa konstruktin tautologjik e pason një fjali tjetër, rëndom e bashkërenditur; pauza midis gjymtyrëve mungon krejt, ritmi është i shpejtë, mbi foljen e dytë bie një theks mjaft i fuqishëm, zanorja shqiptohet disi e zgjatur, toni është eksklamativ retorik. Në të shkruar gjymtyrët e tautologjisë nuk duhen ndarë me presje.

— Nuk i ka fajet fabrika! — i përgjigjej një zë burri.

— Po kush?

— *I ka kush i ka!*

— Gjeje, pra, fajtorin!

— Do ta gjejmë / A. Abdihoqha: Tri ngjyra të kohës, «Nëndori», 1963, Nr. 8, f. 41.

— Sa mirë! E paskeni shpëtuar!

— *More e shpëtoi kush e shpëtoi* atë. /Marko: Hasta la vista (6)/.

Nëpërmjet mospërcaktimit të kryefjalës (*kush*) dhe në raste të tjera të pronarit kallëzuesor (*i, e kujt*), të kundrinës (*kë*) të shprehur si objeksion ndaj kryefjalës, pronarit, objektit, arrijmë te pohimi se përkritazi si subjekte të veprimit, si pronarë, kallëzuesorë a si objekte nuk janë ata që pandehen prej bashkëfolësit, po të tjerë persona a sende.

— Ja ardha edhe unë të marr do-një mincë këtu, se paska shumë.

— Këtu ka (,) po janë të kujt janë e jo të tuat. / Kuteli: Kap.Aga (34)/.

— Ai ka marrë, më duket, vajzën e madhe të Vangjelit.

— Jo, jo, ai *mori kë mori*.

Në rumanishten ekzistojnë të dy tipet e konstrukteve tautologjike me përemrin *cine* (*kush*). Në të dy gjuhët ka një korespondencë të plotë strukturore dhe kuptimore. P.sh.:

1) *Cine-i om, este om,*

2) *Basmuri o fi știind cine o fi știind,*

dar eu nu știu. / Gr. si S. III, 161; V. Guțu — Romalo, v.c. (487)/

## II. 2. Konstruktet tautologjike me përemrin pyetës se

Konstrukti tautologjik ka të njëjtën vlerë si më sipër (II.1.2.) edhe kur bashkohet me përemrin *se* (*nga se*) me funksionin e plotësorit të vepruesit ose të shkakut.

«*Telua u shtrëngua, nga se u shtrëngua*, që u fut në kooperativë, — thoshte ajo; ndryshe s'i mbushej mëndja!» / Musaraj: Të shkuara... (58)/.

Në gjuhën e folur mund të përdoren edhe mjete të tjera lidhëse me përemrin pyetës *se*, i cili sot përdoret vetëm në trajtat e ngurosurave me parafjalë *me se, për se, prej se* etj., por në materialet tona nga lehtësia nuk figurojnë shembuj.

Këtu, çeshtja mbetet për ne akoma e hapur, ashtu si dhe për rumanishten.

### Konstrukte tautologjike me përemrin ç

**II. 3.** Fjalitë gjymtyrë bashkohen me përemrin e pakufishëm ç (edhe *çka*, *shka* për gegërishten).

Konstruktet tautologjike të bashkuar nga përemri i pakufishëm ç tregon papërcaktueshmi nga pikëpamja e sendit ose e tiparit: kuptimin e papërcaktueshmërisë e jep përsëritja e së njëjtës folje, ndërsa atë të sendit a tiparit e jep përemri i pakufishëm ç, në pajtim me kuptimin leksikor të foljeve.

Gjymtyra e dytë e tautologjisë së bashku me përemrin ç mund, të jetë «fjali kryefjalore» «fjali kundrinore» ose «fjali kallëzuesore» simbas vetive strukturore të fjalisë kryesore, d.m.th. simbas funksionit të gjymtyrës «mungesore» që zëvendëson.

Veç kësaj ka kufizime leksikore edhe për rrethin e foljeve të përdorura. Ka edhe ndryshime nga rendi i përemrit ç: ky mund të ndodhet midis dy gjymtyrëve të tautologjisë ose mund të hapë periudhën.

**II. 3. 1.** Konstrukti tautologjik i modelit «u bë ç'u bë» ka gjymtyrë të kufizuar nga pikëpamja leksikore: këto janë folje me kuptimin leksikor të të *ndodhurit*, të *ngjarit*, ndër to ka jokalimtare (*është*, *ngjan*), kalimtare pësore (*bëhet*), kalimtare veprare (*gjen*).

Topika e përemrit ndaj foljeve gjymtyrë tautologjike është i ngurosor: përemri ç (*çka*, *shka*) ndodhet midis foljeve. Në përgjithësi fjalitë gjymtyrë tautologjike përdoren pa gjymtyrë të dyta, përveç rastit me foljen *gjen* që kërkon domosdo kundrinën e drejtë në trajtën e shkurtër të përemrit vector (më, të, e, na, ju, i *gjeti*) ndërsa emrat si kundrinë nuk përdoren përbri tyre.

Konstrukti tautologjik shqiptohet me një theks më të fuqishëm te gjymtyra e parë, ritmi është disi i shpejtë, midis gjymtyrëve nuk bëhet pauzë, (dhe nuk duhet presje në të shkruar), në fund të togut tautologjik intonacioni mbetet i pambaruar, pezull në një notë relativisht të lartë, bëhet një pauzë paralajmëruese që tregon se do të kemi një fjalë tjetër; dhe në fakt, pason një fjalë e bashkuar asidentisht me konstruktin tautologjik.

«U bë ç'u bë, ngrehu tani», mund të paraqitet në mënyrë të thjeshtuar:

*U bëçubë / ngrehu tani* (ku [ ē ] tregon theks më të fuqishëm, [ é ] theks të rëndomtë dhe [ / ] — pauzën).

[Rina dhe Vitoja janë babanjosur nga të qarët (...); mundohen të ngushullojnë babanë e tyre, që është shtrirë te dera e jashtme e duket sikur ka përqafular prakun].

— *U bë (,) ç'u bë*, baba, ngreu tani të shkojmë, mbaje vehten. / S. Spasse: Ata nuk ishin vetëm/.

I bajn rixha (daci) mit tjerë si «na fal ket shokun ton, a ba ç'a ba, tesh edhe po shkon e po bahesh haxhi e na fal shokun ton!» / J.U. Jarnik: Daci edhe mit, Mbledhes, (I) (362)/.

— Mos thirrë, ... të *gjeti ç'të gjeti*, mos thirrë, se do marrë vesh fshati. / S. Andoni: Natën nëpër rrugët e luftës, Tregime nga Morava (88)/.

Konstrukti tautologjik ka vlerë përgjithësuese, të barasvlershme me fjalën «çfarëdo» me nuancë lejimi, d.m.th. se pavarësisht nga ato që

kanë ndodhur duhet të merret parasysh kërkesa e shprehur në fjalinë që pason konstruktin. Vlera e lejimit, mund të theksohet më tepër nga vlera gramatikore e mënyrës lidhore, e cila mund të ketë edhe pjesëzën *le*.

— *Të ngjasë ç'të ngjasë*, unë nuk kam të drejtë të kthehem / S. Andoni: Natën nëpër rrugët e luftës, Tregime nga Morava (88) /.

«*Të bëhet ç'të bëhet* — tha, e zemra i rrihte si e zogut. — Do të hipin gjer te dritarja. / Th. Kacori: Për mëmëdhenë (II) (229) /

— *Të bahet çka të bahet*, — tha, pa e hangër do rrush s'po mund të pritem. / D. Kurti: apud: S. Prifti: Sintaksa e gjuhës shqipe, pjesa II (285) /.

— *Të bëhet ç'të bëhet!* S. Spasse: Buzë liqenit (347)

/ Shtëpia / Mund të rrezohej nga tërmeti. (...) Mori batanijen e jastëkun dhe me vrap hyri prap në shtëpi.

— *Le të bëhet ç'të bëhet*: Do fle në krevatin tim. / D. Agolli: Përpara bukurisë, «Drita», 4 prill 1965, fq. 3, shtylla 2-3 /.

Në vend të lidhores, në të folme të gegërishtes mund të përdoret si gjymtyrë e tautologjisë edhe paskajorja geqe e «së tashmes».

«— *Me kenë ç'me kenë* — i a priti vllau — s'po le pa ta pru edhe tamblin e nanës së Tokshit. / D. Kurti: Pralla kombtare<sup>2</sup> (II) (91) /

\* **II.3.2.** Konstrukti tautologjik me përemrin e pakufishëm ç (gg. *çka* a *shka*) në prepozicion (Ç+F+F), ndryshon nga pikëpamja strukturore prej konstruktit të mësipërm jo vetëm për vendin e përemrit, por edhe për theksat e njëjtë mbi dy gjymtyrët e tautologjisë, për pauzën e domosdoshmë midis tyre dhe për ritmin më të ngadalshëm të shqiptimit: Tipi: *ç'u bë, u bë* shqiptohet: *ç'u bë / u bë*. Midis gjymtyrëve duhet përdorur domosdo presja.

— Pupu! ç'më gjeti mua të zezën!

— *Ç'të gjeti, të gjeti*: mos shtjerë të keqtë tani / Bisedë /.

— *Shka ka kenë* (.) *ka kenë*: venju kapak punëve të kalueme/ J. Rrota: Rreth votrës (46) /.

Vlera e këtij konstrukti tautologjik ka ndryshim nga ajo e pikës II. 3. 1.: theksohet më tepër karakteri i pandryshueshëm, irrevokabël i ndodhisë, d.m.th. se ç'ka ndodhur nuk mund të ndreqet, por ndodhia, që njihet tashmë nga konteksti i mëparshëm a nga situata, shërben si motivim për urdhërin e shprehur në fjalinë që pason konstruktin tautologjik. Fjalja bashkohet me konstruktin aksidentikisht dhe tregon konkluzionin. Kallëzuesit janë folje që tregojnë të ndodhur, të ngjarë («jam», «gjej», «bëhem»).

**II.3.3.** Me foljen këpujë *jam* në fjalinë kryesore, fjalja e varur është kryefjalore. Konstrukti tautologjik thekson karakterin e vërtetë të tipareve.

*Ç'është e vërtetë, është e vërtetë* / Bulka Skica dhe tregime.

*Ç'është e mirë, është e mirë*.

**II. 3. 4.** Kur fjalja e varur është postpozitive dhe fjalja kryesore ka si element të strukturës një përemër dëftor substantiv (ky, kjo, ai, ajo) në funksionin e kryefjalës dhe kallëzuesit emëror me këpujën *jam* i mungon kallëzuesori, fjalja e varur është kallëzuesore.

/ Filozof është ai / kalamani /edhe nga mëndja.

Po shyqyr, thuaj, që nuk i ndodhi gjë mbrëmë/. **Ajo do ish ç'do ish** / Musaraj: Para agimit (I) 357) /.

Konstrukti tautologjik shqiptohet me eksklamacionin e habisë dhe kallëzuesit e fjalive përdoren rëndom në trajta të habitores. P.sh.:

**Kjo qënka ç'qënka**, — thoshte Shemja, kur i binin kokës me kritikë për punët e këshillit që nuk shkonin mirë në fillim / Musaraj: Të shkuara... (77) /.

— Bo, bo, bo! **këta qënkan ç'qënkan!** Ua kaluan edhe halldupëve! / Kacori: PM (II) (99) /.

Fjalja e varur është përsëri kallëzuesore edhe kur kryen funksion të ngjashëm me atë të një plotësori kallëzuesor të kundrinës pranë foljesh vlerësimi të tilla si folja *them*: p.sh.:

Ta presësh nga s'e pandeh, **kësaj i thonë ç'i thonë**. / Sinaeri: Historia e një tregimi, në Kokrra aguridhe (31) /.

Me këtë konstruktit tautologjik theksohet shkalla e tiparit a intensiteti i veprimit, duke u vënë në dukje njëkohësisht qëndrimin i ntelektual ndaj tiparit, rëndom habia. ndonjëherë intonacioni mund të tregojë një qëndrim emocional si pakënaqësi, mërzë etj.

Një rol shumë të rëndësishëm luan intonacioni i këtyre konstrukteve: intonacioni ka një nuancë të theksuar eksklamative.

## II. 3. 5.

Konstrukti tautologjik *Marr ç'marr* dallohet për këto veçori:

1) Foljet kanë kufizime brendakategoriale; ato janë domosdo kalimtare veprare;

2) Konstrukti pasohet nga një fjali tjetër:

a) nëpërmjet të lidhjes bashkërenditëse këpujore pohore (me shpesh lidhëza *e*; më rrallë lidhëzat *dhe*, *edhe*);

b) nëpërmjet të lidhjes asindetike.

Gjymtyra e përsëritur së bashku me përemrin e pakufishëm ç (dhe variantet e tjera dialektore) përbën një fjali të varur kundrinore të tipit përemëror jokorelativ; fjalja e varur tregon papërcaktueshmi të veprimit nga pikëpamja e objektit të drejtë (kundrinës së drejtë), *marr ç'marr* është baraz me *marr diçka*)\*.

Kur pasohet tautologjia nga një fjali e bashkërenditur me lidhëzën *e*, i gjithë konstrukti tregon se një veprim i papërcaktuar nga pikëpamja e kundrinës së drejtë *pasohet* nga një veprim tjetër. P.sh.:

*Bleva ç'bleva e ika.* /

*Mora ç'mora e dola jashtë.*

Në rast se gjymtyrët e tautologjisë janë në të tashmen dhe në të pakryerën, atëhere përdorimi i po asaj trajte kohore të folja kallëzues e fjalisë së bashkërenditur tregon se veprimi i papërcaktuar nga pikëpamja e kundrinës përsëritet *duke alternuar* me veprimin tjetër.

\*) M. Çeliku (175) nuk e përcakton dhe aq saktë vlerën e konstruktit, ai thotë se kjo papërcaktueshmëri konsiston në *praninë e volumit të veprimit* (nënvizuar prej meje, S.F.) krahas me «moscilësimin e objektit të veprimit». E drejtë është me siguri vetëm pjesa e dytë e përcaktimit të vlerës «moscilësimi i objektit të veprimit», sepse një nga shembujt e shqyrtuar prej tij (vrau ç vrau / ime s'po nihet ma (Rr.)) mund të interpretohet në radhë të parë vrau ato që vrau (b.f. lepuj, thëllëza etj.), ndërsa interpretimi «vrau sa vrau» është mbishtruar mbi kuptimin objektor; mirëpo përcaktueshmia nga pikëpamja sasiore shprehet enkas me fjalën *sa* dhe jo me përemrin ç.

/ Fshatarët / *Merrnin ç'merrnin* dhe, duke u sulur, bënin tatëpjetë / Kacori: Për mëmëdhenë (II) (60) /.

Kur gjymtyrët e dytë të tautologjisë janë në dëftore, veprimi jepet si real, por, kur janë në lidhore, shprehin mundësi, eventualitet.

*Merr ç'të marrësh*, e mos u vono.

— Le tua lemë në dorë këtyre, socialdemokratëve, që i kanë akoma dy para vere; të nxjerrin *ç'të nxjerrin* këta nga komunistët, fitim e kemi. / Musaraj: Para agimit (I) (489) /.

**II. 3. 5. 1.** Folja *bëj*, në sajë të kuptimit të përgjithshëm (të gjerë) leksikor, mund të mos tregojë në një kontekst të caktuar domosdo veprim konkret kalimtar, por edhe një veprim çfarëdo (zaten edhe veprim moskalimtar, të barasvlershëm në bazë të situatës me folje të tilla si *hyj*, *dal*, *flas* etj.) dhe në këtë rast, nëpërmjet të një farë tejsemantizimi të saj, mund të arrijë të tregojë jo më një veprim konkret të papërcaktuar nga pikëpamja e objektit, por edhe një veprim të papërcaktuar, të papërmendur fare edhe si veprim konkret, baraz me «veproj». Foljet gjymtyrë të tautologjisë janë në të tashmen dhe në të pakryerën, me këtë tregohet se veprimi i shprehur nga folja-kallëzues, e bashkuar me lidhëz këpujore ose asidentisht, përsëritet pa ndonjë rregullësi intervali (kohë pas kohe).

Muço Qinani *bënte ç'bënte dhe thoshte*: «Ne paskemi zbritur në veri, bre! (Kacori: Për mëmëdhenë (II) (183) / (d.m.th., thoshte kohë pas kohe).

Zoti Uran Roma, *bënte ç'bënte*, nxirrte nga xhepi i jelekut orën me atë qostekun e artë të këputur dhe e shikonte. Herë i dukej sikur ora po kalonte shpejt, herë po mbetëj në vend. (d.m.th. nxirrte kohë pa kohë).

Konstrukti tautologjik me foljen *bëj* në të tashmen ose në të pakryerën e dëftores ka karakter frazeologjik dhe shërben për të treguar *aspektin përsëritës sporadik* të veprimit të foljes pasuese. Në trajtat e tjera kohore folja *bëj* nuk ka karakter frazeologjik.

**II. 3. 5. 2.** Foljen *dij* si gjymtyrë të konstruktit e kemi ndeshur një herë vetëm, nën penën e një shkrimtari që e ka ditur shumë mirë rumanishten dhe që ka jetuar gjatë në Rumani. Kjo na shtie në mend dyshimin se është kalkuar shprehja përkatëse rumune. Krahasoni: Ia lăsamă jupineasă, cu cărțilë cele a d-voastră, în pace; *că eu știu ce știu eu*. Creangă, GRL, II (416) dhe «Rogostari i le të thonë ç'të duan e s'bën zë: *ay di ç'di* e s'i bëhet von për fjalët e botës. / M. Kuteli: Xinxifillua (139).

**II. 3. 5. 3.** Konstrukti tautologjik i sajuar nga përemri i pakufishëm ç e nga përsëritja e trajtës të së kryerës së thjeshtë të foljes *shoh* në vetën e tretë njëjës e shumës, (kurse me vetat e tjera nuk përdoret) ka një dozë të shëndoshë frazeologjizmi. Folja «shoh» në këtë rast nuk tregon të perceptuar me shqisën e të parit, por të konstatuar me arësyetim, të bërë të ndërgjegjshëm, të kuptuar; konstrukti pasohet nga një fjali bashkuar asidentisht (rrallë me lidhëz bashkërenditëse këpujore):

— Hajde, mori grua! ngreu t'u këndojmë një herë këtyre agallarëve, se plasa!

— I i i, ja bëri ajo me zë të hollë, i i i mor imzot, si ardhkam unë në mes të burrave! Haj më mirë ti në qoshe.

*Pa ç'pa* ky Xoxi, u ngrit e shkoi ne djepra me gjith raki /Kuteli: Kap. Aga, 24/.

Kur pa Xoxi se e shoqja nuk donte të vinte në mes të burrave, u detyrua të ngrihej e të shkonte te djepja; këtu konstrukti «pa ç'pa» do të thotë «kur pa» a «siç pa» a «me qenë se pa» domethënë «si e kuptoi se nuk mund të bëhej ashtu siç dëshëronte ai», u detyrua të vepronte ndryshe.

Me konstruktin tautologjik «*pa ç'pa*» (shumës «*panë ç'panë*») tregohet se konstatimi me arësyetim, të kuptuarit e pamundësisë për të vepruar sipas dëshirës së subjektit e detyron këtë, kundër vullnetit të vet të veprorë në drejtimin e treguar nga folja që pason konstruktin; konstatimi i pamundësisë për të vepruar sipas dëshirës së vet shërben si motivim i veprimit të kryer më pas, prandaj gërshetimi i kuptimit leksikor (shoh = kuptoj) me kuptimin gramatikor të trajtës së kryer të thjeshtë (veprim i kryer në të kaluarën, që prin një veprim tjetër dhe që në sajë të bashkëlidhjes me situatën e motivon atë, bëhet shkak për veprimin e dytë), arrin t'i japë konstruktit tautologjik vlerën «me qenë se pa, me qenë se kuptoj», por me një nuancë ekspresive të theksuar.

E mbreti, *pa ç pa*, nga e keqja, e striksi këtë kuvënd, edhe ia dha fjalën e tija /Th. Mitko: Djali i mbretit dhe mjeku, Bleta shqiptare/.

Kur pastaj /*pa ç pa*/ na /i tha/ paratë/ S. Floqi, Pg. v.c./.

— Basho Grigor, ma vështro një çikë vajzën, sa të vete një vrap në shtëpi. . .

Vajz' e Lenos e nisi avazin (=filloi të qajë me të madhe), veshë të kishë ta dëgjoje. *Pa ç'pa*, basho Grigori, e mori në duar dhe zuri ta përkëdhelë /Z. Sako: Bereqeti, 26/.

Më të afruar të mezit të natës, . . . na u bë sikur dikush trokiti aty, te porta e madhe e manastirit.. Dhjaku im, plakur në këto vise, *pa ç'pa* u ngrit si me përtesë dhe zbriti t'i hapë portën udhëtarit... / J. Xoxa: LiV (II) (10)/.

Pastaj /koloneli Cipuros/ u hyri fshatrave të krishterë dhe u kërkonte të dhjetën. . . Fshatarët s'dinin nga t'ia mbanin. *Panë ç'panë* shitën bukën e gojës për të larë të dhjetat /Th. Kacori: Për mëmëdhenë (II) (97) /.

Qetësia u prish. Duhej të fitonje me kokë në torbë. *Panë ç'panë* të dy vllamërit, sa të vihej qetësia, (vendosën) të tërhiqeshin në fshatin e tyre /Spasse: Afërdita përsëri në fshat, I /.

Te shembulli i mëposhtëm duket qartë ndryshimi midis foljes *pa* (= perceptoi me të parë) dhe kuptimit të konstruktit tautologjik *pa ç'pa*:

/Kozì priste të largohej qahjaj, S.F. /Po qahjaj kish ngulur këmbë në ledh të arës dhe s'lëviste nga vendi. Kur *pa* Kozì tek vetulla e djathtë e qahjajt po ulej e po ngrihej. . . e kur dëgjoji të rrahurën e kamzhikut prej meshini në qillotat e kadifenjta, *pa ç'pa*, mori hostenin, shkoj qetë në kular dhe pa thënë gjë, çpoi kazilin që të mirrte më të mëngjër e drejt konakëve të beut. . . /J/Xoxa: LiV (II) (119).

Më rrallë konstrukti tautologjik pasohet nga një fjali e bashkërenditur këpujore (lidhëzat *dhe, e*):

. . . /Resultit/ për shtëpinë prapë nuk i arrinin /të hollat/ *Pa ç'pa* e u dha Liçollarëve një copë korije. . . /Th. Kacori: Për mëmëdhenë (II) (10)/.

— O shok! O shok! A është drejtori aty? A ka vënd për të fjetur? — e pyeti shoferi, po zëri i ngjirur u përgjigj:

— Çfarë shoku, more kopila! Hajt sikter! Më prishtë rehatin, që u prishçi nga mëntë!

*Panë ç'panë* dhe u këthyen në maqinë. Fjetën atje. . . /F. Gjata: Këneta/.

Në rumanishte gjymtyrët e tautologjisë bashkohen nga përemri *ce* (= shq. ç) në prepozicion ose në interpozicion.

Kur periudha fillon me përemrin *ce* me funksion kryefjale të së varurës dhe kallëzuesit janë emërorë, ajo pasohet si dhe në shqiptet nga një fjali asidentike me funksion përqasor. Vlera e tautologjisë është si në shqipe: theksim i tiparevet të gjymtyrës së parë.

*Ce-i frumos e frumos*, orice ai spune. /GLR, II (416) /.

*Ce-i tinër; tot tinër* it'i vine a te juca, jupineşică. / Creangă /.

Të njëjtin konstrukt dhe vlerë kanë si dhe në shqipe konstruktet me foljen kalimtare veprorë *bëj*; këtu përemri s'mund të zërë veçse pozicionin midis fjalive.

Krahaso: *Bëra ç'bëra* dhe... (me foljet në të kryer të thjeshtë, me vlerën e aoristit dhe trajtën e përfektit rumun me vlerën e aoristit).

*Am făcut ce -am făcut* şi am obţinut liberarea tînărului / Caragiale, GRL, II (415) /.

Ashtu kursari *bëri çë bëri* e e kapëtoi lumënë (...) G. Mayer Albanesische Studien. Mbledhës... (466) /.

Për konstruktet e tjera shqipe me përemrin *ç* nuk njohim konstruktet koresponduese në rumanisht me përemrin përkatës *ce*.

#### II. 4. Konstruktet tautologjike me përemrin lidhor që

Fjalitë e varura përcaktore të bashkuara me kryesoren me anën e përemrit lidhor *që* mund të marrin përmbi funksionet e përcaktimit nuanca të ndryshme rrethanore, ndër të tjera edhe një nuancë lejore<sup>27</sup>. Nuanca e lejimit vjen nga korelacioni i brendive reale të fjalive që përbëjnë periudhën dhe gjejnë shprehjen e tyre te disa tipare të veçanta, siç janë funksioni shtjellues i së varurës përcaktore, topika e saj interpozitive, intonacioni (sidomos melodika dhe një theks më i fuqishëm te gjymtyra më kuptimplote e saj) dhe prania e pjesëzës përforcuese *édhe* në fjalinë kryesore. Këto të gjitha janë tipare karakteristike të periudhës me fjali të varur përcaktore me nuancë lejore. Si antecedent mund të përdoret vetëm emri ose përemri vector (përemrat dëftorë, nuk përdoren si antecedentë të një fjalie përcaktore me nuancë lejore, sepse në këtë rast fjalia e varur është përcaktore e mirëfilltë — përcaktore kufizuese — dhe nëpërmjet të konkretizimit të përemrit dëftor arrin të luajë funksione të ndryshme sintaksore si atë të një kryefjale, të një kundrine, të një kallëzuesori të zgjeruar etj.).

Fjalia e varur bashkohet nëpërmjet të fjalës *që*, e cila është përemër lidhor e jo lidhëz. Është përemër lidhor, sepse ndjehet paralelizmi midis tij dhe përemrit *i cili* si kryefjalë (ndonëse shumica dërmuese e rasteve i takojnë vetëm përemrit lidhor *që*, *gg*, *qi* dhe në materialet që disponojmë kemi vetëm një rast kur përcaktorja me nuancë lejore është bashkuar me kryesoren nëpërmjet të përemrit lidhor *i cili*).

Shembuj me fjali të varur përcaktore me nuancë lejore:

a) antecedenti është emër:

Shumë herë dhelpra, *që është aqë dinake*, zihet për katër këmbësh. /Th. Mitko: Bleta shqiptare/.

Ajo zemër e fortë ushtarake, *qi nuk dridhej përballë të sa heshtave*

27) Më gjerë e kemi trajtuar në monografinë e pabotuar *Periudha me fjali të varur përcaktore në shqipen e sotme* fq. 180 vv. të punimit të daktilografiar.

e shpatave armike, u dridh e rrahu me hov të turrshëm. /N. Nikaj; Bukurusha, in: ShkeRr (242)/.

— Tashti qen, sill pragun!

— Edhe delja që s'ka brirë nuk duhet ngarë o bej!. /S. Andoni: TreNgam (64) /

b) antecedenti është përemër vetor:

Bukurusha nuk duel ma jashtë (. . .). **Ajo qi deri m'at herë nuk kishte dijtë kurrë me derdhë lotë, për çfarëdo ngushtice** nisi m'u ndrydhë në vaj. /N. Nikaj; Bukurusha, in: ShkeRr (223)/.

Lajma e prishjes së Balshit i arriu Skënderbeut natën pas betejës së Oranikut. Me vrap u kthye përpara Danjës, dhe **ay, i cili e kish qërtuar Hamzën ca kohë më parë**, i vuri zjarrin krahinës së Shkodrës për të cgjakësuar Balshin dhe pabesinë e Venetisë që ftoj Turqit kundër tij /Noli, HeS<sup>1</sup>, II /.

Ky është modeli strukturor i periudhave me fjali të varur përcaktore me nuancë lejore, d.m.th. modeli që nuk përmban një konstrukt tautologjik.

Konstruktet tautologjike që kanë gjymtyrën e dytë në një fjali të varur përcaktore kanë tipare të përbashkëta dhe tipare të ndryshme me periudhat me fjali të varur përcaktore që pamë më sipër.

Tipare të përbashkëta:

1) Topika interpozitive e fjalisë së varur; jashtë këtij rendi, si fjalia e varur që ka gjymtyrën tautologjike, si fjalia e varur përcaktore pa gjymtyrë tautologjike nuk mund të përdoren;

2) Intonacioni i konstrukteve tautologjike dhe ai i periudhës me fjali të varur përcaktore jo tautologjike është i njëjtë: bëhet pauza midis fjalive, kemi theksa të njëjtë në gjymtyrët përkatëse (në rastin e konstruktit tautologjik theksat mund të jenë më të fuqishëm).

3) Në të dy tipet ekziston mundësia e përdorimit të pjesëzës përforcuese *édhe* përpara kryefjalës, por te konstruktet tautologjike përdorimi i saj është i domosdoshëm.

Tipare të ndryshme:

1) Antecedenti është gjithmonë emër (te konstruktet tautologjike përjashtohet pra antecedenti përemër vetor).

2) Fjala e përsëritur është gjithmonë kallëzuesor i fjalisë së varur me këpujën *jam* (kallëzues emëror) dhe gjymtyra tjetër e konstruktit tautologjik është përherë kryefjalë e fjalisë kryesore (ndonëse nuk përjashtohet mundësia e ndonjë gjymtyre tjetër) kurse te fjalitë përcaktore lejore joutautologjike si kallëzues mund të kemi jo vetëm kallëzues emërorë, por edhe kallëzues foljorë (siç shihet nga shembujt e mësipërm).

3) Fjalia e varur që përmban gjymtyrën tautologjike, bashkohet gjithmonë me përemrin lidhor *që*, sepse në gjuhën shqipe ky përemër përdoret në të gjitha stilet dhe, sidomos, sepse gjuha e folur popullore, ku e kanë burimin dhe përdorimin këto konstrukte, nuk njeh përemrin lidhor *i cili* (pra, për arësye stilistiko-gjinore);

Konstruktet tautologjik relativ ka gjithmonë nuancën lejore; bile mund të themi se kuptimi lejoz është qartësisht mbisundonjës. Kemi pra marrëdhënje lejore të shprehura me lidhje relative (përemërore). Fjalia e varur ku përsëritet me funksionin e kallëzuesorit i njëjti emër që është (rëndom) kryefjalë e fjalisë kryesore, arrin të vërë në dukje karakteristikën e mirëfilltë, të vërtetë të kryefjalës, karakteristikë esenciale në përgjithësi ose esenciale në një kontekst a situatë të dhënë, dhe duke e

theksuar këtë karakteristikë e ve në përqasje, në opozicion me sa flitet në fjalinë kryesore; nga kjo kundërvënje del nuanca e lejimit.

Konstruktet tautologjike, midis gjymtyrëve të të cilëve shprehen marrëdhënje lejore, përdoren në gjuhën e folur dhe pasqyrohen rëndom edhe në letërsinë artistike, sidomos në dialog, në tregim të lirë.

— *Edhe reja, që është re*, nuk kthehet ta hedhë rrufenë dy herë me radhë në një degë, kurse... /B. Xhaferri: Njerëz të rinj, tokë e lash-të (128) /.

— Po ta thashë, o Braho, iku ai zaman: tashi bëhet dasma me violi, jo me daulle; (;) u lidh dynjaja me tela; (;) *edhe kalamani* (,) *që është kalama*, të gjen sa dhëmbë ke në gojë, (;) dolli dituria mbi dhe. /S. Andoni: Brengat e pleqve, «Tre nga M (129).

*Edhe pleqtë* (,) *që janë pleq* (,) ... rrëfejnë me gojën e tyre se s'mbajnë mend të ketë ngjarë një çudi e tillë as në kohrat e lashta. /M. Kuteli: Netë shqiptare (59) /.

Në periudhë mund të kemi më shumë se një konstrukt tautologjik, kur fjalia kryesore ka kryefjalë homogjene, si p.sh.:

*As ujku që është ujku, e thiu që është thi* s'guxojnë t'i dalin përpara (ariut, S.F.) /M. Kuteli: Xinxifillua (33) /.

Periudha me fjali të varur përcaktore (atributive) në rumanisht ka tipare të ngjajshme me ato të shqipes: funksionin atributiv me nuancë rrethanore lejore të fjalisë së varur; përemrin lidhor përkatës (rum. *care*, shq. *që*, si përemër lidhor i gjuhës së folur), të njëjtët antecedentë: emra ose përemra vetorë; i njëjti intonacion (pauzat — pasqyruar në rumanisht në mënyrë mjaft koseguente me shenjat e pikësimit — presat) Krh. konstruktet përcaktore lejore joutautologjike.

Ti - e drag sã trãiești cu un om care se poartã cu tine ca cu un ciine, si mã gonești *pe mine, care te iubesc*... /Caragiale, GLR II (279) /.

Sã fiu prieten cu *bãrbatu*- tau, *care nu-i om de felul meu*, numai sã te poti vedea mai des! /Caragiale, GLR II (279) /.

Përkundrazi, konstruktet tautologjike që shprehin marrëdhënje lejore, ndonëse kanë disa tipare të përbashkëta në shqipe dhe në rumanishte, kanë edhe tipare të ndryshme, ndër to edhe disa mjaft të rëndësishme:

Tipari strukturor kryesor që dallon konstruktet tautologjike të shqipes nga ato të rumanishtes konsiston në ndryshimin e mjetit të lidhjes.

Gjuha shqipe, për të shprehur marrëdhënje lejore me konstruktet tautologjike shfrytëzon strukturën e periudhës me fjali të varur përcaktore me përemrin lidhor *që* dhe jo strukturën e periudhës me fjali të varur lejore, me lidhëzat lejore *sado që, sido që* etj., kurse rumanishtja për konstruktet tautologjike që shprehin marrëdhënje lejore shfrytëzon strukturën e periudhës me fjali të varur lejore, me lidhëza lejore të mirëfillta, ndonëse, siç e pamë më lart, rumanishtja i njeh konstruktet relative me funksion përcaktor me nuancë lejore por jashtë tautologjisë.

Kështu pra, konstruktet tautologjike të rumanishtes janë variant i periudhës me fjali të varur lejore lidhëzore të mirëfilltë dhe nuk bashkohen me kryesoren me përemrin lidhor *care* por me lidhëzën lejore *cã*, (së cilës i përgjigjet për shumë funksione të tjera — veç letores — lidhëza ftillonjëse shqipe *që* dhe *se*), ose me lidhëzën lejore *çitu* (shqip. *sado që*). Në shqipen, *konstruktet tautologjike me lidhëza lejore të mirëfillta nuk janë në përdorim*.

Nga topika, fjalitë e varura me gjymtyrë tautologjike nuk kanë ndonjë ndryshim: fjalitë e varura, në të dy gjuhët janë interpozitive: pasqyrojnë rendin e fjalivet në periudhën model përkatëse: «lidhëza *cã* nuk

çel në rumanishten e sotme fjali lejore të mirëfillta veçse kur fjalia e varur është interpozitive (midis kryefjalës së kryesores dhe kallëzuesit të saj...» (GLR, I, 400).

Le të krahasojmë strukturat që shfrytëzojnë përkitazi shqipja dhe rumanishtja.

— *Edhe unë (.) që jam doktor (.)* u alarmova. /I. Uruçi: Doktor Aleks, Akti I tablo e dytë, «Nëndori» Nr. 9 1963 (15).

*Eu că sint bolnav, și tot am venit la școală.* /GLR, I, 400/.

Në shqipe, përemrin vector *unë* e prin pjesëza përforcuese *édhe*, së cilës i përgjigjet në rumanishte fjala *și*, por kjo, përkundrazi, zë vend në fjalinë kryesore mbas fjalisë së varur dhe jo para kryefjalës, si në shqipe; veç kësaj togu *și tot* dhe *și încă* ka vlerën e një fjale korelative të lidhëzës ( por, prapëseprapë); fjalia e varur nis me përemrin lidhor *që*, në shqipen, kurse në rumanishten ajo nis me lidhëzën lejore *că* dhe mund të nisë edhe me lidhëzat *dacă*, *de*, *citu*, gjithmonë në interpozicion. Ndër lidhëzat lejore që përdoren në gjuhë popullore, sidomos në shprehjet proverbiale rumune, më e përdorshmja është lidhëza *că*:

*Fierul, că -i fler, și încă* ruginește, dar apoi noi care... /Alecsandri, GLR, I (400)/.

*Soarele că e soare și tot* mai are pete. Proverb (GLR, II, 330).

*Ciinele, că-i ciine, dar și* el își ia lumea-n cap de la o vreme /Proverb, GLR, II, 326)/.

Fjala *dar* (=por) si korelat në rumanishten e sotme (nuk përdoret më.

Cum naiba dor să nu-mi fie?

Cînd și muntele, *că -i munte*,

**Si - ncă** are doruri multe /Jarnik — Birseanu, GLR, I (400)/.

Aici, în satu ăsta, sint rădăcinile mele, aici rămîn. Buruenile *că sint buruieni și* cad lîngă rădăcinile lor: Camil Petrescu, GLR, II, 416).

Në poezi, në rumanisht fjalia e varur mund të nisë edhe me lidhëzën lejore *dacă* (= *ndonëse, sado që, sido që, édhe në*), kurse në gjuhën letrare edhe me lidhëzën *citu* (*sado që*)

*Sfintul soare, dacă — i soare*,

**Si tot** după tine moare. /Jarnik-Birseanu, GLR, II, 326)/.

*Știi că boierul, citu-i de boier*, a pus-o de mămăligă. /Creangă, GLR, II, 416 /.

## II.5. Konstruktet tautologjike me lidhëzën ndajfoljore si

Fjalia e varur e këtyre konstrukteve mund të ketë funksione të ndryshme sintaksore sipas vetive leksiko-gramatikore të foljeve kallëzues. Dy janë kryesoret: funksioni kallëzuesor dhe ai mënyror.

### II.5.1.: Fjalia e varur është kallëzuesore.

a) Ky konstruk ka kufizime leksikore e kategoriale: përdoret vetëm një grup i caktuar foljesh, më shpesh folja këpujë *jam* si dhe ndonjë folje tjetër me kuptim leksikor të vlerësimit të sendit, si folja *kam*.

Dy gjymtyrët e tautologjisë bashkohen me lidhëzën ndajfoljore *si* që luan rolin e një lidhëze krahasimi; nëpërmjet të këtij krahasimi i atribuohet subjektit (*jam ashtu si jam*) ose objektit (*e kam si e kam*) një cilësi e pacaktuar (e cila mund edhe të dihet nga konteksti dhe nga situata); gjithë kuptimi i konstruktit tautologjik tregon indiferentizmin ndaj tiparit, cilësisë a vetisë dhe është baraz me *sido që jam, sido*

*që e kam*; midis konstruktit tautologjik dhe fjalisë pasuese të periudhës vendosen marrëdhënje lejore. P.sh.:

(— Më turpëroi çupa, o Sefe vllaj)...

[— ... Më ardhi keq për çupën. *Ish si ish* (,) qe ime bijë. /Andoni: *Brengat e pleqve, Tregime nga Morava* (128)/

Ja kështu ngjau vërtet. Se *ish si ish*, me cene e huqe Ali Tepelena, po vegjëlinë e trimat i kish për zemër. /Po ai, po aty I (28)/

*Ishin si ishin* njerëzia (,) fise e tarafe, me miqësi dhe armiçësi gjaku, tashti u bashkuan dhe u bënë tok me ara e me parmenda, me hambare e gjë të gjallë. /Po ai, I fundit, po aty (109)/.

Fjalja e periudha ku ndodhet konstrukt i tautologjik bashkohet me një konstrukt jotautologjik me lidhëzën kundërshtore *po(por)*, si dhe asindetisht.

Shtëpia e Mara Kolës, në breg të lumit *ishte si ishte* (,) qëndroi se qëndroi për shumë kohë. /Z. Sako: *Shtëpia e re, «Njerëz dhe ngjarje* (119)/.

Krahaso dhe lojën e fjalëve: *Qe si që, u bë si ka* (e cila shqiptohet (në Korçë): *Qe si qe, u bë si ka*).

**II. 5.1.1.** Gjymtyra e dytë e tautologjisë ka funksion kallëzuesori të zgjeruar të kundrinës, d.m.th. të një fjalisë të varur kallëzuese. Konstrukt i tautologjik bashkohet me një fjali tjetër me lidhje asindetike. Midis dy grupeve vendosen marrëdhënje lejore.

— Me gjithë mend e kini, moj grari? Unë e kam çupën të vetëme,(...)

— *E ke si e ke* (çupën, S. F.), puna jote. A ja ke folur Kuma Maros /ariut, S.F./? M. Kuteli, *Xinxifillua* (26)/.

— *E kish si e kish hallin*, nënë Dhorka gëzohej kur i vinin mysafirë në shtëpi (...). /Musaraj: *Llaz Qesarati*, në «*Isha unë...*» (52)/.

*E kish si e kish punën* (Uan Rama, S.F.) duhesh të paraqitej domosdo te ministri. /Idem, *Para agimit* (I) (440)/.

**II. 5. 2.** Kur kallëzuesit janë foljorë, ata shprehen me çdo folje pa ndonjë kufizim leksikor dhe brendakategorial: kalimtare dhe jokalimtare, veprorë dhe pësorë. Mungesa e kufizimit leksikor të foljeve që përbëjnë tautologjinë shpjegohet në faktin se çdo proces mund të karakterizohet nga pikëpamja e cilësisë së tij, d.m.th. nga pikëpamja e mënyrës së shtjellimit. Konstruktet tautologjike në sajë të lidhëzës *si* tregojnë mënyrë, por mënyrë të papërcaktuar dhe këtej marrin kuptimin që zakonisht jepet me shprehjen *disi* ose *dosido*, ndonjëherë edhe *sido që*.

/Ajeti/ I kish thënë zonjës Naime se nuk do të kthehej për drekë(...)/  
/Do hante si të hante jashtë dhe vetëm për darkë do të kthehej. Musaraj, *Para agimit*, (I) (113) /.

Rifati: Ju e dini se unë nuk kursehem për ju. 4500 lekë që kam në arkën e kursimit po ua jap menjëherë. (...)

*Kusurin rregulloje si ta rregullosh* Drama (15), B. Bubani, *Bileta e llotarisë*, A.I.

Kur fjala *si* bashkon dy kallëzues të shprehur me foljen *them*, kalimtare veprorë, me kuptimin e të kumtuarit me anën e ligjerimit, konstrukt i tautologjik nuk ka aq vlerën e mënyrës, se sa atë të objektit, që rëndom në raste të tjera shprehet me përemrin e pakufishëm ç. Përdorimi i fjalës *si* ka të bëjë me një nuancë të hollë lidhur me një farë vlerësimi të brendisë së komunikuar.

↪ Djali është bërë si i përngritur. Ca thonë *se e kanë zaptuar të bardhat*,

ca thonë se. . . **Thonë si thonë** po puna është se atë gjeç e bren përbrenda. /Kuteli, Të tri motrat, «Xinxifillua» (191)/

**II.5.2.1.** Kur kallëzuesit janë shprehur me foljen *bëhem*, (gjithmonë vetë e tretë njëjës), me kuptimin e «të ndodhurit», «të ngjarit», përdoren rëndom trajta e së kryerës së thjeshtë të dëftores dhe ajo e së tashmes së lidhore.

Konstrukti tregon indiferentizëm, rezinjacion, nënshtrim ndaj *asaj* që ndodhi ose që mund të ndodhë, ose ndaj cilësisë së gjendjes.

Për dhen e dhi *u bë si u bë* (,) po për armë (,) këto s'jepen në malet tona. /Kuteli: Kap: Aga (9)/.

— *Tani u bë si u bë*. . . Futeni këtë mërshtë në thes e vareni në lis /Po ai, Hapu malore/, «Xinxifillua» (152)/.

— Nejsë (,) *u bë si u bë*, u pa kjo punë; (...) /N. Bulka: Tri javë në Korçë, «Kur qante. . .» (76)/.

[«E pa të udhës të hyjë (në malore, S. F.).

«E ç'do të humbas po të hyj?

Tani kulaçi m'u mbarua, më tutje nuk shkoj dot.].

*Le të bëhet si të bëhet.* /Kuteli: Hapu malore!, Xinxifillua (136)/.

**II.5.2.2.** Konstruktet tautologjike më të përdorshme janë ato që kanë si kallëzues foljen *bëj* me kuptim të përgjithshëm të një veprimi (baraz me foljen *veproj*).

a) kur konstrukti tautologjik nuk pasohet domosdo nga një fjali e bashkërenditur, ai tregon se kryhet një farë veprimi i papërcaktuar, si shkallë paraprake për të dalë nga një situatë e vështirë, për të kapërcyer disa pengesa, privacione, të cilat paraqiten nga konteksti ose situata reale konkrete. P.sh.

— Aman, o bej (mos na hiq nga puna, S.F.), se na mbetën fëmija pa bukë.

— Hë, more, se mo i patët edhe dje me bukë; *bëjnë si bëjnë fëmija*, hajde /S. Andoni: Ligor Dodani, «TreNgam (29)/.

«Këtu» *bëjnë si bëjnë fëmija* «do të thotë» do të jetojnë si do të jetojnë: «do ta kapërcejnë këtë vështirësi edhe pa ndihmën e tjetërkujt», «do të jetojnë, do të rregullohen në një farë mënyre». Po ky kuptim del edhe më poshtë.

«Pse djallin e paskan prerë / manin, S.F./? — thashë. Nejsë u mendova pastaj, — *do bëj si do bëj* edhe pa manin.(...) /Musaraj: «Isha unë... (22)/.

*Do bëjmë si do bëjmë* (,) fundi. Mos u tremb. // Po ai, Llaz Qesarati, Isha unë. . . (104)/.

Në raste të tjerë, situata, konteksti i tregon qartë pengesat, vështirësitë që duhen kapërcyer me një veprim e përpjekje të përshtatshme, kështu që këtu tautologjia frazeologjike ka kuptimin «përpiqem në një farë mënyre», «përpiqem me çdo mënyrë».

*Zefi*: Po si dreqin do ta kandis daj Budrumin, që është edhe ky djalli vetë? Po *do bënj, sido* (= si do) *bënj*, do përpiqem /Kristo Floqi: Reklamë e blorfë, sqena 1 / (fq. 4-5).

Duhet kandisur Budrumi, «djalli vetë», që klienti i Zefit, Keli, është pasanik. Ai është pengesa, ky është synimi. Tautologjia tregon se do të bahen përpjekje me çdo mënyrë për kapërcimin e pengesës.

Në qoftë se me konstruktin tautologjik është bashkërenditur një fjalë me lidhëzën *e, dhe*, tautologjia tregon të vepruar, të përpjekur për

të arritur synimin, qëllimin që shprehet nga brendia e fjalisë së bashkërenditur, e cila pason.

Mënyrat e foljeve kallëzues në gjymtyrët e tautologjisë janë: Dëftore+Dëftore; Lidhore+Lidhore dhe Urdhërore+Lidhore. Trajtat kohore më të përdorshme janë: për dëftoren — e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e ardhshmjia; për Lidhoren — e tashmja dhe e pakryera.

Sikur si mjaftojnë punët e Frontit e të Partisë, /Memushi, S.F./ *bën si bën* e gjen nga një copë kohë edhe për mua. Vjen e më ndihmon se ma di hallin. /Musaraj: Të shkuara... (19)/.

...Xha Telua gjithnjë muhabet trimërije hapte. *Dhe bënte si bënte*, e binte fjalën te luft' e Kserolakut (...) /Z. Sako: Medalja e trimërisë /.

Çaloku u tremb, i shqau këmba dhe muarrmë të tre rrुकullimën. *Unë bëra si bëra* u mbajta në ca rrögosa bushi, (...) Kuteli: Hapu, malore Xinxifillua (162) /.

Sikundër do të shohim më vonë, pajtimi nga ana e Lek Dukagjinit ishte vetëm për sy e faqe, se *bëri si bëri*, ( ) dhe e mori gjakun me të pabesë. /F. Noli: HeS<sup>3</sup> (46) /.

— U mbytëm me shtëpi e katandë, kur (...) na u ngjall këtë dimër lumi i Vdekur (...) po gjën e gjallë *bëmë si bëmë* e e shpëtuam. /J. Xoxa: LiV (II) (443) /.

— Ashtu, ashtu, *do të bëjmë si do të bëjmë* e do të rregullohem! /S. Spasse: Buzë liqenit (163) /.

Mendoj të bënte si të bënte dhe nga stani (...) të ikte, të ikte nga sytë këmbët: / Spasse: Buzë liqenit (325) /.

Duke i treguar të tëra këto, Sofika i këshilloi të dy burrat, që *të bënin si të bënin* dhe Gurrëmadhin ta futin në kooperativë (...) /Po ai, po aty (242-243) /.

Fjalja pasuese pa tautologji mund të bashkohet edhe asidentisht po kjo ndodh më rrallë.

Ili, çdo mëngjez, *bënte si bënte*, kalonte me bravaret nga ajo shtëpi, ( ) ku do të kishte fjetur mësuesja. Spasse: Afërdita... II.

Për rumanishten njohim konstrukte paralele vetëm për dy variante të shqipes:

1) me foljen *a fi* (= jam), p.sh.:

*Pân — aici toate au fost, cum au fost*; da de-acum am prins eu la minte: /Creangă, GLR (416) /.

*Lumea-i cum este...* si ca dînsa sîntem noi / Eminescu, GLR, II, 273 /.

Konstruktet me foljen *a avea* nuk përfaqësohen në rumanishte, ndoshta, sepse kjo folje nuk ka edhe kuptimin e vlerësimit që ka folja përkatëse e shqipes «kam»;

2) Me çdo folje tjetër përveç foljes *a face* (bëj), *a se face* (bëhem). P.sh.:

*Trecurăm cum trecurăm* pînă aci, stăpîne /Ispirescu DLRLC, I, f. 600 /1.

## II. 6. Konstruktet tautologjike me lidhëzën ndajfoljore ku

Lidhëza ndajfoljore *ku*, bashkon me kryesoren një fjali të varur vendore. Duke bashkuar dy folje-kallëzues tautologjikë konstrukti arrin të shprehë veprim të papërcaktuar nga pikëpamja hapësirore-vendore.

Ata tani kishin mbetur si peshku pa ujë! *Të kapeshin ku të kapeshin*, sa të ngrinin pakëz kokën... /Spasse: Buzë Liqenit (169) /.

Fjalës *ku* mund t'i përgjigjet në fjalinë kryesore fjala korelative *atje*, dhe në këtë rast përcaktimi vendor bëhet me foljen kallëzues të fjalisë kryesore nëpërmjet të kësaj ndajfoljeje.

Kuptimi i fjalës *ku* në shqipen ka të bëjë me kufizime në rrethin e foljeve kallëzues të gjymtyrëve të tautologjisë; këto janë rëndom folje që tregojnë: a) ose veprim statik; b) ose veprim dinamik, por gjithmonë me drejtim të caktuar.

a) me folje statike:

Ata (kusarët, S.F.) e prisnin (kapedanin, S.F.) padurim, si ditën e verës. /Kapedani /I gjen *atje ku i gjen* (kusarë këta, rrinin fshehur në një sfrac ku s'hyn as vetë qoftëlargu!) /Kuteli: Hapu, malore / «Xinxifilua» (158) /.

b) Me folje dinamike:

«Vetëm paraja është besnike! Vendose *atje ku ta vendosësh*, e sa herë që t'i thërrësësh: para, xhane! — të përgjigjet: lepe, këtu jam!» /Kuteli: Hapu malore, «Xinxifilua» (128) /.

Kur kallëzuesit janë shprehur me foljen *dal* në lidhore (rëndom të tashme) tautologjia merr kuptimin e konstrakteve tautologjike «të bëhet ç'të bëhet», «të ngjasë ç'të ngjasë», frazeologjizën tipik për rastet kur njeriu merr një vendim për të kryer një veprim plot rreziqe të mëdha, të cilat detyrohet nga rrethanat që të mos i marrë parasysh. P.sh.:

Në dhomë hyri garsoni, i cili, me një buzëqeshje të ngrirë më zgjati një listë gjellësh në dy gjuhë të huaja... (...). Pa thënë asnjë fjalë (,) vura gishtin në një të parë, në dy të dyta, në një të tretë... «Të *dalë ku të dalë*!» Bën vaki (,) njëra prej tyre do të jetë tavë Elbasani» thashë me vete. /Q. Buxheli: Gjyshja, lulet, ringu... Një ndodhi në plazh (60) /.

## II. 7. Konstruktet tautologjike me lidhëzën ndajfoljore nga

Gjymtyrët e tautologjisë, të shprehura me folje që tregojnë lëvizje, tregojnë marrëdhënje vendore, por vetë kuptimi i lidhëzës ndajfoljore nga (lëvizje me drejtim të papërcaktuar) e thekson karakterin e papërcaktuar të drejtimit hapësiror ku shtjellohet veprimi.

Rëndom, konstrukti tautologjik pasohet nga një fjali me kallëzues të shprehur me foljen «kthehem». Kështu tregohet një veprim i papërcaktuar nga pikëpamja e drejtimit hapësiror të shtjellimit, i cili pasohet nga një veprim tjetër.

*E shpinte nga e shpinte mëndjen Zefi*, prapë te tre vetë kthehej: te Ismaili, te Miti i Agllaisë dhe... te korrieri. /Musaraj: Para agimit (I) (469) /.

E njëjta marrëdhënje paraqitet edhe kur gjymtyrët e tautologjisë janë shprehur me pjesore, siç ndodh në të folurit popullor dialektor, sidomos të disa krahinave. Po japim disa shembuj që ka mbledhur J. Thomaj në katundin Seman (v.c. f. 138):

*Ikur nga ikur ata* /kur i tha dhelpra gjysmë gjelit...//

*Bredhur nga bredhur* tër ditën çuni /kur erdhi me këmën plag //

Ndonjëherë fjala nga bashkon edhe kallëzuesit tautologjikë të shprehur me folje që nuk tregojnë lëvizje dinamike. Në këtë rast do të pri-tej që të përdorej lidhëza *ku*; me gjithëatë, na duket se përdorimi i lidhëzës nga sjell një nuancë të veçantë: me përdorimin e lidhëzës nga duket se tregojmë, bëjmë aluzion te lëvizjet paraprake në drejtime të ndryshme para se të arrihet te veprimi konkret i shprehur me foljen kallëzues.

*Kullotur nga kullotur dhënt /kur u kthyen vetëz//J. Thomaj: v.c. (138) /.*

Të pasnesërmen nuk duruan më kur morën vesh se italianët kishin zënë skelën. Ashtu siç ishim, duar sall po me zemrën plot nga urrejtja, *gjetëm se nga gjetëm* nja dy kamionë dhe u nisëm për në Vlorë. /J. Xoxa: Lumi i vdekur (II) (194)<sup>28</sup>.

Por konstrukti ka vlerën e një konstrukti tautologjik frazeologjik në rast se janë përdorur në gjymtyrët trajta të njëjta të foljes *vete*, e cila ka humbur kuptimin leksikor të lëvizjes konkrete dhe shpreh, sipas situatës, alternimin e një mendimi me një mendim tjetër që «kthehet» si një ide fikse, ose kalimin gjatë bisedimit nga një rreth çështjesh në një rreth tjetër çështjesh më të rëndomta, ose që janë asish «ku vete gjuha» më shpesh, sepse «dhembin» më shumë.

«I ka marrë masat për vete! Çfarë do të thotë kjo?» — filloi ta vrasë mëndjen avokat Ajeti dhe, *vinte nga vinte*, ai prap kthehej tek ai mendimi i parë, që ilegali do të bëjë të tijën. /Musaraj: Para agimit (I) (597).

Në këtë shembëll «*vinte nga vinte*» e «kthehej» nuk ka të bëjë me kryefjalën Ajeti, sepse ai as që ka lëvizur nga vendi. Ai ka qëndruar në vend duke menduar për një çështje që e preokuptonte me të madhe. Këtu do të jemi, me sa duket, përpara shkrirjesh të dy konstrukteve, dy fjalive të ndryshme: «Ai vriste mëndjen» dhe «mendja vinte nga vinte e prap kthehej» në «vinte nga vinte», ai prap kthehej» ndofta nën ndikimin e faktit se subjekti nuk e drejton më vetë mendjen, mendimin e vet, mendimi i imponohet subjektit mendonjës, sepse ky nuk është në gjendje «ta heqë mëndjen» nga ajo çështje.

Krisi kënga e, nëpërmes të këngës, edhe muhabeti.

*Vinim nga vinim, prapë te ato ngjarjet e luftës ktheheshim.* /Musaraj: Të shkuara, të paharuara (79) /.

Pyeta e pyeta Asimin për gjendjen e djalit e të nuses dhe t'asaj copë plake që nuk u zu ngojë fare në gjithë atë muhabet, po *Asimi vinte nga vinte*, e shpinte fjalën te të gjithë kooperativistët bashkë dhe s'më thoshte hiç gjë për ata të mitë /Musaraj: Isha unë... (18) /.

Në dy shembujt e fundit, situata konkrete na tregon: në të parin, se muhabeti prekte çështje të ndryshme duke alternuar me «ngjarjet e luftës» si diçka të zakonshme, të preferuar; kurse në të dytin, autori kallëzon se tematika e bisedimit, pasi pësonte digresione të ndryshme, kthehej me qëllim prej Asimit të çështjet e kooperativistëve «duke i bërë bisht», si të thuash, çështjes që «aq shumë i dhimbte» bashkëfolësit, çështjes së «plakës» dhe të familjes që kish lënë në fshat.

Konstrukteve tautologjike të mirëfillta me lidhëzën *nga* të shqipes (rum. *pe unde*) u përgjigjen në rumanisht konstrukte analoge si nga pikëpamja strukturore ashtu edhe nga pikëpamja e vlerës.

*Vete nga vete dhe kthehet prapë//*(S. Floqi, v.c. 114).

*A umblat pe unde a umblat și s-a întors.* V-Gutu Romalo, v.c. (487)/.

## II. 8. Konstruktet tautologjike me lidhëzën që

Fjalja e varur prepozitive me lidhëzën fthillonjëse që, me folje kallëzues që përsëritet në të njëjtën trajtë kohore nga folja kallëzues të fja-

28) Përdorimi, gjithmonë pleonastik i lidhëzës *se* përpara fjalës *nga* ka ndodhur nga interpretimi i kësaj fjale si ndajfolje pyetëse në një fjali pyetëse të zhdrejtë. Një interpretim i tillë ndodhet vetëm te ky autor.

lisë kryesore kryen funksionin e një fjalie të varur të «marrëdhënjes», si konstrukt sintaksor sinonimik me atë të plotësorit «të marrëdhënjes». Konstrukti tautologjik bën pjesë në një periudhë së paku trigjymtyrësh (tri fjalish) dhe prin menjëherë një fjali të bashkërenditur me lidhëzën kundërshtore *po*.

— Mor, *që lipsej një shi, lipsej*, po më duket se do të na vijë shtërgatë, /Th. Kacori: Ditë që s'harrohen 141) /.

Vlera e konstruktit tautologjik me fjali të varur të marrëdhënjes është po ajo e konstruktit tautologjik me plotësor rrethanor të marrëdhënjes (shih I.3.): theksim i kallëzuesisë dhe kundërvënje ndaj një thënjeje tjetër në planin kufizues.

— Poshtë Resuli nuk ka zbritur! *Që kanë ikur që këtej kanë ikur*. Po ku kanë vatur? Do të jenë hedhur nga Shkëmbi i Bletëve! — tha Hodoja. /Po ai, Për Mëmëdhenë (II) (153) /.

Në shembujt e mëposhtëm duhet nënkuptuar lidhëza që në krye të periudhës. Elipsa e lidhëzës që ndodh sepse folësi rimerr, duke e përsëritur dy herë me rradhë, të njëjtën folje që sapo ka përdorur bashkëfolësi, në të njëjtën trajtë kohore, por duke i bërë ndërrimin e vetës, në qoftë nevoja, dhe konstrukti, si replikë, si përgjigje «flakë më flakë» që është, mënjanon lidhëzën, si diçka që ngadalëson shpejtësinë e transmetimit të komunikimit. Me konstruktin tautologjik, ligjëruesi tregon se është dakord me veprimin e shprehur nga kallëzuesi, por i vë, nëpërmjet të një fjalie të bashkërenditur kundërshtore, një farë kufizimi brendisë së thënjes që sapo ka pranuar si krejt të vërtetë.

— Edhe unë *jam vrarë* kështu, o Kozi, edhe unë *jam vrarë* kështu, me beun (...)... vazhdonte Pilo Shpiragu (...).

— *Je vrarë, je vrarë* o Pilo, po tashi më rri aty, në kufi tënd prapa gardhit e thua: Larg, o sherr, nga kjo derë!... /J. Xoxa: LiV (II) (40-41). Nga thënja e bashkëfolësit, ligjëruesi merr vetëm kallëzuesin në po atë trajtë kohore, dhe duke e kthyer në vetën e dytë, e përsërit dy herë me radhë për të theksuar se është dakord me atë fakt për sa i përket kohës së shkuar, por qëndrimin të tij revolucionar të dikurshëm i vë përballë qëndrimin e sotëm prej «sehixhiu».

— E (,) *kanë* ç'të ndajnë ata, pa më çarten kështu!... thanë në fshat kur morën vesh si u mbyll grindja e grizarakëve /vëllezër për ndarjen e mallit, S.F. /.

— *Kanë, kanë*, po në ua lënçin, se edhe për të ngrënë, me lugët e botës hanë... /J. Xoxa: LiV (II) (164) /.

— Këtë e dinë të gjithë, thashë me qetësi.

— *E dinë, e dinë*, po s'e kanë parë se si të bie bretku atje tërë ditën... /Elena Kadare, Shuajë dritën, Vera, T. 1966 (89) /.

Konstruktet tautologjike me fjali të varur të marrëdhënjes në gjuhën shqipe janë më të rralla se konstruktet tautologjike me plotësor të marrëdhënjes të shprehur me paskajoren (toske a geqe). Në gjuhën rumune, konstruktet përkatës me lidhëzën *că* në gjuhën e sotme nuk përdoren fare; në gjuhën e sotme rumune mbizotërojnë konstruktet sintaksorisht sinonimike me plotësor të marrëdhënjes të shprehur me folje në supin (*de urat, am mai ura*, Mioara Avram ES, 226). Por gjatë zhvillimit historik të konstrukteve me infinitiv, në rumanishte ka pasë paralelizim në të njëjtën kohë edhe plotësorë të marrëdhënjes të shprehur me infinitiv (ndonëse edhe këta kanë genë më të pakët se ata me supin), edhe fjali të varura të marrëdhënjes me lidhëzën *că* (+ *koniuktivin*). Por në gjithë materialin që ka shfrytëzuar linguistja rumune Mioara Avram për studimin «Zhvillimi i fjalive të va-

rura rrethanore me elementë lidhëzore në gjuhën rumune<sup>29</sup> ajo nuk ka gjetur gjithë-gjithë veçse tre shembuj me tipe të ndryshme të fjalisë së varur të marrëdhënjes, ndër të cilët, do të vëmë re, vetëm njëri përmban konstrukt tautologjik, zaten edhe ky me lidhëzën *ca + conjunctiv*, i cili «ka qenë një ekuivalent bashkëkohor i atij me infinitiv, dhe është përfshirë (*inscriindu-se*) në vijën e përgjithshme të zëvendësimit të infinitivit me koniunktivin, por duket (*e probabil*) që as ai nuk ka pasur një jetë më të gjatë se sa plotësori i marrëdhënjes i shprehur me një folje në infinitiv. (Po ajo, po aty, f. 226). M. Avram konkludon se «fjalitë e marrëdhënjes, me lidhëza, nuk kanë përbërë aspak një tip fjalie të varur të përfaqësuar mirë dhe qartë në gjuhën rumune» (f. 226).

Nga ana tjetër, është interesante të krahasohet struktura e të vetmit shembull me konstrukt tautologjik që ka mundur të identifikojë M. Avrami gjatë historisë së shkruar të gjuhës rumune, shembull i marrë nga *Cronica Anonimă e Constantin Brincoveanu-it*, me të vetmin shembull që disponojmë ne për shqipen e sotme me një kallëzues të fjalisë së varur në lidhoren (pa lidhëzën që, si element jo i domosdoshëm).

*Să mai zică ei ceva, nimica n-au mai zis*, fărã decît: greșiți sintem, doamne, greșiți si ce va fi voia mării tale. MA-ES f. 226/ (nënvizuar prej meje S,F.).

Usta Skamin, *ta njihte, nuk e njihte Kozi* /J. Xoxa, LiV, (II) (127) /.

Duke përmbledhur mund të theksojmë se në shqipe dhe në rumanishte ka konkordancë të plotë për sa i përket mjeteve të shprehjes së konstrakteve tautologjike me plotësor të marrëdhënjes; por për sa i përket përdorimit të konstrakteve tautologjike me fjali të varur të marrëdhënjes ka ndryshime. Ndërsa në shqipe përdorimi i paskajores është shumë më i shpeshtë se fjalia e varur për shprehjen e gjymtyrës së marrëdhënjes, në rumanishten më të re si dhe në të sotmen, sipas konkluzionit të nxjerrë nga *Finuța Asan* dhe *Laura Vasiliu* në punimin «Unele aspecte ale sintaxei infinitivului in limba romina («Studii de Gramatica» I (1956) f. 110, citojmë sipas M. Avram, v.c. f. 226), «në vend të infinitivit është përdorur ekskluzivisht supini me *de*». Nga ana tjetër rumanishtja e sotme nuk njeh fjalitë e varura të marrëdhënjes me lidhëzën që (+*dëftore*), të cilat shqipja i përdor rëndom, as fjalinë me lidhëzën *ca (+conjunctiv)*, të cilën rumanishtja e ka përdorur në të kaluarën, por sot nuk e përdor më, kurse shqipja e përdor sot, ndonëse fort rrallë (aq sa në sfondin e materialeve që disponojmë ne, kjo duket në vështrim të parë si një përjashtim, dhe mund të shihet si një shfrytëzim stilistik i mundësive të brendshme të shqipes).

## II. 9. Konstruktet tautologjike me fjalën sa

Për herë të parë «konstruktet e përbëra nga dy trajta kohore të njëjta të po asaj foljeje» të bashkuara me fjalën «sa» janë shqyrtuar prej meje në punimin dialektologjik «Skicë e së folmes së Dangëllisë» (v.c. f. 114).

Tek ky punim, kemi dhënë ndër të tjera edhe vlerën e konstruktit, i cili tregon «një veprim të shkurtër, të shikuar nga ana e vëllimit të shtjellimit në sasi, intensitet (dhe kohë)».

Këtë vlerë i ka dhënë më vonë edhe M. Çeliku (v.c. 172); togu shpreh «një farë kufizimi të veprimit, e ky kufizim bahet në planin e volumit

29) Mioara Avram, v.c., 226.

të shtjellimit të veprimit, në shkallën e intensitetit të shfaqjes së tij dhe së treti edhe në planin kohor» duke i konsideruar veç kësaj edhe togjet të tipit *rri sa rri* si togje «leksikisht të pakufizuara», gjë që është e gabuar.

Si në paraqitjen e vlerës që kemi bërë ne, ashtu edhe te ajo e M. Celikut, ka paqartësi, pasaktësi.

Paqartësi ka edhe në përcaktimin e vlerës që jep Emil Lafeja<sup>30</sup> tipeve «folje + sa + folje», të cilat «shërbejnë për të shprehur aspektin durativ, por në këtë rast, siç e ka parë drejt V. Gutu-Romalo, zgjatja e veprimit në kohë është më e shkurtër sesa në rastin e përsëritjeve të tipit A» (127).

Po kthehemi te këto konstrukte, të cilat më parë i kishim shqyrtuar vetëm nga pikëpamja e asaj së folmeje si dhe të shumë të folmeve të tjera të shqipes, duke i parë mbi një bazë më të gjerë materiale, sidomos të gjuhës së shkruar.

Konstruktet tautologjike me fjalën *sa* i bashkon në një grup të gjerë fakti se ato shfrytëzojnë në ndërtimin e tyre modelin sintaksor të periudhave me fjali të varur krahasore, dhe pikërisht ato të barazisë, me këtë kufizim se mjetit të lidhjes në të varurën, fjalës *sa*, nuk i përgjigjet korelati përemëror-ndajfoljor *aq(ë)* në kryesoren. Gjithashtu i bashkon fakti se këto konstrukte shprehin *sasi* dhe, në sajë të përsëritjes së të njëjtave elemente leksikore, sasia merr nuancën e papërcaktueshmisë (pra konstrukti shpreh sasi të papërcaktuara). Fakti se me se ka të bëjë kjo sasi datajohet nga elemente të tjera strukturore dhe leksikogramatikore të gjymtyrëve të tautologjisë.

Mund të dallohen tri grupe konstruktesh tautologjike me fjalën *sa* si mjet lidhës:

1) Kallëzuesit janë shprehur me folje jokalimtare, rëndom folje që tregojnë lëvizje; kallëzuesit të fjalisë kryesore i mungon kryefjala dhe funksionin e saj e kryen fjalia e varur (fjali e varur kryefjalore; në këtë rast fjala «*sa*» është përemër, dhe kallëzuesit përdoren domosdo në trajtën e vetës së tretë shumës.

Hynë *sa hynë*, të tjerët mbetën jashtë. U nisën *sa u nisën*, po të tjerët mbetën. Atë mbrëmje u sosnë *sa u sosnë*, të tjerët mbritën të nesërmen.

Kuptimi i konstruktit tautologjik është të shprehë papërcaktueshmi nga pikëpamja sasiore e sendit (më sakt e subjekteve); konstruktit tautologjik i kundërvihet një fjali kundërshtore, duke treguar se *një palë, disa*, janë bartës të veprimit, të tjerët u kundërvihen të parëve.

Këto konstrukte janë të përdorshme në ligjërimin e folur.

2) Kallëzuesit janë shprehur me folje kalimtare veprorë të çdo kuptimi leksikor, por këta kallëzues duhet të kenë kundrinën e drejtë të pranishme ose të nënkuptuar nga konteksti ose situata; funksionin e kundrinës e bën një fjali e varur kundrinore; fjala *sa* është gjithmonë përemër (i përdorur substantivisht ose me funksion mbiemri). Këto konstrukte dallohen nga ato të pikës 1 edhe për faktin se foljet mund të përdoren në të gjitha vetat dhe në të dy numrat.

«Sa kërkon për një mace?»

30) Emil Lafe: *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten*, «St. Fil.» 1966, Nr. 4.

«Sa të duaç», i tha ay. *i dha edhe ky sa i dha* e e bleu /Dozon: Manuel. . . (45)/.

— *Shushunja pi sa pi*, pastaj vjen një kohë e ngopet me gjak, ata jo! /M. Kutelu: Hapu, malore / Xinxifillua (157)/.

Pare të bardha sa të duash! Mbush Xoxi xhepet, mbush targaçet e bëj të ngrihem, po s'ngrihem dot. E un i mjeri! *Sbras sa sbras* e bëhem i lehtë /M. Kuteli: Kap. Aga (33)/.

*Kish vjellë sa kish vjellë zotri e tij* kundër lëvizjes nacional-çlirimtare afro pesë vjet me radhë si drejtor gazete nën okupacionin italian (e) s'e pati për turp fare, kur kapitulloi Italia t'i drejtohej partisë e t'i kërkonte të falur për gjithë ato që kish bërë dhe bile të vihej në dispozicion të «Zërit të Popullit» me penën e tij prej esnafi. /Sh. Musaraj: Para agimit (I) (229)/.

Drejtperdrejt ose kontekstualisht foljet janë kalimtare, dhe vlera e tautologjisë është të tregojë sasi të pacaktuar sendesh si objekte të drejta, them sasi të *pacaktuar* e jo sasi të kufizuar; në ndonjë rast masa e sasisë mund të jetë e pakë, por në raste të tjera mund të thomi të kundërtën, si p.sh. te shembulli i Musarajt, ku plotësori i sasisë kohore «pesë vjet me radhë» na shtie në mend sasinë e madhe të objektit, «fjalëve të vjella».

3) Shumë më të shpeshta janë konstruktet tautologjike që kanë si kallëzues folje me kuptim leksikor të kufizuar: folje me kuptim të tillë leksikor që lejon të përcaktohet nga pikëpamja e sasisë kohore të shtjellimit të veprimit e procesit (kalimtare ose jokalimtare); prandaj nga ky rreth kallëzuesish të konstruktit tautologjik përjashtohen foljet që tregojnë *veprim a proces momentan*, fillim veprimi, ose mbarim veprimi. Në qoftë se për foljet kalimtare veprare do të bëjmë dallimin si në pikën 2, atëhere vlera e konstruktit tautologjik është të tregojë shtrirje të pacaktuar të veprimit a procesit në kohë; mjeti i lidhjes «sa» është «lidhëzë ndajfoljore krahasore».

*Ecën sa ecën këta* / mushtullukët, S.F./ nëpër male, — *një ditë, dy, tri, a më shumë* — prrallë është kjo — po u kthyen më këmbë, çalë-çalë, të këputur. /M. Kuteli: E bukura e dheut, Xinxifillua (116)/. Me mjete leksikore, autori na e bën të qartë se bëhet fjalë për një sasi të pacaktuar kohe (*një ditë, dy, tri, a më shumë*) prandaj vlera e tautologjisë nuk mund të konsiderohet kurrsesi si «aspekt durativ i kufizuar». Këtë vlerë e shpjegon qartë edhe origjina e konstruktit tautologjik: ky riprodhon strukturën e fjalive krahasore të barazisë me lidhëzën ndajfoljore *sa* (që tregon sasi) kurse përsëritja e të njëjtit element leksikor (foljes), kush-tëzon karakterin e papërcaktuar të *sasisë* së shtjellimit të veprimit.

Këto konstrukte tautologjike që mund t'i quajmë «konstrukte tautologjike të aspektit durativ të papërcaktuar» janë shumë të përdorshme në gjuhën e folur, si dhe në letërsinë artistike, në stilin kallëzimtar. Ky përdorim i gjerë shpjegohet me faktin se konstrukti tautologjik i aspektit durativ të papërcaktuar pasohet gjithmonë nga një fjali tjetër, e bashkërenditur me të ose nga një fjali e varur kohore me lidhëzën *gjersa (deri sa)*, gjë që tregon se veprimi i shprehur nga tautologjia është një hallkë në vargun e disa veprimeve që ndjekin njëri-tjetrin. Në stilin kallëzimtar, përparimi i aksionit kërkon përdorimin e konstrukteve që shprehin marrëdhënje suksesioni kohor; kjo kush-tëzon përdorimin e shpeshtë të këtyre konstrukteve. Duke u mbështetur në materialin që disponojmë mund të themi se ndër gjithë konstruktet tautologjike, më

i përdorshmi është pa dyshim «konstrukti tautologjik i aspektit durativ të papërcaktuar».

Me konstruktin tautologjik mund të bashkohet.

a) një fjali e bashkërenditur me lidhëzat këpujore *e, dhe, edhe, Mbajti lufta sa mbajti* e kur u pa se nuk po dilte në krye (.) *ka ardhur ferman nga Stambolli* se Malush Aga Katunishti është i falur. /Kuteli, Netë shqiptare (91).

*Gjezdisa sa gjezdisa* dhe gjë s'katandisa.

«... e të veç sa të veç ditë, edhe natën të ktheneç nga tjetrë udhë, edhe të vëç këtu. /Pedersen: Alb. Texte (Kartë për n'airet)/.

*Shkoi sa shkoi* edhe këtij të mirit puna na i vinte për bukuri (...). Kuteli. Kap. Aga (46).

Si të bënin? Të prisnin keq, të rrinin keq! Poshtë i piu dëbora. *Pritën sa pritën* dhe, duke u tërhequr zvarrë, bënë përpjetë. /Kacori: PM (II) 152/

b) Shumë fjali bashkohen me konstruktin tautologjik asidentisht, por si mjet për theksimin e pasimit marrin ndajfoljen e kohës *pastaj*; këtë ndajfolje e marrin edhe kur janë të bashkërenditura me lidhëza këpujore:

*Tafili ndenji sa ndenji* me burrat, *pastaj* iku. /Kacori: PM (II) (137)/.

/Rrogzotari /*Ndenji sa ndenji* ashtu, *pastaj* iku nga kish ardhur. /Kuteli: Hapu, malore! Xinxifillua (132)/.

*Marina ngurroi sa ngurroi, pastaj* shtoi. /Spasse: Buzë liqenit (354)/.

*Zjeva sa zjeva* me vete për ata njëmijë e dyqind dollarët, *pastaj* i harrova. /Kuteli: Një natë tetori (102)/.

*Folmë sa folmë*, *pastaj* /barba Koçua/ tha: Po ai, po aty (102)

*Ariu rri sa rri*, vret mëndjen, *pastaj* thotë /Po ai, Xinxifillua (241)/.

c) Rrallë mund të bashkohet me konstruktin tautologjik një fjali e bashkërenditur me lidhëzën kundërshtore *po (por)*;

... edhe djali mori udhën e tij prapë edhe ikënej. Iku sa iku, *po kur she një shtëpi me një shesh të madh, e si pa shtëpin*, u nis e vate në shtëpi; (...). /Pedersen: Alb. texte (33) Birbil gjizari/.

*Vajza e urtë duroi sa duroi, por një ditë (...)* i këcei merzi e madhe e u zhgreh në vaj. /Kurti: Prralla Kombëtare (I) (62)/.

ç) Me konstruktin tautologjik mund të bashkohet me lidhëzën nënrenditëse *gjersa (deri sa)* një fjali e varur kohore, e cila tregon se veprimi i shprehur nga konstrukti tautologjik zgjat deri në momentin që fillon veprimi i fjalisë së varur dhe ndërpritet prej tij.

/Rrogzotari / *Rri sa rri aty*, lidhur me brez pas trungut, *gjersa e pret gjumi*: /Kuteli: Hapu, malore, Xinxifillua (137)/.

*I ranë sa i ranë* fyellit, *gjersa bota u mërzit* e s'ua vari më. /Kuteli: Një natë tetori, «Nëndori» 7/1962 (103)/.

*Ndenja sa ndenja* në ato vise (.) *gjersa më thirri një ditë mylazimi*, më dha një nishan e më tha: /Kuteli: Kap. Aga (19)/.

*Shkoi sa shkoi*, kështu në të mira (.) *gjersa namëta arth e u ndryshua moti* se zunë luftra të mëdha e gjaku u derdh si lumë. /Kuteli: Kap. Aga (47)/.

Në këtë shembëllin e fundit, karakteri i menjëhershëm i ndërprerjes së veprimit është dhënë vetëm e vetëm me mjete leksikore, me ndajfoljen *namëta*.

Ngandonjëherë periudhat ku ndodhen dy konstrukte tautologjike mund të bashkohen asidentisht, dhe të pasohen nga një fjali e bashkërenditur këpujore. P.sh.:

*Dëgjova sa dëgjova* zhurmat e mëngjezit, *vështrova sa vështrova* vijat e ngatëruara të tavanit edhe mizën që hynte e dilte nëpër telik edhe *pastaj* vendosa të ngrihem. /Kuteli: Kap. Aga (70)/.

/Perëndia/ U kërrus dhe mori nga bregu i lumit një dorë baltë, e *gatoi sa e gatoi*, e *punoj sa e punoj* sipas shëmbëlltyrës së vet e më në *fund* i fryti në hundë (...). /J. Xoxa: LiV (II) (173-4)/.

Duke dashur që të theksohet kuptimi i pasimit të një veprimi nga një tjetër, shkrimtari J. Xoxa ka transformuar konstruktin popullor duke e prirë konstruktin tautologjik nga lidhëza kohore *passi*, *pasi* dhe duke e shndërruar gjymtyrën kryesore të konstruktit tautologjik në një fjali të varur kohore «të paskohësisë». Këtë e ka bërë në të dy variantet e të njëjtit fragment.

Pastaj papu Stefani, *passi psali sa psali*, ngriti gjethen e arrës, e vulosi sytë. /Novela (I) (55)/.

Papu Stefani, *pasi psali sa psali*, si duket (,) mbaroi dhe ngriti gjethen e arrës e zuri sytë. /Novela (II) (97)/.

Në ndonjë rast tjetër, vetë gjymtyra e parë e konstruktit tautologjik shërben si fjali kryesore për një fjali të varur kohore me lidhëzën *si*:

... dhe /djali/ iku e vate nga ajo udhë, që i tha asllani, të mos të vij: e *si mori udhënë, iku, sa iku*. Atje i dalën tri ipe ... /H. Pedersen: Alb. texte (33)/.

Shumë rrallë konstruktin tautologjik mund të paraqitet i pashoqëruar nga fjali të tjera sintaksorisht të lidhura me të. P.sh.:

Edhe iku ai /djali/ vate sa vate; atje i dolli ëngjëlli përpara, i thotë: H. Pedersen: Alb. texte: Kizmetin e gjen përpara, Mbledhës (I) (371)/.

*Ecën sa ecën nëpër dëborë*. Papritur dëgjuan ca ulërime, që herë ndiheshin, herë heshtnin. /Kacori: PM (II) 153/.

Përnjëmend /ariu/ mbetet i mekur, se e ka dehur gazi. *Rri sa rri këshu, me turinjtë e thinjur lart në erë*. Kur hapi përsëri sytë, zbardhëllima ish tretur: /Kuteli: Xinxifillua (30-31)/.

Trajtat e foljeve të konstruktit tautologjik janë rëndom ato të dëftores: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, të cilat kanë një përdorim shumë të gjerë.

a) foljet në të tashmen e dëftores: *Punonj sa punonj* dhe ndes një cigare. /S. Floqi, «Skicë...» (v.c. 114)/.

Po tjetër është puna e burrit. *Duron sa duron* dhe, kur e keqja arrin te nuk mban më, mund t'i thuash atij që të ka nën vete; ... /Musaraj: Para agimit (I) (461)/.

Nuk i kanë marrë në dorëzim /kanalet, S.F./ pasi ato janë pastruar me cilësi të dobët (...), edhe ata të ndërmarrjes së ujërave *rezistojnë sa rezistojnë* dhe, duke mbyllur një sy, janë të detyruar të marrin në dorëzim edhe kanale, pastrimi i të cilave nuk është bërë sipas rregullave teknike. /Milto Ferro: Çfarë është preokupante në sistemin vaditës», «Zëri i Popullit», 29 prill 1965, f. 3/ 2/.

b) foljet në të pakryerën e dëftores:

/Fëmijët/ *Prisnin sa prisnin*, pastaj zinin vetë e kërkonin nëpër xhepat. /Kacori: PM (II) (130)/.

*E mullahu*, sikur të desh vërtet t'i mbajë me gajret, *rrinte sa rrinte*, e i a niste kollës prap... /Shuteriqi: Çlir. (II)/.

I lirë ishte ky qymyri i Babales asohere, po kish njerëz shumë, që nga beu e tatëpjetë, që s'ia pagonin. *Dhe Babalja lutej sa lutej* edhe pastaj shkante prapë në mal edhe harronte. /Kuteli:

c) foljet janë në të kryerën e thjeshtë:

Të parët u hoqën mënjanë. *Folën sa folën* pastaj thirrën në mes të tyre Çomen, çirakun e Kice Terziut./ Kacori: PM (II) (178)/.

*Ndenj sa ndenj* edhe atje pastaj i ra nërmënt kjo botë këndeje — bandilli edhe nipërija — edhe tha të niset. /Kuteli: Kap. Aga (50)/.

/Teto Naja/ *Mallkoi sa mallkoi* e pastaj u lodh. /J. Xoxa: LiV (II) (101)/.

Shumë më rrallë përdoret trajta e së kryerës së plotë:

/Vita/ *Kishte qarë sa kishte qarë* e pastaj qe ngritur e lehtësuar. /J. Xoxa: LiV (II) (225)/.

E shoqja nëpër gjumë dëgjoji tërsëllimën e derës dhe u ngrit e llahtaritur: *ajo kishte pritur sa kishte pritur* të shoqin për ta lajmëruar për atë që kishte dëgjuar nga plaka Selime e për atë që kishte parë në sëndyk. /Spasse: Afërdita përsëri në fshat, V/.

Trajtat e mënyrës lidhore përdoren shumë rrallë. P.sh.:

Plumbat u vëshëllenin mbi kokë. — Fiu! Fiiuuu! Fiiu! Resuli po mendohej si të bënin dhe vendosi *t'u shtien sa t'u shtien* që prapa gurëve, pastaj *t'u kërcenin përsipër*. /Kacori: PM (II) (186)/.

Në rumanishte, gjymtyrët e tautologjisë në periudhë mund të bashkohen me fjalën *cît* (shqip *sa*), e cila paraqitet herë si përemër pyetës lidhor (GLR, I, 160), herë si ndajfolje dhe herë si lidhëz (GLR, I, 161). Fjala *cît* i përgjigjet plotësisht fjalës *sa*. Kuptimi i tautologjisë në rumanishte është si dhe në shqipe. Me konstruktin tautologjik mund të bashkohet, si në shqipe, një fjali e bashkërenditur me lidhëzën këpujore *și* (= dhe), ose një fjali e varur me lidhëzën nënrenditëse kohore *pîna* (= gjersa).

Por në rumanishtet gjymtyrët e tautologjisë mund të bashkohen edhe me fjalën *ce*, e cila ka shumë kuptime, ndër të tjera ato të përemrit shqip *ç*, (përemër pyetës, përemër i pakufishëm, përemër lidhor); kur prihet nga parafjalët *de*, *la*, *pentru* përemri *ce* ka vlerën e përemrit pyetës të ngurosur të shqipes *se* (krahaso *de ce*, *la ce*, *pentru ce* = përkritazi *nga se*, *prej se*, *për se* (përse)). Nga ana tjetër në gjuhën popullore dhe në gjuhën e vjetër fjala *ce*, ashtu si dhe fjala shqip *ç*, (*çfarë*) ka kuptimin e ndajfoljes pyetëse «përse» «pse» në: «Ç'më do» «Ç'më thirre?» Por fjala *ce*, si përemër lidhor, është në konkurrencë me përemrin lidhor *care*, (që ka dalë nga lat. *qualis*, ka qenë pajisur më vonë me një, por këtë e ka humbur) duke u përdorur «në gjuhën e shkruar, posaçërisht në poezi dhe në stilin «e kërkuar» (cautat)». Në këtë rast i përgjigjet përemrit lidhor shqip *që* (gg. *qi*), (ndërsa përemri *care* i përgjigjet përemri *i cili*); po ashtu dhe te togjet *cel ce* (= ai që), *ceea ce* (= ajo që) *cei ce* (= ata që). Në gramatikën e gjuhës rumune të Akademisë thuhet shprehimisht se «Në konstrukte me foljen e fjalisë drejtuese të përsëritur, fjala *ce* ka vlerën e një ndajfoljeje lidhore (relativ) dhe kuptim kohor, duke qenë ekuivalente me *cît* (kohë)» (I, 166). *Ce*, kur bashkon fjali që varet nga folje *kalimtare veprore*, mund t'i korespondojë përemrit shqip *ç* (natyrisht për shqipen vlera do të jetë në radhë të parë objektore), mirëpo nuk jemi të sigurt në kemi, në raste të veçanta, veç vlerës së papërcaktueshmisë lidhur me objektin — drejtpërdrejt apo nëpërmjet tij — edhe papërcaktueshmi nga pikëpamja sasiore (*ç* = *sa*). Nga ana tjetër, kur foljet janë *jokalimtare* fjala *ce* (krahas fjalës *cît*) nuk mund t'i korespondojë veçse ndajfoljes përemërore — lidhëz *sa* të shqipes. P.sh.:

*A stat ce — a stat și — i dete-n gînd*  
 Să iasă după fată. /Coșbuc, GLR, I, 166)/.

*Bocanește el cît bocanește, cînd pîrr! cade copacul peste car /Creangă, DLRLC, I, f. 446/2/.*

## II.10. Konstruktet tautologjike bashkuar me shpehjen lidhëzore «si...që»

1

Konstruktet tautologjik i tipit «Beu, si bej që ish, vriste e priste» ka lidhje me konstruktin relativ ku fjalia kryesore përmban «një plotësor karakterizimi» (sipas terminologjisë së F. Brynoit)<sup>31</sup>, plotësor që shtjellohet nga një fjali e varur përcaktore. Elementet kryesore të kësaj periudhe mund të jepen thjeshtësisht kështu: formula 1) E/Pr+ (si E/MB) + që + F këpujë *jam, dukem, hiqem, kam*.

Aty kemi një gjymtyrë të shprehur me emër ose përemër, e cila shtjellohet nga plotësori i karakterizimit (i shprehur me emër ose mbiemër të prirë nga fjala *si*), plus mjetin e lidhjes *që*, i cili bashkon fjalinë e varur, është një përemër lidhor i pandryshueshëm, sui generis, i cili përmend në fjalinë e varur ose një emër ose një mbiemër, përemër lidhor që luan rolin e kallëzuesorit në fjalinë e varur, pranë disa foljeve me kuptim të caktuar, si *jam, dukem, hiqem, kam* (folje-këpujë abstrakte ose gjysmabstrakte). Foljet e tjera nuk përdoren.

Kjo formulë e përgjithshme mund të na japë konstrukt tautologjik vetëm në rast se te «E/pr» kemi vetëm E (domethënë vetëm emër dhe jo përemër) kurse te «E/MB» kemi gjithashtu vetëm emër (dhe jo mbiemër) përndryshe nuk do të kemi tautologji: kështu që formula 1 reduktohet për konstruktet tautologjike si vijon:

formula 2):  $E + (si\ E) + që + folje-këpujë\ «jam»,$

Prej Stefan Priftit<sup>32</sup> konstruktet që kemi dhënë sipas formulës 1 janë quajtur fjali shkajkore që «ndërtohen shpesh me lidhëzën e krahasimit *si*, pas së cilës vjen një folje me lidhëzën *që* përpara, d.m.th. «si... që + folje» p.sh.: 1) ... ndenji mu në krye të vatrës si më plak që ishte: 2) «Domosdo, si fetar që hiqej, tespjet nuk i ndante nga dora kurr.» (215).

Konstruktet në fjalë ngre disa probleme: nga këto, dy janë kryesore dhe dy — të dorës së dytë, dhe pikërisht:

a1) Funksioni i sotëm i «fjalës me *si* (d.m.th. vlera e «plotësorit të karakterizimit»;

a2) Funksioni i sotëm i «fjalisë me *që*»;

b1) Funksioni origjinar i «fjalës me *si*»;

b2) Funksioni origjinar i «fjalisë me *që*».

Le të shohim si u është përgjigjur këtyre pyetjeve Stefan Prifti:

a1) Autori nuk thotë asgjë për funksionin e sotëm të «fjalës me *si*», për të cilin duhej bërë fjalë domosdo, sepse ai është vendimtar për kuptimin;

a2) S. Prifti ka interpretuar gabim funksionin e «fjalisë me *që*» duke theksuar se «në këto konstruktet, shkakun e përmban në të vërtetë fjalia me *që*» (po aty, 216).

31) F. Brunot, *La pensée et la langue*, 3e éd., Paris 1953, f. 318.

32) Stefan Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa II, disp. II, Tiranë, 1962.

b1) Sipas St. Priftit, «pjesa me *si* ...» ka qenë në funksion të një plotësori të krahasimit a të mënyrës, ose edhe të një plotësori kallëzuesor» (po aty, fq. 216);

b2) «Fjalja me *që* ka qenë «me sa duket, në origjinë, e ndërmjetme» (po aty, 216).

Në këto thënje të Stefan Priftit përmbahen, nga një anë, një pohim i gabuar mbi funksionin e *tanishëm* të «fjalisë me *që*» përbri një hesh-tjeje të plotë të funksionit të *tanishëm* të «fjalës me *si*», ndërsa, nga ana tjetër, paraqiten dy pohime të plota, mbi funksionin parësor, si «të fjalës me *si*», ashtu edhe të «fjalisë me *që*», gjë që nuk çon aspak ujë në shpjegimin e drejtë të vlerës së konstruktit dhe nga e cila autori s'kish si të dilte me konkluzionin e drejtë se «shprehja» *si*... *që* + foljen» mund të barazohet, duke harruar nuancën e hollë të krahasimit, që i jep një farë bukurie të veçantë, me shprehjen, «me *që*... + foljen», d.m.th. «si më plak që ishte» mund të pranohet nga ana e kuptimit, baraz «me që ishte më plak» (po aty, fq. 216).

Shpjegimi duhet të jetë krejt ndryshe. Në fakt, «fjala me *si*» («plotësori i karakterizimit»), i cakton një karakteristikë një sendi, dhe kjo karakteristikë (veti a cilësi, tipar), duke u veçuar sintaksorisht prej fjalës që përcakton (nëpërmjet të theksimit e të pauzës) merr vlerën e një plotësori të shkakat, kështu që në këto konstrukte shkaku e veprimi të fjalisë e tregon «fjala me *si*», d.m.th. «plotësori i karakterizimit», i cili nëpërmjet të veçimit, mer një vlerë «gjysmëpredikative»; «fjalja me *që*» nuk bën tjetër gjë veçse e aktualizon këtë karakteristikë plotësisht, duke e vendosur në mënyrë, kohë edhe vetë; me fjalë të tjera, «fjalja e varur me *që*» e vendos «fjalën me *si*» në predikativitet, nëpërmjet të një apozicioni, dhe kjo fjali është një variant i fjalisë së varur atributive, fjali apozitive, ndajshimore. Kjo është kështu vetëm e vetëm nga ana thjeshtë formale, duke u shkëputur nga kuptimi.

Le të shohim në krye kuptimin e «plotësorit të karakterizimit» përbrenda fjalisë.

Themistokliu, *si kryetar i vetëdashësve*, ishte ngarkuar të kujdesej për qetësinë e vëndit (Kacori: PM (II) (252)/.

Th. (F): Bëre shumë mirë që erdhe. *Si sekretar i organizatës dhe si shef i planit* (,) duhet të thuash fjalën tënde /S. Çomora: Syleshi (85)/:

Për lëvizjen /Safeti/ fliste gjithnjë mirë dhe i vinte keq që, *si i shkuar në moshë*, nuk i merrte dot pas të rinjtë që bënin detyrën e tyre /Sh. Musaraj: Para agimit, «Nëndori» Nr. 11, v. 1963 (53)/.

«E ç'dobi do të kish se u shtri në dëborë?» — mund të pyesë ndokush; për ay, *si njeri i stërvitur*, e dinte mirë se korja e dëborës, ashtu si edhe faqja e ujërave, ia kthejnë rrugën plumbit / S. Andoni: Maleve në Shënëndre (4) /.

Në të gjithë këta shembuj fjalët e nënvizuara «plotësorët e karakterizimit» janë plotësorë shkaku.

Funksioni atributiv (përcaktor) i «fjalisë me *që*», duket qartë te shëmbulli i mëposhtëm i Nolit.

*Si i pari gjeneral turk që mundi një ushtri të Skënderbeut*, (Evrënozi/ u prit në Stamboll me triumf dhe u festua si luani i ditës /HeS<sup>2</sup> (77)/.

Gjithashtu shihet qartë edhe karakteri përemëror i fjalës *që* (përemër lidhor); del qartë edhe funksioni shkakor i «plotësorit të karakterizimit». Ky model ka shërbyer për konstruktet tautologjike me fjalën *që*, me kufizimet që thamë më sipër, duke e ngushtuar veç kësaj për-

dorimin e foljeve kuptimplote ose të këpujave gjysmabstrakte vetëm te folja-këpujë *jam* te fjalja e varur.

I thotë qosja (gruas) që «...po të ishte me muqim që t'i presë bish-tin /kaut/, do shitej më shumë. Edhe *gruaja, si grua që ish*, pandehu vër-tet edhe i preu bish-tin kaut edhe iuk vate më tej më një tjetër urë /H. Pedersen: Alb. texte (70), Qosetë edhe bujku/.

Fjala «grua», te plotësori i karakterizimit *si grua*, thekson një ti-par të gruas (të konceptuar natyrisht, gabimisht, sipas botëkuptimit prapanik, si mendjelehtë, naive etj. etj.), prandaj te gjymtyra *si grua* përbahet një karakteristikë vlerësuese e kryefjalës *grua*; kjo karakter-istikë, e veçuar sintaksorisht, përbën njëkohësisht shkakun e foljes kallëzues *preu* dhe fiton kallëzuesi të plotë nëpërmjet të fjalisë *që ish*, të përbërë vetëm nga kallëzuesi emëror (folja këpujë *ish* dhe kallëzuesori *që*, i cili si përemër lidhor sui generis përmend në fjalinë e varur një fjalë që tregon tipar, veti a cilësi të kryesores).

Kështu pra përsëritja e emrit te plotësori i karakterizimit tautolo-gjik ka po atë vlerë që ka edhe përsëritja e kallëzuesorit emër: shpreh, duke i theksuar, tiparet karakteristike inherente të emrit kryefjalë, karakteristike që bëhet shkak për veprimin e fjalisë ku ndodhet. P.sh. *si prift* do të thotë në kontekstin e shembullit të mëposhtëm, në bazë të konceptit të gabuar fetar, reaksionar, si *njeri i drejtë*, si *njeri i fesë*, i *perëndisë* etj.

Atje janë sëritur sëndyqet me eshtrat e priftërinjve të nxjerra nga dheu tre vjet pas vdekjes, sipas zakonit; se në tre vjet *prifti* (*si prift* që është) gjëndet në dhë i tretur me këmbët shtritur e trupin përpjetë ashtu si e do e drejta. /S. Andoni: Maleve në Shënëndre (15)/.

Një karakteristikë e përshtatshme për çdo rast konkret i jepet beut me plotësorin e karakterizimit — plotësor shkaku te shembulli i M. Kutelit dhe ai i Xoxës.

Kahreman *Beu*, që vriste e priste asaj kohe si i desh zefku, hyri dhe ay në valle se e kish mik të vëllanë e Ndrio Belortasë e mori rryshfet sa plasi, *si bë që ish*. /Kuteli: Netë shqiptare (108)/.

Që atë ditë Masar *beu*, *si bej që ish*, vriste mëndjen se si mund të pihet në dy sisa bashkë. /Xoxa, Novela (II) (35)/.

Siç del nga vështrimi përmbledhës që parashtron Mioara Avram në veprën «Evolutia subordonării... v.c. f. 85-89) del se edhe në ruma-nisht ka pikëpamje të ndryshme. Në disa vepra konsiderohen si fjali shkakore konstruktet e tipit *de draga ce-i era*, si te vëllimi i dytë i Gramatikës rumune të Akademisë, botim i parë, në të cilin merret parasysh vetëm prania e fjalës *de* e cila jepet si lidhës që bashkon një fjali të varur shkakore. Në vepra të tjera, si te *Dictionarul limbii romine literare contemporane* (v.c.) te artikulli *de*, thuhet se lidhëza *de* «së bashku me fjalën *ce*» bashkon një fjali shkakore. Edhe Akad. Iorgu Iordan në botimin e parë të veprës «Limba romina contemporana», shqyrton gjithë konstruktin si fjali, pa u marrë me natyrën e fjalës *de*.

Një konstrukt rumun që i korrespondon shqipes është ai që ka «*de... ce + a fi* si këpujë»; por përputhje të plotë me shqipen ka konstrukt i përbërë nga «*ca + emër + ce + folje «a fi»* (ku *ca* i përgjigjet shqipes *si*, *ce* — shqipes *që* dhe *a fi* foljes-këpujë *jam*, si te shembulli: Rama-ind afarë, Toderică bågă mina în buzunar și *ca un poznaș ce era*, scoase un condei de credă (...). Negruzzi, (MA-ES, 88).

«Ky konstrukt, (konstrukt i «*ca + substantiv + ce + verbul copu-lativ a fi»*, S. F.) — shkruan M. Avram, — analizohet në një plotësor

rrethanor të mënyrës në fjalinë drejtuese *ca + mbiemër* dhe një fjali përcaktore (atributive) të bashkuar me *ce* dhe nuk cilësohet në bllok si një fjali e varur shkakore» (88).

Pavarësisht nga mënyra e analizës që i bën konstruktit M. Avram-i, struktura e konstruktit i përgjigjet plotësisht strukturës së konstruktive përkatës të shqipes. Edhe vlera e tyre i përgjigjet plotësisht vlerës së atyreve të shqipes. Por ne jemi të mendjes se konstrukti shqip «*si + Emër/Mbiemër + që + folja-këpujë jam* dhe konstrukti përkatës rumun «*Ca + N/adj + ce a fi*» mund të interpretohet jo më si plotësor mënyre, por si «plotësor shkak i fjalisë kryesore plus fjali e varur përcaktore shpjeguese, në daçim t'i analizojmë veçan, po të vështrojmë vetëm anën thjesht formale të çështjes; por po të shohim kuptimin e qartë të konstruktit (dhe kjo është zgjidhja më e drejtë), do ta konsiderojmë pa druajtje gjithë konstruktin si një fjali të varur të shkakut që ka si mjete lidhjeje njëkohësisht fjalën *si* dhe fjalën *që*, të cilat funksionojnë si një *shprehje lidhëzore të shkakut*, shprehje lidhëzore me elementet në distancë: *si... që*, rum: *ca... ce*.

Për rumanishten tashpërtash nuk disponojmë konstruktive tautologjike me «shprehjen lidhëzore në distancë» *ca...ce*, por modeli sintaksor ekziston («*ca un calif ce era*», «*ca un poznaș ce era*»), prandaj do të mjaftonte të rimerrej një kryefjalë e shprehur me emër në fjalinë kryesore me të njëjtin emër me *ca* në prepozicion dhe me *ce* para foljes këpujë *a fi* që të kishim dy gjymtyrët e një konstruktive tautologjike<sup>33</sup>.

(*Califul*) S-a apucat de treabă *ca un calif ce era un boț, cu ochi ce te găsești, o bucată de huma insufleșita din sat de la noi /CREANGA, te Elean Carabulea Atributivele determinative și explicative «Studii de Gramatica», III, București, 1961, f. 144/.*

## II. 11. Konstruktet tautologjike me lidhëzën kur

Në gjuhën e folur, sidomos në dialog përdoren konstruktive tautologjike të bashkuar me lidhëzën *kur*, e cila sipas situatës ose kontekstit mund të jetë thjesht kohore ose mund të ngërthejë edhe një nuancë kushti. Nuanca e kushtit ndihet sidomos kur kallëzuesit janë shprehur me trajta kohore që tregojnë përsëritje, si e tashmja, e pakryera.

*Kur je i mirë, je i mirë*  
*Kur qeshim, qeshim.*

Vlera e konstruktive është të theksojmë veprimin a tiparin e një sendi si diçka që i përgjigjet plotësisht brendisë së foljes, tërësisë së tiparit, të çfaqur deri në shkallën më të lartë. Rendi i rëndomtë është F<sub>2</sub> F<sub>1</sub> (fjali e varur — fjali kryesore).

*Kur bëjmë shaka, bëjmë shaka. Kur punon, puno; kur luan, luanj.*

33) Zaten modeli përkatës nuk ekziston vetëm në rumanishten, ai ekziston edhe në gjuhën frënge. Ferdinan Bryno-i në veprën e cituar *La pensée et la langue* (f. 819) jep shembujt: *Comme un brave qu'il...; Le seigneur comme juste qu'il est... Comme des cousins qu'ils étaient, ils avaient continué de se tutoyer*» M. Grevisse, në veprën *Le bon usage*, septième édition, revue, 3e tirage, P. 1961 (f. 458, § 547) jep ndër të tjera, një shembull me «*Que, relativ*», i cili «mund të jetë kallëzuesor neutr»: *Deux rangées, de hautes maisons centenaires qui se taisent comme des vieillards qu'elles sont* Hugo, *Les Misér.*, IV, 15 I /., kështu që kemi konkordancat: shqip — *si+E/Mb.+që*, — rum *ca + E/Mb. + ce*, — fr. *comme + E/Mb + que*, të pasuara përkatëzi nga këpujat; shqip — *jam*, rum. *a fi*. fr. *être*.

Më shpesh këto konstrukte përdoren kur japim një këshillë për veprim, ose kur bëjmë një vërejtje lidhur me një veprim, dhe kërkojmë përshtatshminë e plotë të veprimit a cilësisë me vetveten. Në ligjërimin e përditshëm ato janë mjaft të përdorshme.

Në rumanishte këto konstrukte kanë më fort kuptim kohor, sepse sipas dëshmisë së Mioara Avramit «në gjuhën e sotme letrare, lidhëza *cînd* (=kur) kushtore nuk përdoret», «kurse një shekull më parë ishte e shpeshhtë» (v. c. f. 200).

Megjithatë, na duket e vështirë të ndahet kuptimi kushtor nga ai kohor edhe në një shembull si i mëposhtmi, midis gjymtyrëve të tautologjisë të të cilit, Gramatika e gjuhës rumune të Akademisë (botim i dytë) sheh marrëdhënje kohore.

La munte *cînd ploua, ploua*.

## II. 12. Konstruktet tautologjike me lidhëzën në

Lidhëza kushtore në përdoret me foljen e fjalisë së varur në dëftore ose në dëshirore, sipas faktit që veprimi jepet si real (dëftorja) ose i mundshëm, i dëshirueshëm, eventual (mënyra dëshirore dhe jo lidhorja).

Në *shpëtova* dot, *shpëtova*, nuk *shpëtova*, le ta pësoj. /H. Pedersen: Alb. texte (22)/.

— Të dalë ajo Shqipëri në mejdan!

— Në e nxjerrç ti/ e nxjerrç. / S. Floqi v. c. (128)/.

Konstruktet tautologjik ka për funksion të theksojë kallëzuesin duke e treguar, si të thuash, të vetmen mundësi të shtjellimit të veprimit (=vetëm ti mund ta nxjerrç Shqipërinë në mejdan).

Në *më shpëtofs dot, më shpëtove*; se ndryshe jam i humbur. /Pederson: B.B. (1884, 235, Lambertz: Die Konditionalsatz in der albanischen Sprache, përkthim shqip, Arkivi i Instituti, f. 87) /.

Në rumanisht gjymtyrët e konstruktit tautologjik bashkohen me lidhëzën kushtore *dacă*, dhe ka po atë vlerë që ka edhe në shqipe. Krahasoni: *Dacă mi da, mi da*; *daca* nu... dhe «Në *vjen, eja*; në mos, *ika*», ku vlera është e afërtë me «në ke ndërmend të vish, *eja*».

## II. 13. Konstruktet tautologjike asindetike.

Togun e tipit «*humi — humi*» (= *humbi-humbi*) e ka shqyrtuar për herë të parë M. Çeliku (v.c. f. 175). Ai ka vënë në dukje bashkimin asidentik të komponentëve si dhe intonacionin e togut: «ritmi i ligjërimit karakterizohet nga një *shpejtësi e madhe* edhe nga ana tjetër për sa i përket melodikës së tonit këtu kemi një *ngritje të tonit*, që arrin kulmin në shqiptimin e komponentit të dytë të togut» (175) dhe jep shembujt, të mbledhur në Shqipërinë e Mesme: *vdiq-vdiq* — me zor as mbreti s'e ma ymrin (Gr. Z.); *thahet-thahet* / çer t'i bajm t'ftoftit (R.) *u myt — u myt* / fain e ka vet (Rr.)» (f. 175).

Më pas, E. Lafe (v. c. f. 123) shqyrton përsëritjen në bazë të shembujve të marrë nga të folurit të përditshëm: «*Iku, iku*, prapa diellit s'ka vajtur?; *U thye, u thye*, s'u bë kijameti për një filxhan, de!; — Shiko mos shkasësh. — *Shkava, shkava*, baltë është».

Për intonacionin ai i referohet punimit të M. Çelikut, ndërsa shton nga ana e vet për funksionin sintaksor të gjymtyrëve të përsëritjes: «e para është protasa dhe e dyta është apodosa e një periudhe hipotetike tautologjike, (sepse kushti i shprehur në protasë është njëkohësisht pasoja që përmban apodosa. e dalë nga një fjali pyetëse si *Shpëtova? Shpëtova*» (123).

Karakterizimi i strukturës së togut te këta autorë nuk është i plotë. Së pari, duhet thënë se konstrukti tautologjik përbën një përsëritje dyfishe në një replikë ndaj një foljeje të përmendur nga bashkëfolësi, siç del qartë nga shembulli: Shiko mos shkasësh? — *Shkava, shkava...*, si dhe nga shembulli ynë që do të japim më poshtë, prandaj sfera e përdorimit të tyre është gjithmonë *dialogu* (shembujve të autorëve u mungon konteksti, i cili duhej të ishte dhënë domosdo); së dyti, ajo që karakterizon togun nga ana intonacionore nuk është as shpejtësia e madhe e tonit, as melodika e lartë e tonit, por shpejtësia e shoqëruar domosdo nga një farë «tensioni» të tonit dhe nga një pauzë e shkurtër, por e domosdoshme midis gjymtyrëve, nga një theks i zgjatur mbi rrokjen e gjymtyrës së dytë si dhe nga qëndrimi pezull i tonit në fund të gjymtyrës së dytë; qëndrimi pezull i tonit në një notë të lartë do të thotë se konstrukti nuk përdoret kurrë vetëm, por pasohet nga një fjali tjetër, fjali asindetike ose të bashkërenditur me lidhëz kundërshtore.

Paqartësi e pasaktësi ka sidomos në parashtrimin e vlerës. Nuk është i saktë shpjegimi që jep M. Çeliku, se «Kuptimi i këtij togu është ky: Të tregojmë një veprim çfarëdo, realizimin e të cilit asht e pamundur që ta pengosh: veprimi pra paraqitet si një fakt i kryem ose që do të kryhet pa tjetër». (175), sepse vlera e togut nuk është të tregojë domosdoshmërinë, pashmangshmëni e kryerjes së veprimit.

Nuk e sqaron çështjen më mirë as shpjegimi i gjatë i E. Lafes se gjymtyrët e përsëritjes tregokan «a) një veprim që ka marrë fund», «b) një veprim që ka shumë të ngjarrë të kryhet» dhe se «nga fjalia që pason përsëritjen zakonisht merret vesh se veprimi në fjalë është kryer ose mund të kryhet pa dashjen tonë, se nuk ka pasur ose nuk ka mundësi të pengohet realizimi i tij dhe se për këtë arsye asnjë nuk mund të konsiderohet përgjegjës për pasojat» (123).

Le të shqyrtojmë shembullin:

— Qysh the? Koziiii! Ç'më ia paska bërë mirë!... — *Iku* (,) the?

— Po, po, ca thonë se i mori kalin beut (...).

— *Iku iku*, (...) po edhe në bri të buallit sikur të futet, këtë radhë ma mori të keqen e dollomasë... i fliste prifti me brohori priftëreshës. /J. Xoxa: LiV (II) (90-91)/. Gjatë muhabetit, priftëresha i tregon të shoqit për zënkën e Kozit me beun, i cili e kishte detyruar Kozin ta mbante në kurriz, «kalakiç». Prifti, ihtar i beut, gëzohet në fillim kur merr vesh ç'i punoi beu Kozit, por lajmin e «ikjes», të arratisjes së Kozit, si veprim plot rreziqe për beun e pret me një farë rezinjacioni, si një nënshtrim ndaj një veprimi që nuk mund të «anullohet». Këto konstrukte tautologjike asindeike tregojnë se *pranohet me nënshtrim, me rezinjacion një ngjarje e papëlqyeshme ose pranohet nga e keqja me indifertizëm një veprim i vlerësuar në mënyrë negative nga bashkëfolësi*.

Në bisedimin e përditshëm këto konstrukte janë mjaft të përdorura. Konstrukti nuk njih kufizime leksikore, sepse folje të çdo kuptimi leksikor mund të bashkohen asidentisht, si përsëritje dyfishe e një foljeje që ndodhet në fjalët e bashkëfolësit. Këto konstrukte kanë lidhje me periudhat asindetike me kuptimin e kushtit dhe të lejimit, por nuk lidhen drejt për drejt me fjalitë kushtore të dala prej fjalive pyetëse, siç mendon gabimisht E. Lafe,

Në materialet tona për rumanishten nuk figurojnë konstruktet tautologjike përkatëse. Kjo çështje mbetet tash për tash e hapët.

## KONKLUZIONE

Të kuptuarit tradicional të tautologjisë është, sipas rastit, ose i paktë, ose kryekëput i gabuar. Koncepti i tautologjisë, koncept gjuhësor-brendior, i parashtruar prej linguistëve rumunë acad. Al. Graur dhe Eugenia Contras, ndonëse shënon një kthesë të rëndësishme, është prapëprapë akoma tepër i gjerë dhe ka nevojë për kufizime të ndryshme: për nga rasia e përkitazi nga veta, koha (si dhe nga diateza), dhe nga fakti që gjymtyra e përsëritur nuk duhet të ketë fjalë që varen prej saj — me përjashtim të mjeteve të lidhjes, duke lejuar nga ana gramatikore vetëm një ndryshim për nga nyja e përkitazi për nga elemente të intonacionit (sidomos theksi). Këto kufizime janë pjesë përbërëse të tautologjisë të cilën e kemi përkufizuar si vijon: «Tautologjia është përsëritje e së njëjtës fjalë ose e të njëjtit togfjalësh që ka po atë kuptim leksikor, po atë trajtë rasore, përkitazi po atë diatezë, kohë e vetë, por që nuk plotësohet prej ndonjë fjale a fjalie të varur dhe që ka funksion sintaksor të ndryshëm kur gjymtyrët e tautologjisë ndodhen në të njëjtën fjali, ose që ka po atë funksion sintaksor të kallëzuesit foljor a funksione të ndryshme, atë të kryefjalës e të kallëzuesit kur njëra gjymtyrë ndodhet në fjalinë kryesore dhe tjetra në fjalinë e varur». Konstrukt tautologjik është konstrukti i përftuar me tautologji.

Konstruktet tautologjike shprehin kuptime e nuanca të ndryshme si theksim të një cilësie a të një procesi; në raste të tjera në konstruktin tautologjik theksohet karakteri i vërtetë, autentik i tiparit të gjymtyrës së parë, kurse ndonjëherë, në kushte të caktuara, me to mund të shprehim edhe karakterin ekskluziv të tiparit.

Sfera e përdorimit të konstrukteve tautologjike është gjuha e folur e përditshme, sidomos me karakter bisedimor, dialogu, ku paraqiten si variante stilistiko-afektive plot gjallëri të mjeteve të tjera leksikore a leksiko-gramatikore që janë neutrale nga pikëpamja gjuhësore stilistike. Konstruktet tautologjike përbëjnë një pasuri të çmuar të mjeteve shprehëse të gjuhës.

Konstruktet tautologjike kanë dalë nga modelet mbarëgjuhësore, duke u vënë kufizime të ndryshme, qoftë leksikore, qoftë kategoriale; në mjaft raste modeli i parë nuk është më i tejdukshëm, aq sa ai mund të rivendoset me vështirësi mjaft të madhe. Veç kësaj, kufizimet leksikore mund të arrijnë deri në përdorimin real të një elementi leksikor, kështu që konstrukti tautologjik arrin pikën ekstreme të frazeologjizimit të tij (p.sh.: *bënte ç'bënte e... ose bëri ç'bëri e... , pa ç pa (e)... vinte nga vinte e... ; bëri si bëri e... etj.*). Elemente të ndryshme të strukturës së modelit — si rendi i gjymtyrëve të tautologjisë, mundësia a pamundësia e veçimit sintaksor të konstruktit, variacionet e skemave intonacionore — japin mundësi për diferencime strukturore dhe kuptimore midis elementesh të njëjta leksiko-gramatikore: për vlerën e intonacionit *krh.* p.sh. përsëritjen dyfishe të po asaj foljeje me intonacionin e numërimit *hëngri, hëngri* për të treguar intensitet të shtjellimit të veprimt, nga njëra anë dhe «— *hëngri, hëngri*, po shpejt i doli nga hundët», si replikë kundërshtore ndaj thënjes së bashkëfolësit e cila përmban foljen «hëngri» (o ndonjë ekuivalent të saj të përafërt semantik në trajtën e kryer e thjeshtë), konstrukt tautologjik me elipsën e

lidhëzës *që* (d.m.th. «*që hëngri, hëngri*, po...») «konstrukt tautologjik me fjali të «varur të marrëdhënjes» në prepozicion me vlerën e theksimit të kallëzuesisë dhe me kundërvënje, nga ana tjetër; krahaso vlerën e tyre me vlerën e një konstrukti tautologjik asindetik te shembulli: «— Zana s'e mbajti dietën siç i tha doktori, *hëngri*... — *Hëngri hëngri*, ç'do t'i bëjmë tani», ku kemi të pranuar me nënshtrim të një ngjarjeje të papëlqyeshme, konstrukt që lidhet me periudhat asindetike me marrëdhënje kushtore-lejore. Këto të tri konstrukte duhen dalluar nga një i katërt, ku mund të shohim një përsëritje të thjeshtë pa ndonjë vlerë të veçantë dhe që nuk formon tautologji, as «konstrukt me përsëritje» si te shembulli: «A hëngri drekë gjyshi? — *Hëngri, hëngri*; bile i pëlqeu shumë gjella», ku edhe karakteri intonacionor e tregon se heqja e fjalës së përsëritur nuk prish punë nga pikëpamja kuptimore.

Kështu mjaft tipe konstruktesh tautologjike janë sintaksorisht dhe kontekstualisht pjesë përbërëse të strukturave më të gjera përbrenda të cilave realizojnë ose shtjellojnë kuptimet e tyre të veçanta, aq sa eventualiteti i veçimit, i izolimit sintaksor të konstruktit nuk mund të zbulohet përherë me saktësi.

Në raste të tjera kufizimet leksikore të gjymtyrëve nuk janë të mëdha (f. v. te konstruktet e tipit  $F+sa+F$ , që pranon si *F*. çdo folje, të çdo diateze, me përjashtim të foljeve që tregojnë fillim veprimi, fund veprimi dhe veprim momentan, me fjalë të tjera folje, veprimi i të cilave nuk mund të bëhet objekt cilësimi për nga «sasia»), modeli sintaksor është i gjallë e i tejdukshëm, por prapëseprapë lidhja e brendshme është e tillë që në kallëzim konstrukti « $F+sa+F$ » përdoret rëndom për të treguar «aspekt durativ të papërcaktuar», kështu që konstrukti përbën sot një mjet për tregimin e kësaj nuance aspektore.

Me gjithë që jemi përpjekur të shtiem në studim sa më shumë tipe konstruktesh tautologjike, këtë s'e kemi bërë për një palë konstruktesh, sepse modeli i tyre i parë nuk mund të zbulohet dot me saktësi dhe ato nuk mund të përfshihen, sipas përkufizimit, në konstrukte tautologjike, ose sepse interpretimi i tyre si konstrukte tautologjike për ndjenjën e sotme gjuhësores të shqipfolësit do të dukej i sforcuar, «i nxjerrë me grep», pra pa ndonjë vlerë bindëse. Më vonë, ndoshta, do të kthehemi te disa prej tyre, duke gjetur edhe një bazë klasifikimi të përshtatshme.

Për konstruktet tautologjike të rumanishtes, variante pak a shumë frazeologjike të strukturave bazë, jo gjithmonë kemi qenë në gjendje të pohojmë a mohojmë praninë e tyre, sepse materiali i vjelë për këtë gjuhë ka qenë shumë më i kufizuar se për shqipen. Megjithatë, shpresojmë se punimi do të ngjallë interesimin e kolegëve tanë rumunë për paralelizma të reja, konkordanca ose divergjenca, të papërmendura këtu. Nga materiali i shqyrtuar na dalin një tog konkordancash të plota, një numër i madh konkordancash të pjesshme dhe vetëm disa raste të rralla divergjencash; kur kemi konkordancë të plotë, kjo e ka burimin në përputhjen e sistemeve morfologjike, fonetiko-intonacionore, në ekuivalencën e lartë të kuptimeve leksikore, jo vetëm të kuptimeve bazë por edhe të atyre të derivuara, në shkallë të ndryshme derivacioni (p.sh. konstrukte tautologjike «kryefjalë kallëzuesor»). Në rast konkordancash të pjesshme si te konstruktet tautologjike «plotësor i marrëdhënjes — kallëzues a kallëzuesor», që janë për rumanishten të vetmet që përdoren sot, ndërsa shqipja përveç përdorimit të shpeshtë të këtyre

konstrukteve, ka mundësinë të përdorë edhe konstruktet e periudhës me «fjali të varur të marrëdhënjes», si variant sinonimik sintaksor (e stilistik), të cilat rumanishtja nuk i njuh më, arësyeja duhet kërkuar në karakterin prodhues të modelit në shqipe dhe në karakterin joprodhues të modelit të rumanishtes «ca...ce», ndonëse modeli sintaksor ekziston (dhe jo min e rëndomtë «të konstrukteve tautologjike periudhë me fjali të varur shkakore» me lidhëzën e përbërë «si... që» në shqipe dhe për mungesën e konstruktit tautologjik në rumanishten e sotme me lidhëzën përkatëse të rumanishtes. «ca...ce», ndonëse modeli sintaksor ekziston (dhe jo vetëm të një gjuhë neolatine si rumanishtja, por edhe te frengjishtja, me sa kemi hetuar ne.) Në raste të tjera për shprehjen e një marrëdhënjeje sintaksore (f. v. lejimit në nënrenditje) të dy gjuhët zotërojnë nga dy modele (modelin e fjalive përcaktore me nuancë lejore, me përmër lidhor, dhe atë të fjalive lejore të mirëfillta — me lidhëz lejore), por për konstruktet tautologjike shqipja shfrytëzon modelin e periudhës me fjali të varur përcaktore (edhe kalamani që është kalama, i di të gjitha), kurse rumanishtja për konstruktet tautologjike të njëvlershme shfrytëzon modelin e periudhës me fjali të varur lejore, me lidhëza të ndryshme të mirëfillta të lejimit (*Soarele că e soare și tot mai are pete*, ose me lidhëza të tjera veç lidhëzës lejore *că, si cît(u), dacă*, etj. Një parapëlqim i tillë ka të bëjë, natyrisht, me arësye të ndryshme gjuhësore të brendshme ose historiko-gjuhësore të jashtme, hetimi i të cilave do të ishte me rëndësi të madhe për zbulimin e funksionimit të brendshëm të strukturave në secilën gjuhë.

#### LISTA E VEPRAVE NGA JANË MARRË SHEMBUJT

- |                   |   |
|-------------------|---|
| 1. A. Abdihoxha   | Tri ngjyra të kohës, «Nëndori», 1963, N. 8.                                     |
| 2. Dritëro Agolli | Përpara bukurisë, «DRITA», dt. 4 prill 1965                                     |
| 3. » »            | Zhurma e erërave të dikurshme. T. 1964  |
| 4. Sotir Andoni   | Maleve në Shënëndre, Tiranë, 1958.  |
| 5. » »            | Deç (Dasmë e çuditëshme) T. 1963  |
| 6. » »            | TreNgaM (Tregime nga Morava). T. 1960.  |
| 7. D. Bubani      | Bileta e llotarisë. Komedi, në DRAMA  |
| 8. Nonda Bulka    | Kur qante (Kur qante e qeshte bilbili) T. 1962                                  |
| 9. » »            | Skica e tregime T. 1950   |
| 10. Qamil Buxheli | Një ndodhi në plazh. T. 1962  |
| 11. Aleks Çaçi    | Na hoqën çatinë. Eotim i dytë. T. 1965  |
| 12. Spiro Çomora  | Kek (Karnavalet e Korçës). Komedi, në DRAMA                                     |
| » »               | Syleshi. Komedi. T. 1958.   |
| 13. Auguste Dozon | Manuel (Manuel de la langue chkipe ou Albanaise). Paris 1878.                   |
| 14. Drama         | Drama, T. 1964.   |
| 15. Kristo Floqi  | Reklamë e bloftë. T. 1926   |
| 16. Sami Frashëri | Shqipëria <sup>7</sup> (Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet). T. 1962. |
| 17. » »           | Besa. Dramë. Përkthim nga Ab. Ypi. Tiranë. 1937.                                |
| 18. Fatmir Gjata  | Këneta. T. 1959   |
| 19. Fatmir Gjata  | NëPreJ (Në pragon e jetës). T. 1960   |

20. » » Përmbysja. T. 1954
21. » » Tana<sup>2</sup>. T. 1959.
22. Thoma Kacori Ditë që s'harrohen. T. 1959
23. » » (PM) Për mëmëdhenë (I) Roman, vll. I. T. 1961.
24. « » (PM) Për mëmëdhenë (II), roman, vll. II. T. 1963
25. D. Kurti Prralla kombëtare<sup>2</sup> Ble I, Shkodër 1942
26. » » Prralla kombëtare<sup>2</sup> (II) Ble II. Shkodër 1943
27. M. Kuteli KapAga (Kapllan Aga i Shaban Shpatës). T. 1944.
28. » » Një natë tetori, «Nëndori» Nr. 7, v. 1962
29. » » Netë shqiptare. Botim i dytë. T. 1944
30. » » Xinxifillua T.
31. P. Marko Hasta la vista. Roman, T. 1958.
32. » » Shpella e Piratëve, T. 1964.
33. Gustav Mayer Albanesische Studien, V. VI, Iif: Mbledhës... (I)
34. IiF Mbledhës (të hershëm të folklorit) T. 196
35. Migjeni Vepra. Botim i dytë. Red. S. Luarasi. T. 1957
36. Th. Nikoli Në ato ditë stuhie. T. 1963
37. Th. Mitko Bleta shqiptare. Wien 1923.
38. Sh. Musaraj Isha unë Çobo Rrapushi. Llaz Qesarati. T. 1960.
39. » » Para agimit, Roman. Libri I. T. 1965
40. » » Të shkuara të harruara. T. 1957
41. N. Nikaj 1). Shkodra e rrethueme. 2). Bukurusha. Bot. II. T.
42. F. Noli HeS<sup>2</sup> (Historia e Skënderbeut). Botim i dytë Boston Mass 1949 HeS<sup>3</sup>; Hes<sup>2</sup>, botim i tretë T.
43. Holger Pedersen Albanesische texte (mit glossar). Leipzig 1895.
44. Justin Rrota Rreth votrës. Shkodër 1945
45. Kapllan Resuli Tradhëtia. Roman, 1965
46. Z. Sako Njerëz dhe ngjarje. Tregime. T. 1961.
47. N. Sinaeri Kokrra aguridhe. Tregime. T.
48. S. Spasse Afërdita (përsëri në fshat) T.
49. » » Ata (nuk ishin vetëm). Botim i dytë, T. 1960.
50. » » Buzë liqenit. Roman. T. 1965
51. Dh. Shuteriqi Çlirimtarët v. I, VII. 1954-5.
52. I. Uruçi Doktor Aleks. Dramë, «Nëndori» Nr. 9, v. 1963
53. J. Xoxa Novela (I). T. 1949.
54. J. Xoxa Novela (II). T. 1958
55. » » LiV (Lumi i vdekur) vëll. I. T. 1965.
56. » » LiV (Lumi i vdekur) vëll. II. T. 1965.
57. » » LiV (Lumi i vdekur) vëll. III. T. 1965.
58. V. Vinçani Pas furtunës, DRAMA

## Résumé

CONSTRUCTIONS TAUTOLOGIQUES EN ALBANAIS  
CONTEMPORAIN

(et parallèles albano-roumains)

L'étude représente la variante complète de la communication faite par l'auteur en août 1966 au Premier Congrès International des Etudes Balcaniques et Sud-Est Européennes à Sofia sous le titre «Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordances ou divergences albano-roumaines)», et publiée dans le numéro 2 de 1966 de la revue «*Studia albanica*» sous le titre «Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordances albano-roumaines)».

La tautologie, très longtemps considérée du point de vue conceptionnel, a été conçue comme «la répétition de la même chose par des mots différents ou semblables», et a été interprétée comme oiseuse, inutile ou comme une faute de style. Le même point de vue a dominé dans l'examen des cas de tautologie linguistique, c-à-d. quand il y a répétition de même mot de même sens lexical.

Après avoir examiné la conception de la tautologie linguistique de l'acad. Al. Graur et du linguiste Eugenia Contraş, l'auteur, tout en estimant au plus haut degré l'importance de la conception linguistique de la tautologie exposée par ses collègues roumains, en fait ressortir néanmoins les lacunes, étant donné que la répétition d'un même mot, de même sens lexical, mais de fonction syntaxique différente ne donne pas absolument une tautologie; ainsi dans sa propre définition l'auteur insère certaines limitations très importantes, et la formule comme suit: «La tautologie est la répétition d'un mot ou d'un groupe de mots ayant le même sens lexical, la même forme casuelle, resp. les mêmes voix, temps et personne, mais qui ne sont pas complétés par un mot ou par une proposition et ont des fonctions syntaxiques différentes si les termes sont dans la même proposition, ou bien la même fonction de prédicat verbal ou une fonction différente de sujet et de prédicatif si un des termes est dans la principale et l'autre dans la subordonnée».

L'auteur se propose d'examiner toutes les constructions tautologiques ainsi conçues de l'albanais contemporain (langage parlé, folklore, langue littéraire dans ses différents styles) avec les matériaux glanés dans plus de 80 ouvrages, dont une soixantaine de manière exhaustive. Les constructions tautologiques sont examinées sur un plan contrastif, comparatif dans le roumain contemporain, sur des matériaux bien moindres.

Les constructions tautologiques sont présentées: 1) dans la phrase simple, selon les fonctions syntaxiques des membres, à savoir: a) entre le prédicatif et le sujet (djali është djalë), b) entre le complément direct et le prédicatif du complément direct: (Puna e bën njeriun njeri); c) entre «le complément de relation» et le prédicat verbal ou le prédicatif du prédicat nominal (Për të njohur, e njoh; Për i zoti, është i zoti). Dans la phrase complexe les constructions sont présentées selon les ligatures: les relatifs conjonctifs ç, kush, që, se; les conjonctions që, ku, nga, si, sa, kur, në, la conjonction composée d'éléments en distance si... që (comme ... que) et dans le cas de la juxtaposition —selon l'intonation.

Les éléments de liaison dans la phrase simple sont: la copule «jam» (être), le verbe semi-copule «bëj» (faire, rendre), ou la copule zéro; la préposition për (pour, comme) et la conjonction si (= comme) servent aussi de ligatures.

Dans la phrase complexe, les constructions tautologiques sont réalisées sur les modèles des phrases à une subordonnée: 1) sujet: Ç'u bë, u bë; 2) complément direct: mora ç'mora; 3) prédicative: Ishin si ishin. 4) de relation: Që kanë shkuar, kanë shkuar, po...; 5) locale: Vete nga vete e kthehem; 6) temporelle: Kur je i mirë, je i mirë; 7) causale: Plaku, si plak që ish, mezi ecte; 8) conditionnelle: Në vjen, eja; 9) relative concessive: Edhe kalamani që është kalaman, i di këto; 10) comparative: Eci dhe u ndal; 11) modale: Atë dimër e kalova si e kalova.

Entre deux propositions juxtaposées, à l'aide de l'intonation appropriée, peuvent être exprimées des relations conditionnelles-concessives: iku iku, s'kemi ç'bëjmë.

## I. Constructions tautologiques dans la phrase simple

Dans la phrase simple il y a des relations syntaxiques notamment: 1) entre le prédicatif et le sujet et 2) entre le complément de «relation» et le prédicat verbal ou le prédicatif.

I. 1. Dans les constructions «prédicatif — sujet» est repris un substantif pourvu ou non de l'article déterminatif agglutiné, ou est répété un pronom personnel. En albanais et en roumain — même forme des substantifs ou des pronoms, même correspondant adverbial, alb. gjithmonë, përherë etc., roum. tot. (toujours), même correspondant conjonctif si = ca (comme), même valeurs: a) mise en vedette d'une caractéristique du sujet: Urdhëri është urdhër, Podvada era podvadă; b) accentuation de l'identité: Nëna është nëna, Mama-i mama; Ti je ti, tu esti tu.; c) insistance sur la coïncidence complète avec l'idée générale qu'on s'était faite d'un objet: Burrat si burrat, Briza ca briza; d) exclusivité de la caractéristique (quand la construction est accompagnée d'une négative: Mirëpo ndihma, në fund të fundit, është ndihmë, ajo nuk mund të lozë rolin vendimtar et Crima nu e politică. . . Crima e crimă.

I.2. Les constructions «complément de relation — prédicat (verbal ou nominal)» sont très fréquentes dans la conversation: 1) le prédicat verbal est repris par l'infinitif dit «guègue» ou par l'infinitif dit «tosque»; 2) le prédicat nominal est repris par le prédicatif substantif ou adjectif précédé de la prép. për (roum. de), qui souvent fait ellipse. Valeur d'accentuation d'une idée verbale, substantive ou adjectivale et restriction sur le plan adversatif. Correspondance complète entre l'albanais et le roumain: structure, intonation, valeurs. Po për të larë, kur do të lalesh në lumë? De baut, bei mereu seu numai așa la sârbătorii; Vëlla vëlla, po qesja në mes et Frate frate, dar pita-i cu bani, barbate; për i mirë është i mirë, po... De frumoasa, esti frumoasa, dar...

II. Constructions tautologiques dans la phrase complexe de subordination. Exposé selon les ligatures:

II.1. Ligature kush. 1) Modèle des subordonnées prépositives sujet à valeur conditionnelle. Accentuation de la prédictivité. Concordance avec le roumain Kush është trim, është trim, Cine-i om, e om. 2) Subordonnée

sujet postpositive, intonation différente; la construction exprime que le sujet (kush) l'objet (kë), le propriétaire (i. e kujt) est autre que celui que croit être l'interlocuteur. Ex.: E shpëtoi kush e shpëtoi atë; Basmuri o fi ştiind cine o fi ştiind, dar eu nu ştiu. *Concordance.*

II. 2. Les propositions sont reliées par le pronom interrogatif relatif *se*, précédé d'une préposition, surtout *nga*. La construction exprime que l'agent ou la cause est autre que ce que croit être l'interlocuteur: Ai e pësoi nga e pësoi. *Parallèle roumain inconnu de l'auteur.*

II. 3 *Ligature ç (= ce que). Valeur générale d'imprécision par rapport à un sujet ou un objet. La construction prend des nuances particulières selon les différences de sens lexical des membres, selon les différences d'intonation et des éléments structurels.*

1) *Modèle de subordonnée sujet postpositive, verbes à sens lexical général d'«advenir»: «është», «ngjan», «bëhet», «gjen». Accentuation du premier terme, débit assez rapide, pas de pause entre les termes, ton en suspens, après lequel il y a une pause suivie d'une proposition juxtaposée: U bë ç'u bë/ngrehu tani. La construction tautologique et la juxtaposée donnent une valeur générale de concession.*

2) *Les termes de la tautologie ont des prédicats nominaux. Intonation différente de celle du sous-type 1. Ç'është e mirë, është e mirë. La construction fait ressortir le caractère véridique des qualités.*

3) *Les verbes sont transitifs directs actifs, et la subordonnée, complétive, toujours postpositive, suit la principale sans pause. La construction est toujours suivie d'une proposition (coordonnée ou juxtaposée): Mora ç'mora e dola jashtë. Imprécision de l'objet.*

*L'auteur ne connaît que deux constructions correspondantes roumaines: 1) Cf.: Ce-i frumos e frumos, orice ai spune et Ç'është e vërtetë, është e vërtetë. 2) Cf.: Am făcut ce am făcut și am obținut liberarea tinărului et Ai bëri ç'bëri dhe e kapi gjahun.*

II. 4. *Ligature — le pronom relatif që (qui). Subordonnée interpositive, une relative explicative à nuance concessive. Elles sont limitées dans leur structure comme suit: 1) L'antécédent est toujours un substantif, 2) le prédicat de la subordonnée est toujours nominal avec un prédicatif substantif, 3) la particule edhe est obligatoire et un élément de structure, 4) Emploi exclusif du relatif që: pour des raisons de style, le relatif i cili = (lequel) n'est pas employé: Edhe kalamani që është kalaman, të gjen sa dhëmbë ke në gojë. Différence de structure entre l'albanais et le roumain. L'albanais, quoique connaissant largement les concessives, réalise les constructions tautologiques exprimant la concession sur un des modèles de la phrase complexe à subordonnée relative explicative, en lui faisant subir quelques restrictions; tandis que le roumain, tout en connaissant les relatives explicatives à nuance concessive, réalise la tautologie sur les modèles des subordonnées conjonctionnelles concessives, introduites par les conjonctions purement concessives *că, de, cîtu* dont les corrélatifs se trouvent dans la principale *tot, și încă, dar și*. Divergence complète de structure *Soarele că e soare și tot are mai pete.**

II. 5. *Selon les propriétés lexico-grammaticales des verbes prédicats, la subordonnée, introduite par la conjonction adverbiale si (= comme)*

peut se présenter sous le modèle d'une prédicative (sub. attribut), ou d'une subordonnée modale.

1) La subordonnée prédicative, quand le verbe est la copule *jam* (ou *kam*, au sens d'évaluation) donne au sujet (*jam si jam*) ou à l'objet direct (*e kam si e kam*) une qualité indéterminée; entre la construction tautologique et la proposition suivante est établie, en raison de l'indifférence envers la qualité, une nuance adversative-concessive. La construction correspondante roumaine avec l'adverbe *cum* est construite exclusivement avec la copule *a fi* (être): *Ish si ish, qe ime bijë*. — *E ke si e ke, puna jote*. et *Pan-aici toate au fost cum au fost; da de acum am prins eu la minte*.

2) Les prédicats verbaux n'ont pas de limitations du point de vue lexical. La subordonnée, une modale, exprime imprécision quant à la manière du déroulement de l'action, équivalant approximativement en français à «de quelque manière», «n'importe comment»: *Do të hante si të hante*.

Avec le verbe *bëj* (faire) — tendance vers la phraséologie.

En roumain il y a des constructions concordantes pour les deux variantes: 1) *Lumea-i cum este... și ca dînsa sîntem noi*, 2) *Trecuram cum trecuram pîna aci, stapine*.

II. 6. Avec l'adverbe conjonctif *ku* (où), on introduit une subordonnée locale. La construction tautologique exprime indétermination locale du déroulement de l'action, équivalant au français «quelque part». *I gjen atje ku i gjen*. Les constructions correspondantes avec l'adverbe relatif roumain *unde* ne figurent pas parmi les matériaux de l'auteur.

II. 7. L'adverbe conjonctif *nga* (roum. *pe unde*), désignant indétermination de l'orientation du mouvement, sert de ligature à une construction tautologique qui met en vedette le caractère indéterminé de l'orientation, équivalant approximativement au français «quelque part», «en une certaine direction». La construction est d'ordinaire suivie d'une proposition coordonnée, dont le prédicat verbal est *kthehem* (retourner). Il y a une forte tendance vers la phraséologie. Concordance avec le roumain: *Vete nga vete dhe kthehet prapë, A umblat pe unde a umblat și s-a întors*.

II. 8. La conjonction *që* (que) introduit une subordonnée prépositive «de relation». La valeur de la construction tautologique est le même que celle de son synonyme fonctionnel «complément de relation»; accentuation de la prédictivité et opposition sur un plan restrictif. — *Mor që lipsej një shi, lipsej, po më duket se do të na vijë shtërgatë*. Lorsqu'on reprend, dans le dessein de formuler une objection, une assertion de l'interlocuteur, la conjonction est ordinairement omise: — *Edhe unë jam vrarë kështu, o Kozi...* — *Je vrarë, je vrarë, o Pilo, po tashi më rri aty...*

La construction tautologique à «subordonnée de relation» n'est pas représentée en roumain contemporain. Pour exprimer «la relation» le roumain contemporain n'emploie que le «complément de relation», tandis que l'albanais peut employer le complément ou bien la subordonnée de relation.

II. 9. Ligatures; alb. *sa*, roum. *cît*. ou *ce*. Modèle des phrases complexes à subordonnée comparative d'égalité. Constructions tautologiques

très fréquentes dans le style narratif. Restrictions lexicales: sont exclus les verbes exprimant le commencement ou le terme de l'action, ou une action instantanée. *Ecën sa ecën këta nëpër male, një ditë, dy a më shumë* — *prallë është kjo* — *po u kthyen më këmbë, të këputur*. Dans cet exemple, les mots *një ditë, dy a më shumë* expriment sans ambiguïté qu'il s'agit d'une durée indéterminée de temps; la construction tautologique exprime «l'aspect duratif indéterminé». Avec la ligature roumaine *cît il y a* concordance complète avec les constructions albanaises avec *sa*, mais il y a une certaine divergence avec la ligature roumaine *ce*, dont le correspondant albanais *ç* n'a de valeur précise que comme sujet ou objet et ne peut assumer une valeur éventuelle de quantité qu'à travers la valeur de l'objet, la valeur quantitative, restant très imprécise. Avec les verbes intransitifs, la ligature *ç* en albanais est impossible; en albanais, pour exprimer la quantité (la durée dans le temps) on doit employer exclusivement *sa*. *Mai rumega el cît rumega și per urma aterne pe somn; A stat ce-a stat și-i dete-n gînd, să iasă după fată*.

II. 10. En apportant des restrictions au modèle d'un complément circonstantiel de cause (*si* + Nom ou Adjectif) et d'une subordonnée introduite par la conjonction *që*, on obtient en albanais une phrase complexe introduite par la locution conjonctionnelle ayant ses éléments structurels en distance *si. . . që* (fr. comme. . . que); par la reprise d'un substantif on a une construction tautologique qui met en vedette la caractéristique du sujet, caractéristique qui devient la cause du contenu de la principale: *Edhe gruaja, si grua që ish, pandeu vërtet. . .* Le modèle, quoique interprété de manières différentes par les linguistes roumains, existe aussi en roumain (et en français), et comprend la locution correspondante roumaine *ca . . . ce* comme ligature: *Ramiind afara, Toderica bagă mina în buzunar, și ca poznaș, ce era, scoase un condei de crede*. L'auteur ne connaît pas de construction tautologique correspondante en roumain.

II. 11. Subordonnée prépositive temporelle, introduite en albanais par *kur*, en roumain par *cînd*. Valeur temporelle à nuance conditionnelle. La construction tautologique fait ressortir une caractéristique véridique de l'action *Kur punojmë, punojmë, La munte, cînd ploua, ploua*.

II. 12. La construction tautologique avec la conjonction hypothétique *në* (*si*) et les verbes à l'indicatif fait ressortir la prédicativité. Si la principale est une proposition impérative, la construction a une valeur approximative d'une demande d'exécution immédiate d'une action projetée ( $\approx$  *si tu as l'intention de faire cela, fais-le*):  
Cf.: *Dacă mi da, mi da, dacă nu. . . et Në vjen, eja; në mos, ika vetëm*.

II. 13. La construction tautologique, constituée par une phrase à juxtaposition et caractérisée par une intonation propre: débit rapide, sur une haute ligne mélodique «tendue» et restée en suspens, après quoi fait suite d'une manière absolue une juxtaposée ou une coordonnée, exprime que l'action, quoique désagréable, est acceptée avec résignation. Valeur générale d'une conditionnelle-concessive. La question de la construction roumaine correspondante reste pour le moment ouverte.

\* \* \*

L'auteur conclut que les constructions tautologiques représentent des variantes stylistico-expressives des moyens lexicaux et grammatico-lexicaux neutres du point de vue stylistique et sont très répandues dans le langage parlé. Certaines constructions tautologiques représentent le point extrême de leur phraséologisation (bënte ç bënte e. . . , bëri ç'bëri e. . . , pa ç'pa e. . . , bëri si bëri. . . , eca sa eca, etc.); d'autres constructions sont moins liées du point de vue phraséologique, quoique ils aient subi de nombreuses restrictions, lexicales ou grammaticales.

Les constructions tautologiques moins liées phraséologiquement expriment l'accentuation d'une qualité, propriété ou d'une action, tandis que dans d'autres cas, elles expriment l'accentuation du caractère véridique, authentique d'une propriété du premier terme; dans des conditions déterminées, la tautologie peut exprimer le caractère exclusif de la propriété ou de la qualité.

Pour certaines constructions tautologiques du roumain, l'auteur, en se basant sur une base matérielle bien moindre par rapport à l'albanais, a été contraint de laisser ouverts la question de leur emploi. Il exprime l'espoir que ces parallèles vont attirer l'attention des collègues roumains pour l'examen de nouveaux parallèles.

Le matériel examiné présente un certain nombre de concordances totales, certaines concordances partielles et un petit nombre de divergences. Les concordances totales sont conditionnées, du point de vue strictement linguistique, par une concordance complète de certains éléments de la morphologie, de l'intonation, par une haute équivalence des valeurs lexicales des termes, non seulement des valeurs fondamentales, mais aussi des valeurs dérivées, à divers degrés de dérivation. Dans les cas de concordances partielles (complément de relation et subordonnée de relation, etc.) c'est la productivité du modèle qui est en jeu: le modèle est plus productif en albanais qu'en roumain. De même on pourrait dire des constructions tautologiques exprimant la concession: la productivité du modèle conjonctionnel concessif du roumain a entraîné les constructions tautologiques, tandis qu'en albanais, le modèle très productif des subordonnées relatives s'est étendu sur toutes les constructions tautologiques exprimant la concession; en albanais, les traits fondamentaux de structure (édhe . . . që) quoiqu'ils aient certains traits d'une locution conjonctionnelle concessive avec ses éléments en distance (édhe dans la principale, që dans la subordonnée), pourtant la présence du substantif répété fonctionnant en qualité de sujet dans la principale et de prédicatif (attribut) dans la subordonnée, ne donne pas encore la possibilité de considérer le tout comme une conjonction concessive. L'étude plus approfondie d'une telle prédilection d'emploi de diverses structures en albanais et en roumain pour exprimer le même rapport de concession, etc. aurait une très grande importance pour l'examen de l'agencement interne des structures dans les systèmes syntaxiques des deux langues.

